

**VENDIME
TË PËRZGJEDHURA**

TË KOLEGJIT ADMINISTRATIV

**TË GJYKATËS SË LARTË
(2022 - 2026)**



**GJYKATA E LARTË
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDIME
TË PËRZGJEDHURA
TË KOLEGJIT ADMINISTRATIV
TË GJYKATËS SË LARTË
(2022 - 2026)**



© Të drejtat e autorit në lidhje me përmbajtjen e këtij botimi, duke përfshirë
tekstin dhe fotot e përdorura, i takojnë Gjykatës së Lartë.
Tiranë, 2026

Përgatiti Aulona Hazbiu
Faqosja dhe kopertina Maluka print
Shtypur në Shqipëri nga “Maluka”

Ky botim u prodhua me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe
të Këshillit të Evropës. Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e autorit.
Pikëpamjet e shprehura këtu nuk mund të konsiderohen në asnjë mënyrë se
pasqyrojnë opinionin zyrtar të Bashkimit Evropian apo të Këshillit të Evropës.

Bashkëfinancuar nga
Bashkimi Evropian



COUNCIL OF EUROPE



Bashkëfinancuar dhe zbatuar
nga Këshilli i Evropës

VOLUMI II:

VENDIME TË PËRZGJEDHURA TË KOLEGJIT ADMINISTRATIV TË GJYKATËS
SË LARTË: **VLERËSIMI FINANCIAR I PRONËS, MARRËDHËNIET E
PUNËS NË SHËRBIMIN CIVIL DHE NDIHMA JURIDIKE**

TABELA PËRMBLEDHËSE

FJALË HYRËSE10

I. Vlerësimi financiar i pronës

1. Vendim nr.00-2022-616, datë 07.04.2022 (gjykata kompetente: raporti me natyrën e vendimmarrjes së ATP-së) 15
2. Vendimi nr.00-2025-2462 (260), datë 19.06.2025 (metodologjia ligjore - standardi minimal 10% i kompensimit, zëri kadastral aktual ndryshon nga ai i kohës së shpronësimit) 18
3. Vendim nr.00-2025-3927 (418), datë 12.11.2025 (njoftimi mbi kundërshtimin e vlerësimit - marrja efektivisht dijeni) 21
4. Vendim nr.00-2026-391 (77), datë 05.02.2026 (njoftim mbi kundërshtimin e vlerësimit - afati i paraqitjes së padisë) 26
5. Vendim nr.00-2025-1010 (129), datë 25.03.2025 (regjimi juridik i pronës në momentin e shpronësimit) 29
6. Vendim nr. 00-2025-4542 (498), datë 18.12.2025 (pronë komuniteti fetar: detyrim hetimi regjim prone për secilën periudhë shtetëzimi) 32
7. Vendim nr.00-2025-144 (38), datë 23.01.2025 (ATP barrë prove ligjshmëri vendimi)..... 36
8. Vendim nr. 00-2025-2559 (91), datë 27.02.2025 (vendim kompensimi i paekzekutuar: elementët e llogaritjes së vlerës financiare) 39
9. Vendim nr.00-2025-2569 (153), datë 07.04.2025 (shpërblim i drejtë financiar - vlera zyrtare e inflacionit/ interes bankar)..... 43
10. Vendim nr.00-2025-4710 (537), datë 23.12.2025 (kompensim me obligacione-indeksimi i interesit bankar) 46

II. Marrëdhëniet e punës në shërbimin civil

11. Vendim nr. 00-2023-2560 datë 22.06.2023 (TND: DAP - ndërgjyqësi e detyrueshme) 50

12. Vendim nr. 00-2023-93 (12), datë 19.01.2023 (afat ngritje padie: ristrukturimi si shkak përfundimi i marrëdhënies në shërbim civil).....	52
13. Vendim nr.00-2023-2356, datë 13.06.2023 (ndërvlerësia: çështje penale - administrative/disiplinore)	56
14. Vendim nr.00-2024-160, datë 16.01.2024 (moskonfirmim statusi nëpunësi civil: vlerësim i rezultateve në punë)	59
15. Vendim nr.00-2024-3688 (108), datë 12.03.2024 (moskonfirmim statusi nëpunësi civil: zbatim i parashikimeve të Kodit të Punës).....	63
16. Vendim nr.00-2025-1529 (180), datë 30.04.2025 (status nëpunësi civil: heqja dorë me shkrim nga rikthimi në detyrë).....	66
17. Vendim nr.00-2025-2351 (255), datë 18.06.2025 (largim nga shërbimi civil: nxjerrja e vërtetimit tatimor, tejkalim flagrant kompetence)	70
18. Vendim nr.00-2023-3297(279), datë 12.09.2023 (status nëpunësi civil: punonjës i administratës doganore)	75
19. Vendim nr.00-2025-1740 (189), datë 13.05.2025 (status nëpunësi civil gjyqësor: procedurë e posaçme verifikimi nga Këshilli i Gjykatës)	78
20. Vendim nr.00-2025-799 (60), datë 30.01.2025 (status nëpunësi civil: njësia e qeverisjes vendore - inspektor IVMT)	82

III. Ndhimja juridike

21. Vendim nr. 00-2024-3517, datë 19.09.2024 (kompetencë funksionale-ndihma juridike dytësore)	86
22. Vendim nr.00-2024-5317, datë 27.12.2024 (kompetencë funksionale-ndihma juridike dytësore)	90
23. Vendim njësues nr. 35008-00053-00-2026, datë 16.04.2026 (kompetencë funksionale - ndihma juridike dytësore)	94

**PARATHËNIE E KRYETARIT TË GJYKATËS SË LARTË
SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**FOREWORD BY THE PRESIDENT OF THE SUPREME
COURT OF THE REPUBLIC OF ALBANIA**

I nderuar lexues,

Shkrimi i parathënies për përmbledhjen e vendimeve të Kolegjit që kam nderin të drejtoj mbart një përgjegjësi të veçantë institucionale. Ai përfaqëson, mbi të gjitha, një akt transparence dhe përgjegjshmërie ndaj lexuesit: një mundësi për të paraqitur jo vetëm zgjidhjet juridike që ka dhënë Kolegji Administrativ, por edhe arsyetimin që i mbështet ato dhe parimet mbi të cilat është ndërtuar vendimmarrja e tij.

Ky vëllim është, njëkohësisht, dëshmi e përpjekjes së vazhdueshme të Kolegjit për të ndërtuar një jurisprudencë të qëndrueshme, koherente dhe të parashikueshme, në funksion të garantimit të sigurisë juridike dhe forcimit të besimit të publikut te drejtësia administrative. Veçanërisht, ky botim i referohet një përzgjedhje vendimesh në kuadër të procesit të trajtimit të pronës, marrëdhënieve të punës në kuadër të shërbimit civil dhe jo vetëm, si dhe një procesi mjaft të rëndësishëm për aksesin në gjykatë siç është ndihma juridike falas.

Një pjesë e qenësishme e këtij vëllimi i kushtohet çështjeve të trajtimit të pronës, një fushë që vazhdon të zërë një vend të rëndësishëm në praktikën e gjykatave administrative. Nëpërmjet këtyre vendimeve, Gjykata e Lartë ka synuar të garantojë që procesi i kompensimit të zhvillohet mbi bazën e standardeve të qarta ligjore, duke respektuar të drejtën e pronës dhe të drejtën për akses efektiv në gjykatë. Këto vendimmarrje pasqyrojnë angazhimin e vazhdueshëm të Kolegjit Administrativ në interpretimin e kuadrit ligjor të krijuar nga Ligji nr. 133/2015, “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”. Ky ligj synoi të vendoste rregull në një proces që, përgjatë më shumë se dy dekadave, kishte grumbulluar një tërësi komplekse dhe shpesh kontradiktore vendimmarrjesh administrative, vendimesh gjyqësore dhe ndërhyrjesh ligjvënëse. Si çdo reformë ligjore me objektiva të gjera, ai nuk arriti t’i zgjidhte në mënyrë të plotë të gjitha problematikat, duke lënë për gjykatat detyrën e interpretimit dhe zgjidhjes së paqartësive që ligjvënësi nuk kishte parashikuar ose që nuk mund t’i rregullonte përmes normave të përgjithshme. Vendimet e përzgjedhura zhvillojnë standarde të rëndësishme lidhur me kompetencën gjyqësore në mosmarrëveshjet për vlerësimin financiar të pronës, respektimin e afateve të ankimit administrativ, barrën e provës mbi organet publike, metodologjinë e vlerësimit financiar, si dhe kriteret për përcaktimin e kategorisë kadastrale të pasurisë në momentin e shpronësimit ose shtetëzimit.

Një vend të rëndësishëm zë gjithashtu jurisprudenca mbi marrëdhëniet e shërbimit civil. Vendimet e përfshira në këtë botim trajtojnë çështje që lidhen me procedurat e emërimit dhe largimit nga shërbimi civil, përgjegjësinë disiplinore, raportin ndërmjet procedimeve administrative dhe atyre penale, si dhe rolin e institucioneve përgjegjëse në administrimin e shërbimit civil. Nëpërmjet tyre, Kolegji Administrativ ka konsoliduar standarde që synojnë garantimin e ligjshmërisë, meritokracisë dhe proporcionalitetit

në administratën publike, duke forcuar sigurinë juridike dhe besimin në institucionet shtetërore.

Ky botim përfshin gjithashtu vendime mbi ndihmën juridike, të cilat riafirmojnë rëndësinë e aksesit efektiv në drejtësi për çdo individ, pavarësisht gjendjes së tij ekonomike. Përmes interpretimit të dispozitave përkatëse, Gjykata e Lartë ka theksuar se garancitë procedurale nuk mund të mbeten formale, por duhet të sigurojnë ushtrimin real dhe efektiv të së drejtës për mbrojtje dhe për një proces të rregullt ligjor.

Gjatë viteve të fundit, Gjykata e Lartë ka qenë e angazhuar në një proces të pandërprerë modernizimi, me synimin për t'iu afruar më shumë qytetarëve dhe studiuesve të ligjit, duke përcjellë aktivitetin e saj me transparencë dhe në kohë reale. Për këtë arsye, për të dytin vit radhazi ky botim i veçantë, i realizuar me ndihmën e çmuar të Këshillit të Evropës, do të jetë i disponueshëm edhe në format elektronik duke u bërë lehtësisht i aksesueshëm për të gjithë. Gjithashtu, nisur nga angazhimi dhe pjesëmarrja e GJL në forume ndërkombëtare ku ajo jep kontributin e saj për trajtimin e temave me rëndësi për gjykimin administrativ, civil e penal, u pa me vend që një informacion i shkurtër i këtyre vendimeve të jetë edhe në gjuhën angleze, duke u ardhur në ndihmë studiuesve të huaj ose atyre shqiptarë që prezantojnë vendimmarrjen e GJL jashtë vendit.

Botimi i këtij viti vjen i pasuruar me risi të rëndësishme, jo vetëm në strukturë dhe përmbajtje, por edhe në qasjen ndaj përmbledhjes ligjore, duke synuar një paraqitje më të qartë dhe koncize të thelbit të çdo vendimi të përzgjedhur. E njëjta metodikë zbatohet për hedhjen e vendimeve në platformën JUDIX e cila vetëm brenda një viti është pasuruar me mbi dy mijë vendime të përzgjedhura. Në këtë udhëtim transformimi, në emër të Gjykatës së Lartë, shpreh mirënjohjen time për Këshillin e Evropës, i cili, përmes projektit “Mbrojtja e të drejtës së pronës dhe lehtësimi i ekzekutimit të vendimeve të GJEDNJ-së në Shqipëri” (D-REX III), ka qenë dhe mbetet një partner i palëkundur në rrugën tonë drejt botimit cilësor dhe bashkëkohor të vendimmarrjes së kësaj Gjykate. Mbështetja e tij ka qenë vendimtare jo vetëm për harmonizimin e jurisprudencës shqiptare me atë të GJEDNJ-së, por edhe për forcimin e kapaciteteve të Gjykatës së Lartë, me qëllimin final të garantimit të drejtave themelore dhe ofrimit të një drejtësie efektive për të gjithë.

Qëllimi i këtij botimi është të ofrojë një instrument praktik pune për të gjithë profesionistët e së drejtës, duke sjellë në mënyrë të sistemuar zhvillimet më të rëndësishme të jurisprudencës administrative të Gjykatës së Lartë. Njëherazi, ai përfaqëson vijimësinë e nismës për dokumentimin dhe sistematizimin e jurisprudencës së Gjykatës, me bindjen se botimet që do të pasojnë do të vijnë në mbështetjen zbatimit e njëtrajtshëm të ligjit, zhvillimit dhe doktrinës dhe konsolidimit të shtetit të së drejtës.

Ju uroj një lexim të frytshëm!

SOKOL SADUSHI
Kryetar i Gjykatës së Lartë

Dear reader,

Writing the foreword to a collection of judgments delivered by the Chamber which I have the honor to preside over carries a particular institutional responsibility. Above all, it represents an act of transparency and accountability towards the reader: an opportunity to present not only the legal solutions adopted by the Administrative Chamber, but also the reasoning underpinning them and the principles upon which its jurisprudence has been built.

At the same time, this volume bears witness to the Chamber's continuous endeavor to develop a coherent, consistent and predictable body of case-law, serving the objectives of legal certainty and strengthening public confidence in administrative justice. In particular, this publication brings together a carefully selected collection of judgments concerning property restitution and compensation, employment relationships within the civil service and other areas of public administration, as well as one of the most significant guarantees of access to justice—state-funded legal aid.

A substantial part of this volume is devoted to disputes concerning the treatment of property, an area which continues to occupy a prominent place in the practice of the administrative courts. Through these judgments, the Supreme Court has sought to ensure that the compensation process is conducted on the basis of clear legal standards, while safeguarding both the right to property and the right of effective access to a court. These decisions reflect the Administrative Chamber's continuing commitment to interpreting the legal framework established by Law No. 133/2015, *"On the Treatment of Property and the Completion of the Property Compensation Process."* That legislation sought to bring order to a process which, over more than two decades, had accumulated a complex and often contradictory body of administrative decisions, judicial rulings and legislative interventions. Like any legislative reform pursuing broad objectives, it could not resolve every issue in its entirety, leaving to the courts the responsibility of interpreting and addressing ambiguities that the legislature had either not foreseen or could not regulate through general legal provisions. The selected judgments develop important standards concerning judicial jurisdiction over disputes relating to the financial valuation of property, compliance with statutory time limits for administrative appeals, the burden of proof borne by public authorities, the methodology for determining financial compensation, and the criteria governing the classification of the cadastral category of property at the time of expropriation or nationalization.

Equally significant is the jurisprudence concerning civil service relations. The judgments included in this publication address issues relating to appointment and dismissal procedures within the civil service, disciplinary liability, the relationship between administrative and criminal proceedings, as well as the role of the institutions responsible for the administration of the civil service. Through these decisions, the Administrative Chamber has consolidated standards aimed at safeguarding legality, merit-based public administration and proportionality, thereby reinforcing legal certainty and

strengthening public confidence in state institutions.

This publication also includes judgments concerning legal aid, reaffirming the fundamental importance of effective access to justice for every individual, irrespective of his or her financial circumstances. Through its interpretation of the relevant statutory provisions, the Supreme Court has emphasized that procedural guarantees must not remain merely formal in nature, but must ensure the genuine and effective exercise of the right to legal protection and to a fair trial.

In recent years, the Supreme Court has remained continuously engaged in a process of institutional modernization, with the objective of bringing the Court closer to citizens and legal scholars alike by ensuring greater transparency and providing timely access to its activities. For this reason, and for the second consecutive year, this special publication, prepared with the invaluable support of the Council of Europe, will also be made available in electronic format, thereby ensuring its accessibility to all. Furthermore, in view of the Supreme Court's active participation in international forums, where it contributes to discussions on matters of importance to administrative, civil and criminal adjudication, it was considered appropriate to provide a brief summary of each selected judgment in English, thereby facilitating access for foreign scholars, as well as Albanian practitioners and academics presenting the jurisprudence of the Supreme Court abroad. This year's edition introduces important innovations, not only in its structure and content, but also in its approach to legal reporting, with the objective of presenting the essence of each selected judgment in a clearer and more concise manner. The same methodology has been adopted for the publication of judgments on the JUDIX platform, which, within the space of a single year, has been enriched by the addition of more than two thousand carefully selected decisions. In the course of this process of transformation, and on behalf of the Supreme Court, I wish to express my sincere appreciation to the Council of Europe, which, through the project "Protecting Property Rights and Facilitating the Execution of ECtHR Judgments in Albania (D-REX III)," has been, and continues to be, a steadfast partner in our efforts to ensure the high-quality and modern publication of the Court's jurisprudence. Its support has proved instrumental not only in promoting the harmonisation of Albanian case-law with that of the European Court of Human Rights, but also in strengthening the institutional capacity of the Supreme Court, with the ultimate objective of safeguarding fundamental rights and ensuring the effective administration of justice for all.

The purpose of this publication is to provide a practical working tool for all legal professionals by systematically presenting the most significant developments in the administrative jurisprudence of the Supreme Court. At the same time, it represents the continuation of the Court's initiative to document and systematise its case-law, in the conviction that future publications will continue to promote the uniform application of the law, the development of legal doctrine and the consolidation of the rule of law.

I wish you a rewarding and enriching reading.

SOKOL SADUSHI
President of the Supreme Court

VOLUMI II:

VENDIME TË PËRZGJEDHURA TË KOLEGJIT ADMINISTRATIV TË GJYKATËS
SË LARTË: **VLERËSIMI FINANCIAR I PRONËS, MARRËDHËNIET E
PUNËS NË SHËRBIMIN CIVIL DHE NDIHMA JURIDIKE**

I. Vlerësimi financiar i pronës



1. Vendim nr.00-2022-616, datë 07.04.2022 (gjykata kompetente: raporti me natyrën e vendimmarrjes së ATP-së)

Maksima: 1. Sipas ligjit nr. 133/2015, janë katër dispozita që përcaktojnë gjykatën kompetente për mosmarrëveshjet civile dhe administrative që lindin nga trajtimi i pronës. Kur Agjencia e Trajtimit të Pronës (ATP) nuk kryen vlerësimin financiar të pronës brenda tre vitesh, atëherë subjekti mund t'i drejtohet Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për të përfituar vlerësimin financiar. 2. Kur subjekti kundërshton vlerësimin financiar të pronës nga ATP, atëherë kompetente nga ana funksionale për trajtimin e çështjes është Gjykata Administrative e Apelit Tiranë. 3. Ankimet kundër vendimit të njohjes së të drejtës së pronës bien në kompetencën e Gjykatës së Apelit (gjykata civile), ndërsa gjykata kompetente për shqyrtimin e çështjes, kur kërkesa është depozituar përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 133/2015 dhe nuk është shqyrtuar brenda tre vjetësh nga organi publik, është gjykata civile e shkallës së parë ku ndodhet sendi.

Fjalë kyçe: trajtim i pronës, gjykatë kompetente, vlerësim financiar prone

Decision no. 00-2022-616, dated 07.04.2022 (competent court: relation to the type of decision-making by the ATP)

Legal principle(s): 1. According to Law no. 133/2015, there are four provisions that determine the competent court for civil and administrative disputes arising from the treatment of property. When the Agency for the Treatment of Property (ATP) does not conduct a

financial evaluation of the property within three years, then the subject may apply to the Administrative Court of First Instance of Tirana to obtain the financial evaluation. 2. When the subject objects to the financial evaluation of the property by the ATP, then the Tirana Administrative Court of Appeal is functionally competent to handle the case. 3. Appeals against the decision to recognize the property right fall within the competence of the Court of Appeal (civil court), while the court competent to review the case, when the request was filed before the entry into force of Law no. 133/2015 and has not been reviewed within three years by the public body, is the civil court of first instance where the item is located.

Keywords: *treatment of property, competent court, financial valuation of property*

Rrethanat e çështjes:

Paditësja A.S [...] është një nga trashëgimtarët ligjorë të radhës së parë të babait të saj, të ndjerit Ll.Ll, duke trashëguar një të pestën e pasurisë trashëgimore [...] me vendimin nr. [...] të ish KKKP Vlorë, është vendosur njohja si ish pronar i të ndjerit mbi truallin me sipërfaqe 1.000 m² të ndodhur [...] dhe kompensimi i kësaj sipërfaqe sipas disponibilitetit që do të ketë komisioni në bazë të nenit 16 të ligjit nr. 7698, datë 15.04.1993. Me këtë vendim është vendosur që për truallin e pretenduar në lagjen “Varosh”, të mos i njihet për shkak se kjo pasuri është njohur në pronësi të pronarëve të vjetër. [...] paditësja i është drejtuar ish AKKP Tiranë për përfundimin e kompensimit të sipërfaqes së truallit prej 1.000 m² [...] i padituri ATP me vendimin nr. [...] ka vendosur kompensimi financiar të pronës [...] në vlerën prej 1.379.800 lekë dhe kompensimin nga fondi i ATP me sipërfaqen 36.310,52 m², numër pasurie [...] fshati Golem - Gjirokastrë, [...]

Duke mos qenë dakord me këtë vendim, paditësja i është drejtuar me padi Gjykatës së Apelit Vlorë, [...]

Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr. [...] ka vendosur; “Shpalljen e moskompetencës lëndore të Gjykatës së Apelit Vlorë për shqyrtimin e çështjes dhe dërgimin e saj për vazhdimin e gjyqimit në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.”

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë me vendimin nr. [...] ka vendosur:

“Të ngrejë përpara Gjykatës së Lartë çështjen e mosmarrëveshjes së kompetencës lëndore me Gjykatën e Apelit Vlorë.”

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji [...] vëren se parashtresa e Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë është pa bazuar në ligj. Për rrjedhojë, Kolegji konkludon se vendimi nr[...] i Gjykatës së Apelit Vlorë, duhet të lihet në fuqi. [...]

Referuar përmbajtjes së ligjit nr.133/2015, [...] çështja e kompetencës, si asaj lëndore, asaj funksionale ashtu edhe tokësore nuk i është lënë regjimit juridik të rregullave të përgjithshme, por është rregulluar në mënyrë të posaçme nga vetë ky ligj.

Procesi i njohjes dhe kompensimit të pronës, duke qenë një proces që përmban elementë si të natyrës civile ashtu edhe të natyrës administrative, e ka çuar ligjvënësin në përcaktimin e rregullave të veçanta për ankimin gjyqësor ndaj veprimtarisë së organit publik, ATP në ligjin e ri nr. 133/2015, [...]

Natyra civile e këtij procesi rezulton në faktin se ATP-ja shqyrton dhe disponon në lidhje me një të drejtë të natyrës private, sikurse është e drejta e pronës, e mbrojtur drejtpërdrejt nga aktet me fuqinë më të lartë juridike në Republikën e Shqipërisë, siç është Kushtetuta (neni 41) dhe Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (neni 1 i Protokollit I). Kjo konfirmohet edhe nga jurisprudenca unifikuese e Gjykatës së Lartë (*shih vendimet unifikuese nr. 24, datë 13.03.2002 dhe nr. 4, datë 10.12.2013, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë*).

Nga ana tjetër, natyra administrative e procesit në fjalë del nga përmbajtja e vetë ligjit nr. 133/2015, [...] cili përcakton karakteristikat e këtij organi (ATP), si një organ publik, si dhe rregullat e afatet për trajtimin e kërkesave për njohjen dhe kompensimin e pronave.

Referuar përmbajtjes së ligjit të sipërcituar janë katër dispozita që përcaktojnë gjykatën kompetente në raport me natyrën e vendimmarrjes së ATP-së. [...] Nga analizimi në mënyrë sistematike e këtyre katër dispozitave që përcaktojnë gjykatën kompetente për shqyrtimin e ankimit të subjektit të interesuar në procesin e njohjes dhe kompensimit të pronës, arrihet në përfundimin se gjykata kompetente përcaktohet bazuar në llojin e kërimit që ka parashtruar subjekti i interesuar (subjekti i shpronësuar ose trashëgimtarët e tij) përpara ATP-së. Nëse kërkitimi i tij lidhet vetëm me vlerësimin financiar të pronës kompetente janë gjykatat administrative, ajo e shkallës së parë ose ajo e apelit, në varësi të faktit nëse ATP e ka shqyrtuar çështjen ose jo dhe ka dalë ose jo me një vendim brenda afatit prej tre vjetësh, të përcaktuar në ligj. Nga ana tjetër, nëse kërkesa e subjektit në fjalë ka të bëjë me njohjen e pronës, kompetente nga pikëpamja lëndore do të jenë gjykatat civile, edhe këtu, sipas rastit, gjykata e shkallës së parë ose ajo e apelit, varësisht nëse ATP është shprehur ose

jo me vendim brenda afatit ligjor (*shih vendimin 2157, datë 26.09.2017, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë*).

[..] Kolegji vlerëson se në **çështjen në shqyrtim, referuar kërtimeve të parashtruara nga pala paditëse në kërkesë** padi të cilat kanë të bëjnë me kundërshtimin e vlerësimit financiar (lidhur me vlerën dhe formën e kompensimit), referuar nenit 19 të ligjit nr. 133/2015, [..] **këto kërtime janë në kompetencën e Gjykatës Administrative të Apelit, ndaj vendimi i Gjykatës së Apelit Vlorë që ka shpallur moskompetencën e vet është i mbështetur në ligj.** [..]



2. Vendimi nr.00-2025-2462 (260), datë 19.06.2025 (metodologjia ligjore - standardi minimal 10% i kompensimit, zëri kadastral aktual ndryshon nga ai i kohës së shpronësimit)

Maksima: Në shqyrtimin e çështjeve që lidhen me vlerësimin financiar të pronave të njohura për kompensim, gjykata është e detyruar të zbatojë standardet ligjore dhe kushtetuese në fuqi, duke hetuar plotësisht rrethanat faktike, duke përfshirë vlerësimin e pjesës së kthyer dhe të kompensuar, përcaktimin e zërit kadastral në kohën e shpronësimit dhe aplikimin e standardit minimal prej %10 të vlerës aktuale të pronës, sipas praktikës së GJEDNJ dhe vendimeve të Gjykatës Kushtetuese.

Fjalë kyçe: vlerësim financiar i pronës, metodologjia ligjore, standardi 10%, zëri kadastral

Decision no. 00-2025-2462 (260), dated 19.06.2025 (legal methodology - minimum standard 10% of compensation, current cadastral value differs from that at the time of expropriation)

Legal principle(s): In examining issues related to the financial valuation of properties recognised for compensation, the court is obliged to apply the legal and constitutional standards in force, fully investigating the factual circumstances, including the valuation of the returned and compensated part, the determination of the cadastral value at the time of expropriation and the application of the minimum standard of 10% of the current value of the property,

according to the practice of the ECtHR and the decisions of the Constitutional Court.

Keywords: *financial valuation of property, legal methodology, 10% standard, cadastral value*

Rrethanat e çështjes:

Paditësit L.M dhe M.K. janë trashëgimtarët e R.M, i cili ka pasur një pronë [...] që i është shtetëzuar gjatë periudhës 1990-1945. [...] KKKP Vlorë me Vendimin nr. [...] ka vendosur: “*Të njohë si ish-pronar të kësaj prone R.M të një sipërfaqeje truallit prej 2570 m² [...] Ish pronari posedon sipërfaqen e truallit prej 1076 m². Të kompensojë sipërfaqe e truallit prej 1494 m² në bazë të nenit 16 të ligjit nr. 7698 datë 15.04.1993, sipas disponibilitetit që do të ketë komisioni.*

Në momentin e shqyrtimit të dosjes origjinale sipas disponimit të këtij vendimi, Arkiva e KKKP Vlorë është djegur, për rrjedhojë trashëgimtarët ligjorë kanë krijuar dosjen nga e para me dokumentet origjinale që ato dispononin. Një kopje e dosjes e krijuar me Nr. 985 është dorëzuar pranë ish-AKKP -së në vitin 2008 në emër të njërit prej trashëgimtarëve ligjorë[...] Me shkresën “*Njoftim vendimi*” [...]AKKP [...] ka dërguar bashkëlidhur një kopje të vendimit Nr. 249 datë 03.03.2009 “*Për kompensimin e pronës*”, ku kërkesa e trashëgimtarëve ligjorë të ish-pronarit të shpronësuar, e paraqitur për kompensim në të holla, nga fondi i vitit 2008 të mos miratohet për shkak të pamjaftueshmërisë së këtij fondi.

Sipas paditësve, në mënyrë të vazhdueshme në korrespondencën shkresore me ATP-në janë njoftuar se akoma nga ky institucion nuk janë marrë në shqyrtim kërkesat e subjekteve të shpronësuar që kanë në administrim një vendim të KKK Pronave për sa i përket vitit 1996. [...] paditësit i janë drejtuar këtij institucioni me kërkesën [...], për vlerësimin financiar pasi ka rezultuar se, vendimi Nr. 106 datë 19.06.1996 i ish-KKKP pranë Bashkisë Vlorë dhënë në emër të subjektit të shpronësuar është publikuar i pavlerësuar. Me shkresën [...] “*Kthim përgjigje*”, ATP i ka bërë me dije se, nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen nr[...]është konstatuar se vendimi nr. [...]i ish-KKKP është në cilësinë e kopjes së njehsuar, për rrjedhojë në të tilla kushte ATP është në pamundësi objektive për vlerësimin e vendimit të sipërcituar. [...]

Gjykata Administrative te Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. [...], ka vendosur:

“Pranimin e kërkesë padisë [...]Vlerësimin financiar të pronës e llojit “truall” me sipërfaqe prej 1494 m², të njohur për kompensim me [...] në vlerën 16,289,082 lekë [...]” [...]

Gjykata Administrative e Apelit me vendimin nr. [...] ka vendosur: *“Lënien në fuqi të vendimit [...]”* [...]

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji [...] vlerëson se rekursi përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr.49/2012 [...] që e bëjnë të cenueshëm vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit, duke u kthyer çështja për rishqyrtim pranë asaj Gjykate por me tjetër trup gjykues për hetimin e plotë të çështjes dhe interpretimin e drejtë të ligjit material dhe procedural të zbatueshëm.

[...] Mbi rrethanat e faktit të përshkruara më sipër, Kolegji vlerëson të marrë në shqyrtim procedurën e plotë që ligji nr. 133/2015 dhe kuadri nënligjor dalë në bazë dhe për zbatim të tij kanë parashikuar lidhur me trajtimin e pronës e përfundimin e procesit të kompensimit të pronave si dhe mënyrën e disponimit nga organet publike të ngarkuara me zbatimin e këtyre procedurave.

[...] Kolegji vlerëson të sjell në vëmendje faktin se, ligji nr.133/2015 *“Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”* si dhe kuadri nënligjor normativ dalë në bazë dhe për zbatim të tij i është nënshtruar disa herë shqyrtimit në nivel kushtetues nga Gjykata Kushtetuese, por edhe trajtimit nga Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut. [...] Kolegji thekson se referuar momentit kohor të vendimmarrjes nga Gjykata Administrative e Apelit, ndryshimet e sipërcituara kanë qenë në fuqi, arsye për të cilën detyronte Gjykatën Administrative të Apelit që në zgjidhjen e çështjes me qëllim implementimin e fuqisë detyruese të vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr.4, datë 15.02.2021, **GJAA kishte detyrimin që të përcaktonte dhe të hetonte dhe standardin minimal 10% për diferencën në vlerësim midis zërit kadastral të sotëm dhe atij të kohës së shpronësimit” në kuptim të nenit 42 dhe 142, pika 1 të Kushtetutës.** Po ashtu, Gjykata Administrative e Apelit duhej të kishte vlerësuar konform formulës ligjore në fuqi, jo vetëm pjesën e njohur për kompensim, por edhe atë të kthyer palës paditëse. Gjykata Administrative e Apelit duhej të kishte administruar prova për pjesën e kthyer dhe të merrte mendimin e ekspertit përkatës në lidhje me vlerën e kësaj prone, varësisht vendndëçodhjes **së saj dhe përcaktimit të zërit kadastral në kohën e shpronësimit, duke specifikuar edhe faktin nëse në qytetin e Vlorës kishte vijë të verdhë në kohën e shpronësimit, apo do të gjejë zbatim rregulli i kufizimit të sipërfaqes së konsideruar truall deri në 500 m², në rast të pasjes së ndërtimeve mbi truall.** Sa i përket qenies së vendimit të ish

Komisionit në formën e njëjtë me origjinalin, gjykata duhet të hetonte dhe të kërkonte nga pala paditëse që të saktësonte se si është bërë njësia me origjinalin pranë noterit dhe ku ndodhet origjinali që ka shërbyer për vërtetimin e njësisë me origjinalin. Më tej, Gjykata Administrative e Apelit duhet të arsyetojë dhe ti japë përgjigje pretendimeve të palës së paditur, të riparashtuar **në rekurs, sipas të cilave** “Nga pozicionimi i pronës e njohur për kompensim sipas plan-vendosjes bashkëlidhur vendimit krahasuar me hartën e vitit 1937- 1938 rezulton se prona e njohur për kompensim figuron tokë bujqësore. Gjithashtu, referuar hartës, vija e verdhë e qytetit, viti 1972, rezulton se prona e njohur për kompensim ndodhet jashtë vijës së verdhë.”

[..] Në rigjykim, Kolegji vlerëson se Gjykata Administrative e Apelit duhet të rivlerësojë faktet, bazuar në kriteret e sipërcituara ligjore dhe në fund të japë vendim për zgjidhjen në themel të pretendimeve të paditësit. [..]



**3. Vendim nr.00-2025-3927 (418),
datë 12.11.2025 (njoftimi mbi
kundërshtimin e vlerësimit - marrja
efektivisht dijeni)**

Maksima: 1-Afati 30 (tridhjetë) ditor i parashikuar në nenin 19 të ligjit nr. 133/2015 për paraqitjen e padisë për kundërshtimin e vlerës së kompensimit është afat ligjor për kryerjen e veprimit procedural, që passjell dekadencën e të drejtës nëse nuk është ushtruar në afat, ndaj nga gjykatat duhet analizuar me kujdes momenti kur fillon të ecë ky afat, në kuptim të njoftimit “sipas mënyrës së përcaktuar në ligj”. 2- Kur ATP publikon vlerësimin financiar, por pala nuk është vënë në dijeni paraprakisht për datën e saktë të publikimit dhe njoftimi nuk tregon qartë për të drejtën dhe afatin e paraqitjes së padisë, afati për paraqitjen e padisë nuk fillon nga data e botimit të buletinit, por nga momenti që pala ka marrë dijeni efektivisht për vlerësimin financiar një e metë e tillë e aktit duhet të interpretohet në favor të palës, ndërsa barrën e provës për njoftimin efektiv e ka organi publik.

Fjalë kyçe: vlerësim financiar i pronës, njoftim i vlerësimit, marrja dijeni efektivisht për njoftimin

Decision no. 00-2025-3927(418), dated 12.11.2025 (notification on the objection to the assessment - effective receipt of knowledge)

Legal principle(s): 1-The thirty-day time limit provided for in Article 19 of Law No. 133/2015 for bringing an action challenging the amount of compensation constitutes a statutory procedural time limit for the performance of a procedural act. Failure to exercise that right within the prescribed period results in the forfeiture (*dekadencë*) of the right of action. Accordingly, the courts must carefully determine the point at which that time limit begins to run, with particular regard to the requirement that notification be effected “in the manner prescribed by law.” “. 2- Where the Property Treatment Agency (ATP) publishes the financial valuation, but the claimant has not been informed in advance of the exact date of publication, and the notification does not clearly indicate the right to bring an action and the applicable time limit for doing so, the time limit for filing the action does not begin to run from the date of publication of the Official Bulletin. Rather, it begins from the moment the claimant acquires actual knowledge of the financial valuation. Such a defect in the administrative act must be interpreted in favour of the claimant, while the burden of proving effective notification rests with the public authority..

Keywords: financial assessment of property, assessment notification, effective receipt of notice

Rrethanat e çështjes:

Paditësja M.N është një ndër trashëgimtarët ligjorë të të ndjerit M.D. për të cilin ish KKKP, me vendimin nr. [...] ka vendosur që [...] *It'i njihet një sipërfaqe trualli prej 442.5 m², nga këto 100 m², e zënë me anë funksionale të pallateve dhe 348.5 m², e zënë me dyqane. Në zbatim të nenit 21, i njihet në pronësi një sipërfaqe trualli prej 7.5 m², për efekt parablerje të një dyqani me sipërfaqe 7.5 m², e cila është e zënë nga NISH Elektriku. [...]*

Me vendimin [...], KKKP ka vendosur: “Të ndryshojë vendimin e mëparshëm të saj, [...] si më poshtë: “Në zbatim të nenit 18, i ndryshohet sipërfaqja prej 442.5 m², e trajtuar në bazë të nenit 16, në 127 m², nga të cilat 27 m² është e zënë nga studio e skulptorit, kurse 100 m² është e zënë nga pallatet e sheshe funksionale, diferenca prej 315.5 m², e zënë me dyqane, i njihet sipas nenit 21 (parablerje)”.

Trashëgimtarët e subjektit të shpronësuar, kanë aplikuar për kompensim financiar pranë AKKP-së (sot ATP-së) [...] me vendimin nr. [...], ajo

e ka pranuar kërkesën, duke kompensuar trashëgimtarët e në të holla, për sipërfaqen prej 127 m² në vlerën prej 3,048,000 lekë.

Ky vendim është kundërshtuar pjesërisht nga trashëgimtarët, me pretendimin se në bazë të akteve ligjore që rregullonin masën e kompensimit, duhej të ishin kompensuar për sipërfaqen deri në 200 m². Kjo kërkesë është pranuar nga Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin [...] është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë [...] duke i dhënë palës paditëse të drejtën që të kompensohet me të njëjtën vlerë për m² edhe për 73 m² (127+73=200 m²). Nga sipërfaqja totale prej 442.5 m² që është njohur me vendimet e KKKP-së, janë trajtuar për kompensim në të holla sipërfaqja prej 200 m² dhe kanë mbetur pa trajtuar edhe diferenca, sipërfaqja prej 242.5 m².

Pala e paditur, ATP, [...] ka proceduar me publikimin e vlerësimeve financiare të ish-pronarëve në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare, ku për subjektin, vlerësimi është publikuar në buletin nr.16, datë 30.05.2016, ku emri i tij mban nr.2190 rendor, në faqe 80 të buletinit.

[...] Me shkresën nr. [...], ATP ka sqaruar palën paditëse se; *“kompensimi financiar i saj [...] vlerësohej i zaturuar. Sipas palës së paditur: “...vlerësimi i pronës së kompensuar financiarisht është më i madh sesa vlerësimi financiar i pronës për të cilën është njohur e drejta për kompensim dhe parablerje, për të cilën nëse do të ishte hequr dorë brenda afatit të sipërcituar [30.06.2017] do të përlllogaritej si kompensim (3,048,000+1,752,000=4,800,000)>(1,080,897+2,749,053=3,829,950) lekë. Në të tilla kushte subjekti i shpronësuar Man Dashi konsiderohet i kompensuar. [...]*

Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. [...], ka vendosur: *“Mospranimin e padisë së paraqitur [...] për mosplotësim të kushteve formale të paraqitjes së saj [...]”*.

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji [...] vlerëson se rekursi i palës së paditur [...] **përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58, pika “a” të ligjit nr.49/2012** “[...] pasi vendimi është marrë në zbatim të gabuar të ligjit material dhe konkretisht neneve 19 të ligjit nr. 133/2015 dh nenit 161 të KPA, në lidhje me mënyrën e njoftimit të vendimit të vlerësimit financiar dhe momentin e fillimit të afatit të ngritjes së padisë për kundërshtimin e këtij vlerësimi.

Parashkrimi është një institut juridik që i përket të drejtës materiale, i cili lidhet me të drejta subjektive të parashikuara në ligj dhe drejtohet kundër padisë në kuptimin material, duke shkaktuar shuarjen e saj (i quajtur ndryshe si parashkrim shues). Parashkrimi i padisë përmban dy

elemente thelbësorë: *a)* kalimin e një periudhe kohe të caktuar (që njihet si afat i parashkrimit të padisë) dhe *b)* mosveprimin e titullarit për të ushtruar këtë të drejtë gjatë kësaj kohe, në rastet kur ai mund dhe duhej të vepronte. Koncepti i parashkrimit është përcaktuar në nenin 112 të KC [..]

Për të vlerësuar nëse ka kaluar apo jo afati i paraqitjes së padisë, si pasojë e mosveprimit të titullarit të saj, me rëndësi është përcaktimi i saktë i momentit të lindjes të së drejtës, nga fillon edhe llogaritja e afatit. Sipas nenit 117 të KC, afati i parashkrimit të padisë fillon nga dita, kur subjektit i ka lindur e drejta e padisë. Pikërisht, momenti i lindjes të së drejtës së padisë përcaktohet si fillimi ecjes së afatit të parashkrimit, pasi vetëm me lindjen e kësaj të drejte mund të flitet për mosveprim të titullarit dhe vetëm kur cenohet e drejta subjektive lind e drejta e padisë për mbrojtjen e saj. (*shih vendimin nr. 273, datë 28.05.2015 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë*).

Ligji nr. 49/2012, në nenin 18 përcakton rregullat për llogaritjen e afatit të padisë administrative, si një ndër kushtet formale që gjykatat administrative duhet të verifikojnë. Referuar parashikimit të nenit 18, afatet e paraqitjes së padisë janë të prera dhe shkelja e tyre shkakton humbjen e së drejtës së padisë. Këto afate shqyrtohen nga gjykata edhe kryesisht.

Ligji nr.133/2015 [..]ka përcaktuar mënyra e kompensimit të ish pronarëve, e cila ka në themel të saj vlerësimin financiar të pronës së shpronësuar duke iu referuar vlerës së pronës sipas zërit kadastral që ka pasur kjo pronë në kohën e shpronësimit. Në zbatim të nenit 19 të ligjit nr.133/2015, [..] Afati 30 (tridhjetë) ditor që parashikohet në këtë nen, është afat ligjor për kryerjen e veprimit procedural të paraqitjes së padisë në gjykatë, që duhet vlerësuar me kujdes nga gjykatat më të ulta, si një specifike e gjykimit administrativ dhe një nga parakushtet për ngritjen e padisë administrative, që normohet nga e drejta publike dhe passjell dekadencën e të drejtës nëse nuk është ushtruar në afat, rregullim ky i parashikuar shprehimisht në nenin 18 (7) të ligjit nr.49/2012 [..] Në këtë kuptim, nga gjykatat duhet analizuar me kujdes edhe momenti kur fillon të ece ky afat, në kuptim të shkronjës “b” të pikës 1 të nenit 18 të ligjit të mësipërm, sipas të cilës afati fillon nga data e njoftimit, sipas mënyrës së përcaktuar në ligj, të aktit administrativ, në rastet kur ky akt ankimohet drejtpërdrejt në gjykatë. Nga ana tjetër, Gjykata duhet të marrë në konsideratë edhe parashikimet specifike të nenit 18, pika 2 të ligjit nr. 49/2012, në rastet kur akti që kundërshtohet nuk tregon qartë për të drejtën dhe afatin e padisë, sipas të cilit [..]

Në referim të nenit pikës 2, të nenit 19, Kolegji çmon se njoftimet që duhet të bëjë ATP pas përfundimit të procesit të vlerësimit financiar duhet

të jenë në përputhje me KPA. Ky kod, në nenin 147, përcakton shprehimisht detyrimin e organit publik ti komunikojë palës ose një subjekti tjetër, të përfshirë në procedurën administrative, veprimin administrativ ose veprimin procedural me anë të njoftimit. Përsa i përket mënyrës së njoftimit, ky nen parashikon parimin e njoftimit më të përshtatshëm ku, në qoftë se nuk është parashikuar ndryshe me ligj, organi publik është i lirë të vendosë mënyrën e duhur të njoftimit të veprimeve administrative apo ndonjë njoftim tjetër, në kuadrin e procedurës administrative, shqyrtimit të mjeteve ligjore administrative ose procedurës së ekzekutimit të aktit administrativ. Në çdo rast, organi publik kryen njoftimin, duke pasur parasysh efektivitetin e tij, mbrojtjen ligjore të interesave të palës, transparencën dhe koston. Ky kod ka përcaktuar edhe mënyrat e njoftimit formal, i cili bëhet nëpërmjet dorëzimit personalisht, njoftimit nëpërmjet të tretit apo postës, si dhe nëpërmjet publikimit elektronik, njoftimit publik apo botimit zyrtar, sipas parashikimeve të neneve 159 deri në 163 të këtij Kodi. Në çdo rast ligji ka parashikuar rastet kur realizohet secila mënyrë e njoftimi formal, duke pasur gjithmonë në vëmendje përshtatshmërinë e njoftimit.

Duke iu referuar natyrës së vendimmarrjes së ATP në rastin e vlerësimit financiar të një vendimi për kompensim, e cila ka një karakter individual dhe mënyrës së veprimit të ATP përmes krijimit të regjistrave përkatës dhe publikimit periodik të tyre, Kolegji vlerëson se publikimi i vlerësimit sipas nenit 19 të ligjit nr.133/2015, duhet të përmbushë kriteret e parashikuara në nenin 161 të KPA, në lidhje me njoftimin nëpërmjet publikimit elektronik. Në kushtet kur ligji i posaçëm nuk parashikon botimin zyrtar si një mënyrë njoftimi për vlerësimin financiar dhe në kuptim të parimit të realizimit të një njoftimi të përshtatshëm dhe efektiv sipas nenit 147 të KPA, çmohet se njoftimi i parashikuar në nenin 19 të ligjit nr. 133/2015 duhet të plotësojë standardet e parashikuara në nenin 161 të KPA, [..]

Për rrjedhojë, në kushtet kur pala e paditur nuk e ka vënë në dijeni paraprakisht për datën e publikimit, Kolegji vlerëson se afati për paraqitjen në gjykatë të padisë për kundërshtimin e vlerës së kompensimit, në zbatim të nenit 19 të ligjit nr.133/2015 dhe 161 të KPA nuk ka filluar të ecë nga momenti i botimit të Buletinit të Njoftimeve Zyrtare por nga momenti që pala paditëse ka marrë dijeni efektivisht për vlerësimin financiar të bërë nga ATP, përmes shkresës nr. [..]. Nga ana tjetër vërehet se në njoftimet respektive, të aktit administrativ, për vlerësimin financiar të vendimit të KKKP nuk është treguar qartë për të drejtën dhe afatin e paraqitjes së padisë. Përderisa, sipas nenit 19 ligjit nr.133/2015, përcaktohet detyrimi i ATP për të publikuar aktet e vlerësimit, duke marrë si mënyrë njoftimi

rregullat e KPA (neni 161), si dhe duke pasur parasysh se në këtë njoftim të aktit nuk përcaktohet as e drejta e paraqitjes së padisë dhe as afati përkatës ligjor, Kolegji vlerëson se një e metë e tillë e aktit që kundërshtohet në gjykatë duhet të interpretohet në favor të palës, e cila përfiton nga garancia e nenit 18 (2) të ligjit nr.49/2012. Në rastin konkret, barrën e provës për njoftimin e bërë në mënyrë efektive palës paditëse e ka organi publik i cili nuk rezulton që ta ketë ezauruar garancitë e nenit 161 të KPA përpara se ti jetë kthyer përgjigje me shkresën nr.2745/1 prot., datë 19.04.2018 nga ATP. Për rrjedhojë, përfundimi i arritur nga Gjykata Administrative e Apelit për mospranimin e padisë me arsyetimin se padia është paraqitur jashtë afatit është i pabazuar, pasi mbështetur në të dhënat për rrethanat procedurale dhe kohën e paraqitjes së padisë në Gjykatë, është respektuar afati ligjor për paraqitjen e saj.

[..] Kolegji vendosi prishjen e vendimit nr. [...], të Gjykatës Administrative të Apelit dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në këtë gjykatë, me tjetër trup gjykues.



4. Vendim nr.00-2026-391 (77), datë 05.02.2026 (njoftim mbi kundërshtimin e vlerësimit - afati i paraqitjes së padisë)

Maksima: Në rastin e kundërshtimit gjyqësor të vlerësimit financiar të kryer nga Agjencia e Trajtimit të Pronave, afati 30-ditor i parashikuar nga neni 19 i ligjit nr. 133/2015 fillon të zbatohet në mënyrë efektive vetëm kur publikimi i aktit administrativ është bërë në përputhje me rregullat e njoftimit të Kodit të Procedurave Administrative dhe kur akti tregon qartë të drejtën e ankimit, afatin dhe mënyrën e ushtrimit të tij. Në mungesë të këtyre elementeve, zbatohet garancia e nenit 18, pika 2, të ligjit nr. 49/2012, sipas së cilës afati për paraqitjen e padisë është një vit.

Fjalë kyçe: vlerësim financiar i pronës, njoftimi i vlerësimit, afati i padisë.

Decision no.00-2026-391 (77), dated 05.02.2026 (notice on the objection to the assessment - deadline for filing a lawsuit)

Legal principle(s): In the case of a judicial objection to the financial assessment carried out by the Agency for the Treatment of Property, the 30-day deadline provided for by Article 19 of Law no. 133/2015 begins to apply effectively only when the publication of

the administrative act has been made in accordance with the rules of notification of the Code of Administrative Procedures and when the act clearly indicates the right to appeal, the deadline and the manner of exercising it. In the absence of these elements, the guarantee of Article 18, point 2, of Law no. 49/2012 applies, according to which the deadline for filing a lawsuit is one year.

Keywords: Financial assessment of property, notice of assessment, deadline for filing a lawsuit,

Rrethanat e çështjes:

Pala paditëse S.B është trashëgimtar i ish pronarit M.B që me vendimin nr. [...] të ish KKKP ka përfitur që: ti njihet sipërfaqen prej 26.490 m² [...] si dhe t'i kthehet sip. Truall prej 5.000 m² [...] dhe kompensohet sipërfaqja prej 6.649 m² që është e zënë, [...]

Me vendimin nr. [...] të ZRKKP është vendosur: “a. Të njohë sipërfaqen prej 148.351 m² që ndodhet [...]. Kthimin e sipërfaqes së lirë totale prej [...] c. Njohjen e së drejtës së kompensimit me një nga mënyrat e parashikuara në ligj [...] për sipërfaqen prej 122.911 m², [...] (Z.K arë dhe Truall)”.

[...] pala e paditur [...] ka vendosur që për efekt të kompensimit financiar ai të konsiderohet i kompensuar, për shkak se vlera e pronës së kthyer është më e madhe se vlera e pronës së njohur për kompensim: Ky vendim është publikuar në buletin nr. [...] të njoftimeve zyrtare në bazë të kërkesës së bërë nga ATP.

Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin [...]

ka vendosur: “Mospranimin e padisë së paditësit [...]” [...]

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji [...] vlerëson se rekursi i paraqitur përmban shkaqe që parashikon neni 58 i ligjit nr. 49/2012 [...] ekzistenca e të cilave mund ta bënte të cenueshëm vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit. [...]

Kolegj thekson se pretendimi i palës paditëse për se padia duhet të shqyrtohet në themel nga gjykata, në kuadër të aksesit për gjykim është i drejtë dhe i bazuar ligjërisht. Kolegji në zgjidhjen e drejtë të mosmarrëveshjes objekt gjykimi, vlerëson të shtrojë për zgjidhje çështjen se si duhet kuptuar dhe zbatuar afati 30 ditor për paraqitjen e padisë për kundërshtimin e vlerësimit financiar në gjykatë, sipas nenit 19 të ligjit nr. 133/2015 [...] dhe nenit 18(2) të ligjit nr. 49/2012 [...]

Kolegji vlerëson se afati tridhjetë ditor që parashikohet në nenin 19 të ligjit nr.133/2015 është afat ligjor për kryerjen e veprimit procedural të paraqitjes së padisë në gjykatë, që duhet vlerësuar me kujdes nga gjykatat

më të ulëta, si një specifike e gjykimit administrativ dhe një nga parakushtet për ngritjen e padisë administrative, e cila normohet nga e drejta publike dhe passjell dekadencën e të drejtës, nëse nuk është ushtruar në afat. Ky rregullim është parashikuar shprehimisht në nenin 18(7) të ligjit nr. 49/2012 [..]

Ligji i posaçëm nr.133/2015 në nenin 16 të tij parashikon se[.] në analizë të dispozitave të mësipërme, njoftimet që duhet të bëjë ATP pas përfundimit të procesit të vlerësimit financiar, duhet të jenë në përputhje me KPA (pika 2 e nenit 19). [..]

Në çështjen objekt gjykimi, vendimi nr. [..] i ZRKKP është botuar në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare nr. [..] dhe për rrjedhojë afati për paraqitjen në gjykatë të padisë për kundërshtimin e vlerës së kompensimit, në zbatim të nenit 18 i ligjit nr. 49/2012 ka filluar të ecë 10 ditë pas këtij botimi. Mirëpo në këtë njoftim të aktit administrativ të vlerësimit, nuk është treguar qartë për të drejtën dhe afatin e padisë, sipas nenit 18 të ligjit nr.49/2012. Kjo e metë e aktit që kundërshtohet në gjykatë, shkon në favor të palës, e cila përfiton nga garancia e nenit 18(2) të ligjit nr.49/2012, sipas të cilit afati për paraqitjen e padisë është 1 vit, në rastet kur akti administrativ nuk tregon qartë për të drejtën dhe afatin e padisë. Rrjedhimisht, arsyetimi i gjykatës Administrative të Apelit është i gabuar në lidhje me momentin e fillimit të afatit për paraqitjen e padisë dhe llojin e afatit në fjalë, pasi ai ka filluar të ecë me botimin në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare nr. [..] dhe se afati i fundit për të paraqitur padinë nuk është data 04.04.2019. Meqë në këtë botim nuk është shënuar e drejta e ankimit në gjykatë dhe afati 30 ditor, ky afat sipas nenit 18(2) të ligjit nr.49/2012 bëhet automatikisht 1 vit dhe rrjedhimisht paraqitja e padisë nga paditësi duke qenë se është bërë brenda këtij afati 1 vjeçar, vlerësohet se është e rregullt dhe nuk ka vend për parashkrimin e padisë në fjalë.

Kolegji ka mbajtur tashmë qëndrimin në çështje të ngjashme lidhur me trajtimin e afatit 30 ditor për kundërshtimin e vendimit të vlerësimit financiar ndaj vendimeve të ish AKKP, i parashikuar në nenin 19, të ligjit nr. 133/2015, në raport edhe me kuptimin e nenit 18(2) të ligjit nr. 49/2012, në rastet kur akti i njoftimit nuk parashikon shprehimisht të drejtën dhe afatin për ankim gjyqësor. Në vendimin nr. 00-2022-2287 (321), datë 22.09.2022 Kolegji [..]

Nga ana tjetër Kolegji vlerëson të theksoj se edhe KPA, ka bërë një parashikim specifik në rastin e njoftimeve nëpërmjet publikimit elektronik, ku në nenin 161 [..] Në interpretim të kësaj dispozite, vlen të theksohet se është detyrim i institucioneve publike zbatimi i këtij ligji organik, i cili përmban rregulla procedurale të qarta për mënyrën e njoftimit

të subjekteve të interesuara. Në këtë kuptim, në rastin e njoftimeve nëpërmjet publikimit elektronik, institucion publik, ka detyrimin të njoftojë paraprakisht subjektet të cilëve regjistri elektronik u drejtohet dhe nga ky moment ata janë në dijeni të këtij akti, si dhe të pasojave juridike që sjellë kalimi i afateve ligjore përkatëse. Pra, institucion ka detyrimin që të respektojë të drejtat e individëve dhe tu jap atyre mundësinë të njihen dhe të mbrohen efektivisht ndaj çdo vendimi që synon të krijojë pasoja juridike në interesat e tyre. Respektimi i këtyre rregullave nga ana tjetër, i jep të drejtë institucionit publik të pretendojë parashkrimin e padisë apo rënien në dekadencë të pretendimeve të palës paditëse, por për sa kohë vetë institucionet publike nuk respektojnë parashikimet ligjore të detyrueshme për zbatim, atëherë ata nuk mund të ngrenë pretendime të tilla dhe individët gëzojnë mbrojtje ligjore sipas nenit 18(2) të ligjit nr.49/2012. [..]

Në përfundim, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se vendimi i Gjykatës Administrative së Apelit duhet të prishet dhe çështja të dërgohet për rishqyrtim, në po atë gjykatë, me tjetër trup gjykues.



**5. Vendim nr.00-2025-1010 (129),
datë 25.03.2025 (regjimi juridik i
pronës në momentin e shpronësimit)**

Maksima: *Përcaktimi i zërit kadastral të pronës në kohën e shpronësimit është element themelor për vlerësimin financiar të saj, trajtimi i gabuar i pronës si tokë bujqësore kur ajo ka qenë truall përbën zbatim të gabuar të ligjit.*

Fjalë kyçe: *vlerësimi financiar i pronës, zë kadastral, truall, tokë bujqësore*

Decision no. 00-2025-1010 (129), dated 25.03.2025 (legal regime of property at the time of expropriation)

Legal principle(s): *Determining the cadastral classification of the property at the time of expropriation is a fundamental element for its financial valuation/ The erroneous classification of the property as agricultural land when it was land (truall) constitutes incorrect application of the law.*

Keywords: *financial valuation of property, cadastral entry, land, agricultural land*

Rrethanat e çështjes:

Në cilësinë e trashëgimtarit ligjor të ish pronarëve M.L, M.L dhe H.L, me vendimin nr. [...] të KKKP, paditësit i është kthyer fizikisht një sipërfaqe trualli prej 10.334 m² dhe është njohur për kompensim një sipërfaqe prej 4056.6 m². Me vendimin nr. [...] të KKKP Tiranë, nga pjesa e njohur për kompensim prej 4056. 6 m², paditësit i është kthyer fizikisht edhe një sipërfaqe prej 170 m² duke ngelur për kompensim vetëm sipërfaqja prej 3886.6 m². [...]Pranë palës së paditur ka ngelur dosja përse i përket kompensimit për sipërfaqen prej 3886.6 m².

Me shkresën [...], pala e paditur ka njoftuar paditësin se vendimi nr. [...] në emër të subjekteve të shpronësuar, është vlerësuar dhe do të publikohet në regjistrin e radhës të përditësuar për vendimet 1993-1994.

Pala paditëse i është drejtuar palës së paditur për t'i vënë në dispozicion kopjen e vendimit të vlerësimit. Pala e paditur ka refuzuar të japë një kopje të tillë duke arsyetuar se mjaftohet me informacionin e dhënë me shkresën nr. [...], sipas të cilës paditësi është informuar se nuk do të kompensohet për vlerën e truallit me sipërfaqe prej 3886.6 m² pasi konsiderohet i kompensuar, duke iu referuar diferencës së çmimit mes tokës truall që i është kthyer fizikisht paditësit me çmimin e tokës bujqësore që ka qenë në kohën e shpronësimit.

Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. [...] ka vendosur: *“Pranimin e padisë [...] Shfuqizimin e vlerësimit financiar të ATP-së për vendimet nr. [...] të KKKP për subjektin e shpronësuar si dhe publikimin në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare nr. [...]. Detyrimin e palës së paditur që të bëjë vlerësimin financiar të pronës së paditësit, me sipërfaqe totale prej 3886.6 m², të njohur me vendimet nr. [...] të KKKP Tiranë, sipas zërit kadastral të kohës së shpronësimit, «truall», si dhe në përputhje me VKM-në nr. 89, datë 03.02.2016.”* [...]

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji [...] se rekurset e palës paditëse dhe të paditur, kundër vendimit [...] të Gjykatës Administrative të Apelit, parashetrojnë shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 germa “a” të ligjit nr.49/2012 “lidhur me zbatimin e gabuar të ligjit nr. 133/2015 në lidhje me identifikimin e zërit kadastral **të pronës në kohën e shpronësimit dhe mënyrës së disponimit** nga gjykata, të cilat në vlerësim të këtij Kolegji nuk qëndrojnë.

Në pikën 1/a të nenit 6 të ligjit nr. 133/2015, datë 05.12.2015 [...] dhe në pikën 3/a të Kreut I të VKM nr. 223, datë 23.03.2016 “[...] është përcaktuar metodologjia e vlerësimit, sipas së cilës: «Prona e njohur për kompensim vlerësohet në bazë të zërit kadastral që ka pasur në kohën e shpronësimit»,

duke u bazuar në hartën e vlerës në kohën e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Përcaktimi i saktë i kriterit dallues për identifikimin e zërit kadastral të pronës, në momentin e shpronësimit ka qenë në vëmendje të posaçme të ligjvënësit. Në nenin 5, pika 12, të ligjit nr. 2015/133 parashikohet se [...] duke vënë theksin tek vija kufizuese e qyteteve dhe qendrave të banuara në çastin e shpronësimit. Në kreun I, pika 3, të VKM nr. 223, datë 23.03.2016 parashikohet se vlerësimi kryhet “duke u bazuar në vlerat e përcaktuara në hartën e vlerës”. Po ashtu në këtë akt nënligjor parashikohet: [...]

Kolegji, si u njoh me shkaqet e parashtruara në rekurs, vlerëson korrekt arsyetimin e Gjykatës Administrative të Apelit, se pala e paditur ATP ka gabuar në përcaktimin e vlerës së pronës së njohur dhe të kthyer dhe të asaj të njohur për kompensim, duke e trajtuar atë si “tokë bujqësore” në momentin e shpronësimit. Pala e paditur nuk ka argumentuar ligjshmërinë e përfundimit të arritur për zërin kadastral “Arë” të sipërfaqes që është trajtuar me vendimet përkatëse dhe se përfundimi i palës së paditur nuk gjen mbështetje në dokumentacionin kadastral të origjinës së pronës që është administruar prej saj, sikurse përcakton ligji nr. 2015/133 dhe VKM nr. 223, datë 23.03.2016 [...] Nga ana tjetër, Kolegji çmon se Gjykata Administrative e Apelit ka interpretuar drejtë ligjin nr.133/2015, nenin 5, pikat 12 dhe 13 të tij, përsa i përket identifikimit të zërit kadastral në kohën e shpronësimit, për efekt të ligjit të mësipërm në raport me vijën kufizuese të qytetit dhe ka kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm në lidhje me përcaktimin e zërit kadastral të sipërfaqes së trajtuar me vendimet e mësipërme dhe të asaj që do të kompensohet. Rrjedhimisht qëndrimi i Gjykatës Administrative të Apelit vlerësohet në përputhje me ligjin material dhe aktet e administratuara në dosjen gjyqësore.

Kolegji vlerëson se Gjykata Administrative e Apelit rezulton të ketë kryer një hetim të plotë e të gjithëanshëm të çështjes, jo vetëm në funksion të identifikimit të zërit kadastral të pronës në kohën e shpronësimit por edhe në funksion të zgjidhjes përfundimtare të kërimit të paditësit, duke e bërë kërkimin e paditësit të qartë dhe krejtësisht të përcaktueshëm. Duke identifikuar zërin kadastral të pronës në momentin e shpronësimit (duke e trajtuar atë si tokë truall), sipërfaqen për të cilën paditësi është shpronësuar dhe atë për të cilën ai duhet të kompensohet, zonën kadastrale ku shtrihet prona që do të kompensohet dhe vlerën e pronës për m² në bazë të VKM-së nr. 89, datë 03.02.2016, gjykata ka përcaktuar në mënyrë krejtësisht të qartë vlerën e kompensimit që i përket paditësit për efekt të kompensimit. Në këto kushte, pranimi i padisë nga gjykata e apelit dhe dërgimi i çështjes pranë ATP-së që të (ri) bëjë një vlerësim financiar, në këtë rast nuk është gjë tjetër veçse detyrimi i organit publik

të zbatojë një vendim gjyqësor duke kryer thjeshtë veprime matematikore në nxjerrjen e vlerës së plotë të shpronësimit, pa patur mundësi të bëjë një vlerësim tjetër dhe nevojë të bëjë hetim administrativ apo vlerësime nga pikëpamja e faktit apo e ligjit.

Kolegji sjell në vëmendje se çështjet e tjera të ngritura në rekursin e palës së paditur dhe Avokaturës së Shtetit, janë adresuar në mënyrë shteruese nga ana e Gjykatës Administrative të Apelit, duke argumentuar në përputhje me nenin 37 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar. [...] Në përfundim, mbështetur në arsyet e mësipërme, Kolegji vlerëson se vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit duhet të lihet në fuqi.



**6. Vendim nr. 00-2025-4542 (498),
datë 18.12.2025 (pronë komuniteti fetar:
detyrim hetimi regjim prone për secilën
periudhë shtetëzimi)**

Maksima: 1. Në mosmarrëveshjet për vlerësimin financiar të vendimeve përfundimtare të kompensimit sipas ligjit nr. 133/2015, përcaktimi i zërit kadastral të origjinës së pronës kërkon hetim të plotë mbi kohën e shpronësimit dhe dokumentacionin përkatës të asaj kohe. 2. Për pronat e komuniteteve fetare, kur evidentohen disa periudha shtetëzimi, gjykata duhet ta shtrijë hetimin në secilën prej tyre. 3. Kur vlerësimi financiar i ATP-së kundërshtohet në gjykatë, është gjykata ajo që duhet ta zgjidhë mosmarrëveshjen në themel, duke përcaktuar vlerën konkrete të detyrimit, pasi ATP, pas mbarimit të afatit ligjor, nuk ka më kompetencë të kryejë rivlerësim financiar.

Fjalë kyçe: vlerësim financiar i pronës, zë kadastral, periudhë shtetëzimi

Decision no. 00-2025-4542 (498), dated 18.12.2025 (religious community property: obligation for investigation, property regime for each period of nationalisation)

Legal principle(s): 1. In disputes over the financial assessment of final compensation decisions under Law no. 133/2015, the determination of the cadastral classification of origin of the property requires a full investigation of the time of expropriation and the relevant documentation of that time. 2. For properties of religious communities, when several periods of nationalization are ev-

idenced, the court must extend the investigation to each of them. 3. When the financial assessment of the ATP is contested in court, it is the court that must resolve the dispute on the merits, by determining the specific amount of compensation due, since the ATP, after the expiration of the statutory time limit, no longer has jurisdiction to carry out a financial revaluation.

Keywords: *financial assessment of property, cadastral item, nationalisation period*

Rrethanat e çështjes:

[..] Me vendimin [..] të ZRKKKP, subjektit të shpronësuar, KMSH, Myftinia Korçë i është njohur e drejta e pronësisë për disa nga pronat [..]: “1. -Truall me sipërfaqe 5 135 m², [..] Truall me sipërfaqe 372 m² [..]. 2. Të kthejë pronën: - Trull i lirë me sipërfaqe 501, [..] Truall me sipërfaqe 372 m², [..]. 3. Të njohë të drejtën e kompensimit për pronën e zënë me ndërtime, rrugë, pallate dhe lulishte, për sipërfaqen 4635 m². [..]

Ish-AKKK Tiranë më datën 26.04.2011 ka marrë në shqyrtim kërkesën me nr. [..]për kompensimin fizik të sipërfaqes prej 5100 m². [..] me vendimin nr. [..]ka vendosur: “1. *Pranimin e pjesshëm të kërkesës.* 2. *Kompensimin fizik të subjektit të [..] për sipërfaqen 4000 (katër mijë) m², të llojit “truall”, [..] 3. Nga prona e njohur për kompensim, sipas [..] të ZRAKKP qarku Korçë, këtij subjekti të shpronësuar i mbetet për t’u kompensuar sipërfaqja prej 1876 m². [..]*

ATP ka publikuar në Buletinin e publikimeve zyrtare nr. [..], vlerësimin financiar të vendimit [..]dhe vlerësimi për këtë subjekt është 0 lekë: *Subjekti konsiderohet i kompensuar (- 3 261 435 lekë).* Pala e paditur ka arritur në këtë përfundim pasi zërin kadastral të pronës së trajtuar për kompensim me sipërfaqe 1876 m² e ka konsideruar zë arë në momentin e shpronësimit. [..]

Gjykata Administrative e Apelit me vendimin nr. [..] ka vendosur: “*Pranimin e padisë. Ndryshimin e vlerësimit të kompensimit financiar të bërë nga pala e paditur ATP ndaj vendimit nr.[..] të ZRKKKP Korçë të ndryshuar [..] duke bërë rivlerësimin financiar për sipërfaqen 1876 m² nga zë kadastral “arë” në zë kadastral “truall”[...].*”.[..]

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji [..] vlerëson se në përmbajtje të rekursit ngrihen shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012 [..] ekzistenca e të cilave e bën të cënueshëm vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit. [..] vlerësohet se arsyetimi dhe përfundimi i arritur nga Gjykata Administrative e Apelit

është rrjedhojë e interpretimit jo të drejtë të kërkesave të ligjit procedural, të cilat e bëjnë të cënueshëm vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit, duke u kthyer çështja për rishqyrtim pranë asaj gjykate por me tjetër trup gjykues për hetimin e plotë të çështjes dhe interpretimin e drejtë të ligjit material dhe procedural të zbatueshëm. [...]

Kolegji vlerëson se, konflikti gjyqësor lidhet me përcaktimin e zërit kadastral në kohën e shpronësimit. Gjykata e Apelit ka vlerësuar se zëri kadastral në kohën e shpronësimit është truall duke u bazuar në vitin 1967 ku sipas dekretit 4263 datë 11.04.1967 neni 2 i tij është vendosur që pasuria e paluajtshme e komuniteteve fetare përveç ndërtesave ku ata janë vendosur, kalon në pronësi të shtetit. Në këto kushte koha e shpronësimit të KMSH Myftinia Korçë do të merret si kohë viti 1967. Referuar hartës së vitit 1961 pjesë nga plani rregullues i Korçës, vija e verdhë shk. 1:2500, ashtu sikundër edhe ekspertja e ka sqaruar në aktin e ekspertimit rezulton se kjo pronë përfshihej brenda vijës së verdhë të qytetit të Korçës.

Mirëpo, Kolegji vlerëson se GJAA nuk i është përgjigjur pretendimeve të organit publik në lidhje **me zërin kadastral të origjinës duke mos iu referuar hartës se vitit 1967, por hartave të vitit 1944** duke mos hetuar mjaftueshëm në kushtet që njihen 3 periudha shtetëzimi për këto lloj pronash (**pronat e myftinive myslimane (vakëfet) në Shqipëri**):

a. Reforma agrare – 1945: Me ligjin e reformës agrare të vitit 1945, shteti mori tokat e mëdha bujqësore, përfshirë edhe shumë prona vakëfi që administroheshin nga myftinitë. Këto toka u shpërndanë ose u futën në pronësi shtetërore.

b. Shtetëzimet e përgjithshme – 1946–1950. Në këtë periudhë u shtetëzuan shumë prona të institucioneve fetare dhe organizatave të ndryshme. Administrimi i pronave fetare u kufizua shumë nga shteti.

c. Heqja e fesë – 1967. Në vitin 1967, regjimi komunist ndaloi zyrtarisht fenë në Shqipëri. Xhamitë, kishat dhe të gjitha institucionet fetare u mbyllën. Të gjitha pronat e mbetura të myftinive dhe institucioneve fetare u shtetëzuan plotësisht.

Kolegji vlerëson se GJAA kishte detyrimin ligjore të shtrinte hetimin gjyqësor në këto tre periudha për përcaktimin e zërit kadastral të origjinës sipas parashikimeve të ligjit nr. 133/2015 i ndryshuar detyrë të cilën duhet ta plotësojë gjatë rigjyqimit të çështjes.

[..] Në përmbajtjen e pikave 1 dhe 2 të nenit 6 të ligjit nr.133/2015 janë materializuar parimet kryesore të formulës së kompensimit. [...] Vlerësimi për këto vendime bëhet duke marrë si referim zërin kadastral, sipas origjinës së pronës, që ndodhet më afër pronës që do të kompensohet, duke u bazuar në hartën e vlerës në kohën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, e

cila do të jetë referencë për të.

Kolegji, vlerëson se kriteret e vlerësimit janë përcaktuar shprehimisht nga ligjvënësi dhe vetëm respektimi i tyre garanton parimin e ligjshmërisë dhe përgjegjshmërisë në marrjen e vendimeve. Ligji 133/2015 bën të qartë se, evidentimi i kohës së kryerjes së shpronësimit është përcaktues i mënyrës së të proceduarit nga pala e paditur ATP në vlerësimin financiar të vendimit përfundimtar për kompensim. Kjo veprimtari e palës së paditur përcaktohet se mbështetet pikërisht në të dhënat e dosjes që i përket vendimit të organit të njohjes, kthimit dhe kompensimit të pronës.

Po kështu, Kolegji vlerëson se nëse nuk provohet zëri kadastral **në momentin e shpronësimit pala paditëse përfiton nga efektet e vendimit nr. 4, dt.15.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese, [..]** duke qenë se kur ka hyrë në fuqi kjo e fundit kjo çështje ka qenë në gjykim dhe, jemi në kushtet e neni 76, pika 2 dhe pika 7 shkronja “b”, të ligji nr. 8577/2000 [..]

Në lidhje me vendimmarrjen e GJAA, Kolegji vlerëson se, vendimi nr[.] të Gjykatës Administrative të Apelit duhet të priset dhe për faktin se është marrë në zbatim të gabuar të ligjit material nr. 133/2015 dhe 20/2020 sa i përket kompetencave të palës së paditur ATP. Më konkretisht, Kolegji e gjen të bazuar pretendimin e rekursuesve se vendimi i gjykatës është një vendim i pamundur të ekzekutohet duke qenë se e detyron ATP me detyrime të cilat ajo ligjërisht nuk e ka më në kompetencë funksionale. Në momentin që vlerësimi financiar i realizuar nga ATP, kundërshtohet në gjykatë, është gjykata ajo që duhet të realizojë një ri-vlerësim financiar duke korrigjuar atë që ka realizuar ATP, nëse konstaton që vlerësimi financiar i kundërshtuar në gjykatë nuk është i realizuar në përputhje me ligjin apo provat.

ATP për sa parashikohet në ligjin nr. 133/2015, ka detyrim vetëm të ekzekutojë një vendim gjyqësor, ku të jetë përcaktuar vlera e saktë e detyrimit për subjektin e shpronësuar. Duke qenë se ligji ka hyrë në fuqi më datë 23.02.2016 dhe në shkurt të vitit 2019 janë bërë 3 vite që ky ligj ka hyrë në fuqi, afat pas kalimit të të cilit është kompetente Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ajo që duhet të kryejë vlerësim sipas kompetencës funksionale që i është dhënë me ligjin nr. 133/2015. Nisur nga momenti i disponimit të vendimit të gjykatës së apelit, pala e paditur nuk kishte më kompetenca në lidhje me vlerësimin apo rivlerësimin e kompensimit të pronave të njohura për kthim dhe kompensim. [..]

Për sa më lart, vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit është dhënë në zbatim dhe interpretim jo të drejtë të ligjit, prandaj ky vendim gjyqësor duhet të priset dhe çështja të dërgohet për rishqyrtim në këtë gjykatë, por me tjetër trup gjykues.



**7. Vendim nr.00-2025-144 (38),
datë 23.01.2025 (ATP barrë prove
ligjshmëri vendimi)**

Maksima: Në çështjet që lidhen me vlerësimin financiar të pronave të njohura për kompensim, organi publik (ATP) mban barrën e provës për të provuar ligjshmërinë e vendimit të tij dhe përcaktimin e saktë të zërit kadastral të pronës, mbi bazën e dokumenteve zyrtare dhe akteve të administruara. Mungesa e hetimit të plotë dhe përmbysja e barrës së provës në ngarkim të subjektit privat përbën shkelje të ligjit material dhe procedural.

Fjalë kyçe: ATP, barrë prove, përcaktim zë kadastral.

Decision no. 00-2025-144 (38), dated 23.01.2025 (ATP burden of proof legality of decision)

Legal principle(s): In matters related to the financial valuation of properties recognized for compensation, the public body (the ATP) bears the burden of proof to prove the legality of its decision and the correct determination of the cadastral item of the property, based on official documents and administered acts. The lack of a full investigation and the reversal of the burden of proof on the private entity constitutes a violation of substantive and procedural law.

Keywords: the ATP, burden of proof, cadastral classification determination.

Rrethanat e çështjes:

[..] ish-KKKP Tiranë me vendimin nr. [..] ka vendosur të njohë ish-pronar I.Rr. (trashëgimtarët e tij), duke i kthyer një sipërfaqe totale prej 5630 m² dhe duke i njohur të drejtën e kompensimit për sipërfaqen prej 24 638 m². Në total nga ky komision është trajtuar sipërfaqja prej 30,268 m².[..]

Ish-KKKP Tiranë me vendimin nr. [..]ka vendosur të njohë ish-pronaren M.Rr (trashëgimtarët e saj), duke i kthyer një sipërfaqe totale prej 5930 m² dhe duke i njohur të drejtën e kompensimit për sipërfaqen prej 902 m² kjo sipas përcaktimit të pikës (c) të vendimit. Totali i sipërfaqes së njohur nga komisioni është sipërfaqja prej 6,832 m².

[..] Sipas vlerësimit të publikuar [..], rezulton të jenë përfshirë në listat

e kompensimit monetar pasuritë si më poshtë vijon: - në faqe 18 të gazetës, pasuria e ish-pronarit I.Rr. me shënimin: “EZAURUAR”; - Në faqen 18 të gazetës, për pasurinë që i përket ish-pronares M.Rr, rezulton të mos jetë bërë asnjë vlerësim financiar, por gjendet me shënimin “vendimi i komisionit nuk ka hartë”.

[..] Referuar argumenteve sa më sipër, si dhe bazuar në përcaktimet e nenit 7 pika 2/a të ligjit, ATP ka vlerësuar se vlerësimi i pronës së kthyer me vendimin përfundimtar [..]të KKKP Tiranë, është më e madhe se vlera e tokës së njohur për kompensim, atëherë subjekti i shpronësuar sipas vendimit të KKKP-së është konsideruar kompensuar.

Ndërkohë, në lidhje me ish-pronaren M.Rr., ATP sqaron në shkresën e saj se: *“Nga verifikimet në regjistër rezulton se vendimi nr. [..], nuk i është përcaktuar vlera për arsye se nga dokumentacioni ligjor dhe hartografik i administruar në dosje nuk është përcaktuar zëri kadastral i origjinës së pronës. Në këto kushte duhet të përcaktoni dokumentacion me anë të së cilit të përcaktohet zëri kadastral i origjinës së pronës për të bërë të mundur përcaktimin e vlerës së pronës së njohur me vendimin e mësipërm”.*

Gjykata Administrative e Apelit me vendimin nr. [..] ka vendosur: *“Rrëzimin e kërkesë padisë [..]”.* [..]

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji [..] vlerëson se rekursi i palës paditëse përmban shkaqe nga ato të bazuara në ligj, sipas nenit 58 shkronja (c) të ligjit nr. 49/2012. [..]

Kolegji vëren se shkaqet e ngritura në rekurs kryesisht drejtohen në kundërshtimin e vendimit gjyqësor, pasi Gjykata Administrative e Apelit (GJAA) ka rrëzuar padinë e paditësve, **përsa i përket vlerësimit financiar të tokës së njohur për kompensim, si e llojit “bujqësore”, dhe jo truell sipas pretendimeve të palës paditëse.** Ndër të tjera, Gjykata Administrative e Apelit ka mbështetur vendimmarrjen në argumentimin se, referuar vërtetimit të lëshuar nga Zyra e Kadastrës pranë Bashkisë së Qytetit të Tiranës me nr. 2/9 prot. datë 02.09.1993, del se sipërfaqja e tokës ka qenë e kategorizuar në livadh dhe e punueshme. Përcaktimi i kryer për zërin kadastral të pasurisë si rrjedhojë nuk mund të konsiderohet “truall”, kjo për faktin se sipas gjykatës së apelit një përcaktim i tillë nuk gjendet i përshkruar në asnjë nga aktet me të cilën vërtetohet fakti juridik i pronës para shpronësimit. Në vlerësimin e gjykatës së apelit zëri kadastral i origjinës për pronën e njohur me vendimin nr. 553 datë 30.06.1994 të ish-KKKP Bashkia Tiranë, në emër të Ibrahim Rreli, është *tokë bujqësore*, vërtetuar me një akt ligjor me vendimin nr. 553 datë 30.06.1994 të ish-KKKP Bashkia Tiranë, i

cili nga pala paditëse nuk është kontestuar në kohën e daljes së këtij akti. [..]

Ndaj, brenda kompetencës funksionale të Kolegjit çmohet dhe arrihet në përfundimin se, gjendet i gabuar vlerësimi ligjor i GJAA pasi ka rrëzuar padinë në mungesë të hetimit të plotë dhe shterues të rrethanave të faktit në lidhje me llojin e tokës objekt kompensimi për palën paditëse, që përbën njëherësh si shkak rekursi ngritur nga rekursuesit. Kolegji vlerëson se për këtë arsye vendimi i GJAA duhet të prishet. [..]

Sa i përket meritës së shkaqeve të rekursit, Kolegji çmon se, duke qenë se shkaqet e ngritura në rekursin e palës paditëse, lidhen me nevojën e vlerësimit të fakteve të çështjes, të pakryer nga Gjykata Administrative e Apelit, vendimi nr. 14 datë 14.02.2018 i Gjykatës Administrative të Apelit nevojitet të prishet dhe çështja të dërgohet për rishqyrtim në po atë gjykatë, por me tjetër trup gjyqes, për hetimin e plotë të çështjes dhe interpretimin e drejtë të ligjit material dhe procedural të zbatueshëm. Konkretisht, Kolegji thekson se përcaktimi i zërit kadastral bëhet mbi bazën e dokumenteve zyrtare të cilat janë të administruara pranë organeve publike dhe pala e paditur ATP, në zbatim të nenit 35 të ligjit nr. 49/2012, datë 03.05.2012 [..] ka barrën e provës për të vërtetuar ligjshmërinë e vendimeve objekt shqyrtimit. Pra, barrën e provës për të provuar zërin kadastral të pronave objekt shqyrtimi e ka organi publik dhe jo pala paditëse siç rezulton në tërësi nga arsyetimi i Gjykatës Administrative të Apelit. Në këtë drejtim, Kolegji vlerëson se, gjatë gjykimit pranë gjykatës së faktit, jo vetëm duhet të ishin administruar provat e nevojshme sikurse ka rezultuar në çështjen objekt gjykimi, konkretisht titulli i pronësisë apo aktet e pronësisë mbi të cilën pretendohet origjina e pronës, aktet zyrtare në momentin e marrjes së vendimit për kompensim dhe/ose ato aktualisht, për të përcaktuar drejtë zërin kadastral, por edhe duhej të arsyetohej hollësisht në lidhje me qëndrimin e ndryshëm në raport me aktin e ekspertimit në kuadër të detyrimit që përcakton neni 224 e vijues i KPC për gjykatën dhe jo të konsiderohet *apriori* konstatimi se zëri kadastral i pronës në kohën e shpronësimit është ai i përcaktuar me vendimin e KKKP Tiranë, me arsyetimin formal se nuk është ankimuar në atë periudhë nga pala paditëse. Kjo dispozitë e KPC e dikton arsyetimin e detajuar nga ana e gjykatës në eventualitetin e vlerësimit në tërësi të provave të administruara në gjykim prej saj, në kundërshtim me konkluzionet e provës me ekspertë, sikurse në rastin objekt gjykimi.

[..] Ky vendim i GJK është shpallur pas shqyrtimit dhe dhënies së vendimit nga ana e GJAA për këtë çështje, por Kolegji konstaton se, në rastin konkret zbatohet parashikimi i nenit 76, pika 2, shkronja (b) të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 [..] Efektet juridike të vendimit të GJK, gjejnë zbatim në rastin konkret pasi çështja objekt shqyrtimi është në proces

gjyqësor dhe për të cilin akoma nuk ka një vendim të formës së prerë dhe përfundimtar, pasi në rastin konkret GJAA, në çështjen objekt gjykimi, shqyrton si shkallë e parë.

[..] Në rigjykim, GJAA do duhet të rivlerësojë faktet, bazuar në kriteret e sipërcituara ligjore në fuqi dhe në fund të japë vendim për zgjidhjen në themel të pretendimeve të paditësit, në drejtimin e plotësimit të mangësive të evidentuara më sipër.



**8. Vendim nr. 00-2025-2559 (91),
datë 27.02.2025 (vendim kompensimi i
paekzekutuar: elementët e llogaritjes së
vlerës financiare)**

Maksima: Kur kemi vendime kompensimi të përcaktuara me vlerë dhe ende të paekzekutuara, referuar nenit 6 (7) të ligjit nr. 133/2015, i ndryshuar, llogaritja e vlerës financiare kryhet mbi dy elemente: (i) indeksimin sipas vlerës zyrtare të inflacionit dhe (ii) interesin bankar sipas mesatares vjetore të nxjerrë nga Banka e Shqipërisë. Periudha e llogaritjes është nga njohja e të drejtës për kompensim deri në datën e publikimit nga ATP, pra ligji nuk njeh aplikimin e këtyre elementeve përtej kësaj date.

Fjalë kyçe: vendime kompensimi të paekzekutuara, interes bankar, indeksim vlerë zyrtare inflacioni

Decision no. 00-2025-2559 (91), dated 27.02.2025 (unenforced compensation decision: elements of the calculation of the financial value)

Legal principle(s): When compensation has already been determined in value by a final decision but has not yet been enforced, pursuant to Article 6 (7) of Law no. 133/2015, as amended, the calculation of the financial value is based on two elements: (i) indexation according to the official inflation value and (ii) bank interest according to the annual average issued by the Bank of Albania. The relevant calculation period runs from the date on which the right to compensation was recognized until the date of publication by the ATP, therefore the law does not recognize the application of these elements beyond this date.

Keywords: unenforced compensation decisions, bank interest, indexation of official inflation value

Rrethanat e çështjes:

Paditësi Gj.M, është trashëgimtar ligjor i trashëgimlënësit K.M qe me vendimin e KKKP nr. [...], ka përfituar: *“njohjen e [...], pronësinë mbi një sipërfaqe toke prej 180 dynym [...]. Të kompensojë me obligacione shtetërore trashëgimtarët ligjore të të ndjerit për një sipërfaqe tokë bujqësore prej 148.1 dynym x 13.5 lekë/m² baraz në vlerën totale 1.999.350 lekë.”*

[...] Publikimi është realizuar në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare nr. [...], ku paditësi është evidentuar me numër rendor 171 dhe vlera financiare është përcaktuar 2,775,898 lek. [...] Pala e paditur me shkresën nr. [...], i kthen përgjigje paditësit duke sqaruar ndër të tjera, se *“Me vendimin [...] është vendosur kompensimi në vlerën 1,999,350 lekë. Pika 7 e nenit 6 të ligjit nr. 2015/133 ka përcaktuar metodologjinë e vlerësimit. Vlera e indeksit dërguar me shkresën nr. 1/49 prot., datë 04.05.2016 të INSTAT, është 1.3884. Përlllogaritja e vlerës totale për kompensim është: 1,999,350 x 1.3884 = 2,775,897.45 lekë.”*

Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. [...], ka vendosur: *“Pranimin e pjesshëm të padisë [...] Detyrimin e palës së paditur ATP të llogarisë në vlerësimin financiar të vendimit nr. [...] të KKKP, interesin bankar sipas mesatares vjetore të nxjerrë nga Banka e Shqipërisë në datën 24.02.2016, mbi shumën 1.999.350 lekë, nga data 24.02.2016 deri në marrjen e shpërblimit. Rrëzimin e padisë për pjesën tjetër të kërtimeve..”* [...]

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji [...] vlerëson, se rekurset përmbajnë shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012 [...] të cilat do ta bënin të cenueshëm vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit. [...] Mosmarrëveshja në konflikt lidhet me kundërshtimet e palës paditëse, mbi metodologjinë e përdorur nga pala e paditur në këtë vlerësim. [...]

Në lidhje me rastin në gjykim, Kolegji vëren, se thelbi i kërkit të paditësit është kundërshtimi i metodologjisë së përdorur nga pala e paditur, për vlerësimin e pasurisë, pa u lidhur me zërin kadastral që ka pasur pasuria. Paditësi ngre pretendime jo vetëm mbi metodologjinë e përdorur nga pala e paditur sipas nenit 7)6) të ligjit nr. 2015/133, por pretendon edhe vlerësim financiar të pronës referuar çmimit sipas tregut të lirë. Këto pretendime, mbi metodologjinë e vlerësimit, janë ngritur prej paditësit dhe në rekurs, ku lidhur me çmimin e pronës, është kërkuar dhe aplikimi i parashikimeve të VKM nr. 1620/2008 “Për miratimin e çmimeve të trojeve, që ndodhen në të gjitha bashkitë dhe në

disa komuna”. [...] Në analizë të kësaj dispozite, Kolegji vëren, se ligjvënësi ka përcaktuar se kjo metodologji vlerësimi zbatohet për vendimet e kompensimit të përcaktuara (a) me vlerë dhe (b) ende të paekzekutuara ku subjekti i shpronësuar (paditësi) do të përfitojë (i) indeksimin, sipas vlerës zyrtare të inflacionit dhe (ii) interesin bankar, sipas mesatares vjetore të nxjerrë nga Banka e Shqipërisë në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe përlllogaritja duke aplikuar këto elementë (indeksimin dhe interesin bankar), do të bëhet për periudhën nga njohja e të drejtës për kompensim deri në datën e publikimit (të përlllogaritjes) nga ATP.

VKM nr. 223/2016, e cila ka dalë në bazë e për zbatim të ligjit nr. 133/2015, në Kreun I, pika 5, [...] Kolegji vëren, se ky parashikim në këtë pikë të VKM, në thelb, është i njëjtë me parashikimin e bërë në nenin 6(7) të ligjit nr. 133/2015, i ndryshuar, duke specifikuar se ATP (i padituri) kërkon pranë Bankës së Shqipërisë dhe INSTAT koeficientet përkatës të vlerave zyrtare të inflacionit dhe interesave bankare mesatare vjetore.

[...] Nga palët dhe Gjykata Administrative e Apelit, është pranuar se kemi një vendim kompensimi, të përcaktuar me vlerë dhe ende të paekzekutuar. Konstatohet se Gjykata Administrative e Apelit ka vlerësuar si në përputhje me ligjin vlerësimin e bërë dhe formulën e zbatuar nga pala e paditur ATP, në favor të palës paditëse. Nga ana tjetër, Gjykata Administrative e Apelit ka pranuar pjesërisht padinë, [...] Kolegji vlerëson, se vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit është marrë në interpretim e zbatim të gabuar të ligjit. Vendimi është kontradiktor dhe krijon paqartësi të dukshme, duke cenuar jo vetëm të drejtën e pretenduar nga pala paditëse, por paraqet probleme dhe sa i përket ekzekutimit të tij, në raport me parashikimet e vetë ligjit nr. 133/2015.

Gjykata Administrative e Apelit, duke detyruar palën e paditur ATP të llogarisë në vlerësimin financiar të vendimit të KKKP Lezhë, interesin bankar, sipas nenit 6(7) të ligjit nr. 133/2015, ka pranuar se ky vlerësim financiar mbi vendimin (vlerën) e paekzekutuar të KKKP, sipas kësaj dispozite, llogaritet duke aplikuar (i) indeksimin sipas vlerës zyrtare të inflacionit dhe (ii) interesin bankar sipas mesatares vjetore të nxjerrë nga Banka e Shqipërisë. Nga ana tjetër rezulton se Gjykata Administrative e Apelit është e pa qartë dhe kontradiktore në lidhje me periudhën e aplikimit të interesit bankar dhe mënyrën si do të aplikohet ky interes. Konkretisht, gjykata ka arsyetuar në vendim se *“lidhur me vonesën në marrjen e këtij shpërblimi vetë ligji ka njohur të drejtën e përfitimit të interesave bankare mbi vlerën e përcaktuar pas indeksimit, nga data e hyrjes në fuqi të ligjit deri në marrjen e këtij shpërblimi”*. Pra, sipas arsyetimit të gjykatës, interesat bankare do të aplikohen mbi

vlerën (shumën) që rezulton pas aplikimit të indeksimit (të inflacionit), ndërkohë që në dispozitivin e vendimit të saj, Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur llogaritjen e interesit bankar mbi shumën 1.999.350 lekë (principali pa indeksimin).

Po ashtu dhe sa i përket periudhës së pagimit të interesave, Kolegji konstaton se Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur pagimin e interesit bankar, nga data e hyrjes në fuqi të ligjit deri në marrjen e këtij shpërblimi, por nuk rezulton të jetë shprehur dhe nuk ka arsyetuar në lidhje me interesin bankar, sa i përket periudhës nga njohja e të drejtës për kompensim, deri në hyrjen në fuqi të ligjit. Vetë ligji nr. 133/2015 [neni 6(7)] përcakton se llogaritja që do të bëhet në favor të subjektit, bazohet në aplikimin e dy elementëve, (i) indeksimin dhe (ii) interesin bankar. Kjo do të thotë se të dy këta elementë financiarë, do të zbatohen në llogaritje për të njëjtën periudhë, që fillon nga njohja e të drejtës për kompensim deri në datën e publikimit nga ATP, gjë e cila nuk është bërë nga ana e Gjykatës Administrative të Apelit.

Referuar përcaktimit të nenit 6(7), të ligjit nr. 133/2015, i ndryshuar, Kolegji çmon të theksojë, se llogaritja e vlerës financiare në rastet e vendimit të kompensimit me vlerë dhe ende të paekzekutuar, kryhet mbi bazën e dy elementëve, (i) indeksimin sipas vlerës zyrtare të inflacionit dhe (ii) interesin bankar sipas mesatares vjetore të nxjerrë nga Banka e Shqipërisë dhe periudha e llogaritjes është, nga njohja e të drejtës për kompensim, në rastin konkret me vendimin nr[.] të KKKP Lezhë, deri në datën e publikimit nga ATP. Ky segment kohor nga njohja e të drejtës për kompensim deri në datën e publikimit nga ATP, përcaktohet nga vetë ligji nr. 133/2015, i cili nuk e njeh aplikimin e këtyre dy elementëve në llogaritje, apo dhe vetëm të interesit bankar, tej kësaj periudhe (pas publikimit nga ATP). Kjo del nga vetë përmbajtja e ligjit nr. 133/2015 në tërësi, referuar afateve të përcaktuara në të (ligj), si edhe ndryshimi (saktësimi) që ligjvënësi ka bërë nëpërmjet ligjit nr. 77/2022, ku në nenin 6(7), të ligjit nr. 133/2015, togfjalëshi “deri në *marrjen e shpërblimit*” u zëvendësua me “deri në *datën e publikimit*”.

Për këtë, Kolegji çmon të sjellë në vëmendje jurisprudencën e tij, ku, në një rast të ngjashëm, ka mbajtur të njëjtin qëndrim, [..] (Shih vendimin e KAGJL nr. 00-2024-5434, datë 22.05.2024).

Në vijim, Kolegji vëren, se Gjykata Administrative e Apelit e ka quajtur të rregullt e në përputhje me ligjin, përlllogaritjen e bërë nga pala e paditur ATP, sipas koeficientit të referuar nga INSTAT, por pa arsyetuar/sqaruar në këtë drejtim, nëse kjo formulë e përdorur nga ATP ($1,999,350 \times 1.3884$

= 2,775,897.45 lekë), përfaqëson vetëm llogaritjen e indeksit të inflacionit apo përfshin dhe interesin bankar. Referuar pikës 5 të VKM nr. 223/2016, është përcaktuar se ATP *kërkon pranë Bankës së Shqipërisë dhe* INSTAT (dy) koeficientet përkatës të vlerave zyrtare të inflacionit dhe interesave bankare mesatare vjetore, ndërkohë që sipas përlllogaritjeve të palës së paditur kemi vetëm koeficientin e referuar nga INSTAT. Kolegji çmon, se në këtë rast, mungesa e arsytimit e bën vendimin të cenueshëm, jo vetëm në drejtim të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, por dhe në kuptim të identifikimit të qartë të marrëdhënies në konflikt dhe zbatimit korrekt të nenit 6(7) të ligjit nr. 133/2015, i zbatueshëm për rastin në gjykim.

Gjithashtu, Kolegji çmon të evidentojë, se referuar përmbajtjes së nenit 6(7) të ligjit nr. 133/2015, Gjykata Administrative e Apelit, nuk ka kryer një hetim lidhur me (ekzekutimin) vendimin nr. 73, datë 27.03.2002, të ish KKKP Lezhë, dhënë në favor të paditësit. Ky hetim ishte i domosdoshëm në rastin konkret, nisur nga fakti se kemi një vendim kompensimi me obligacione shtetërore, që barazohen në vlerën totale prej 1.999.350 lekë, për të sqaruar nëse paditësi ka përfituar obligacione si rezultat i këtij vendimi dhe si kryhet indeksimi mbi obligacionet, apo dhe aplikimi i interesit bankar.

Në analizë të sa më lart, Kolegji konkludon se çështja duhet të kthehet për rishqyrtim dhe Gjykata Administrative e Apelit si gjykatë ligji dhe fakti, me qëllim zgjidhjen e drejtë të këtij konflikti gjyqësor, [...]



**9. Vendim nr.00-2025-2569 (153),
datë 07.04.2025 (shpërblim i drejtë
financiar - vlera zyrtare e inflacionit/
interes bankar)**

Maksima: Nga interpretimi sistematik i nenit 6/7 të ligjit nr. 133/2015 dhe të VKM nr. 223/2016, rezulton se treguesit “vlera zyrtare e inflacionit” dhe “interesi bankar” kanë kuptime të veçanta dhe duhet të trajtohen si elemente të pavarur në funksion të sigurimit të shpërblimit të drejtë financiar.

Fjalë kyçe: vlerë zyrtare e inflacionit, interes bankar, përlllogaritje e obligacioneve

Decision no.00-2025-2569 (153), dated 07.04.2025 (fair financial compensation - official inflation rate/bank interest)

Legal principle(s): *From the systematic interpretation of Article 6/7 of Law no. 133/2015 and of the Council of Ministers Decision no. 223/2016, it results that the indicators “official inflation rate” and “bank interest” have special meanings and should be treated as independent elements in order to ensure fair financial compensation.*

Keywords: *official inflation rate, bank interest, calculation of bonds*

Rrethanat e çështjes:

[..]Me vendimin nr. [...] të KKKP është vendosur që ish pronares A.I. t'i njihet sip 150.000 m2 [...], t'i kompensohen 3,150,000 lekë letra me vlerë. Meqenëse ish pronarja kishte vdekur, KKKP ka disponuar për trashëgimtarët e saj. [...] pala e paditur ka publikuar se, vlerësimi financiar për sipërfaqen e kompensuar është 5.746.545 lekë, vlerë për të cilën pala paditëse nuk është dakord [...]duke pretenduar që vlerësimi financiar i vendimit përfundimtar që ka njohur të drejtën e kompensimit behet duke marre si bazë zërin kadastral, sipas origjinës se pronës në momentin e shpronësimit. [...]

Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. [...], ka vendosur:

“Pranimin pjesërisht të kërkesë padisë. -Ndryshimin pjesërisht të vendimit të ATP-së për vlerësimin financiar, kryer për Vendimin [...] të KKKP. -Detyrimin e të paditurit ATP të kompensoje financiarisht trashëgimtarët ligjor të ish-pronares A.I në vlerën 15.263.268 lekë (pesëmbëdhjetë milion e dyqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e tetë lekë). [...]”[...]

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji [...] përsa i përket pretendimit të ngritur në rekursin e palës së paditur përfaqësuar nga Avokatura e Shtetit se kërkesë padia është parashkruar, Kolegji vlerëson të pabazuar pretendimin. Nga aktet bashkëlidhur rezulton se në datë 23.07.2018, ATP ka publikuar në Buletinin Zyrtar, Regjistrin e Vlerësimeve për vendimet përfundimtare që janë shprehur për njohjen e të drejtës së kompensimit për vitet 1993-2000, duke publikuar dhe vendimin nr. [...] vlerën financiare në masën 5,746,545 lekë, e cila është kundërshtuar në këtë gjykim nga pala paditëse, e cila i është drejtuar Gjykatës në datë 21.12.2018. Në këtë njoftim të aktit administrativ të vlerësimit nuk është treguar qartë për të drejtën dhe afatin e padisë. Në këtë kontekst, Kolegji vlerëson se paditësi është brenda afatit

të posaçëm një vjeçar të parashikuar në nenin 18 (2) të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar. Kolegji sjell në vëmendje se është konsoliduar qëndrimi i tij në lidhje me afatin e ngritjes së padisë në raste të ngjashme. [...]

Kolegji sjell në vëmendje se kërkitimi themelor i paditësit në këtë gjykim, i cili pretendohet edhe në rekurs është kundërshtimi i metodologjisë së përdorur për vlerësimin e pasurisë pa u lidhur me zërin kadastral që ka pasur pasuria. Në këtë kontekst, paditësi ngre pretendime jo vetëm mbi metodologjinë e referuar sipas nenit 7) 6) të ligjit nr. 2015/133 por pretendon edhe vlerësim financiar ekuivalentë me vlerën e pasurisë në eventualitetin e implikimit të VKM nr. 1620/2008 ose VKM nr. 89/2016. Kolegji vlerëson se Gjykata Administrative e Apelit nuk i ka dhënë përgjigje këtij pretendimi të palës paditëse duke kufizuar shqyrtimin gjyqësor në zbatueshmërinë e nenit 6(7) të ligjit nr. 133/2015.

[...] Kolegji vlerëson se nga interpretimi sistematik i normës nenit 6/7 të ligjit nr. 133/2015, i ndryshuar, si dhe aktit normative nënligjor nr.223, datë 23.3.2016 “**vlera zyrtare e inflacionit**” dhe “**indeksi bankar**” kanë kuptime të veçanta. **Inflacioni zyrtar** është përqindja e rritjes mesatare të çmimeve të konsumit për një periudhë njëvjeçare. Ai llogaritet dhe publikohet nga Banka e Shqipërisë bazuar në të dhënat zyrtare të INSTAT-it. **Indeksi bankar** është një tregues referencë, zakonisht i lidhur me normat e interesit në tregun bankar shqiptar, si psh ; i) *Treguesi i normës mesatare të interesit të kredive ose depozitave*, ii) *Treguesi i interesit të Bonove të Thesarit*, dhe përdoret për: a) përlllogaritjen e interesave të ndryshueshme në kontratat bankare ose të kreditimit, b) rregullimin e normave në mënyrë të drejtë sipas kushteve të tregut. Në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit (2015), këta tregues shërbejnë si bazë fillestare e llogaritjes për aplikimin e disa dispozitave të ligjit dhe për zbatimin e normave financiare në kontrata dhe detyrime që rregullohen nga ky ligj.

Në funksion të sa sipër, Kolegji evidenton faktin se GJAA pavarësisht se pranon faktin se ligjvënësi në nenin 6/7 ka përcaktuar dy kriteret që, *ATP-ja do të bëjë vlerësim financiar të tyre, duke i shtuar vlerës së përcaktuar 1) indeksimin sipas vlerës zyrtare të inflacionit dhe 2) interesin bankar*, por nuk ka arsyetuar në lidhje me këtë të fundit, se pse nuk mund ta përfitojnë paditësat, krahas pretendimeve të cituara në pikën 49 të këtij vendimi. Cenimi i njërit prej këtyre kriterëve, cenon të drejtën e subjektit për një shpërblim të drejtë dhe në përputhje me ligjin. Po kështu, Kolegji vlerëson se Gjykata Administrative e Apelit duhet të arsyetoj shkaqet për të cilat nuk merr në konsideratë normat e interesit bankar por mbështetet vetëm në të dhënat e ardhura nga INSTAT-ti .

Në këto kushte Kolegji vlerëson se çështja duhet të kthehet për rishqyrtim pranë Gjykatës Administrative të Apelit, e cila në rigjykim ka për detyrë:

(i) të hetoj dhe të jap përgjigje pretendimeve të palës paditëse në lidhje me implikimin eventual të vendimmarrjes së Gjykatës Kushtetuese në lidhje me pretendimet e paditësit të patrajtuarra prej saj, lidhur me zbatueshmërinë e VKM nr. 89/2016 ose VKM nr. 1620/2008, nëse vlerësohet se është rasti;

(ii) Të marrë në shqyrtim normën e indeksimit në raport me aktet provuese në dosje, duke identifikuar qartë kriteret ligjore dhe nënligjore sipas nenin 6 pika 7 e ligjit 133/2015 dhe VKM nr.223/2016.

[..] Për sa më lart, Kolegji arrin në përfundimin se vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit është dhënë në zbatim dhe interpretim jo të drejtë të ligjit, prandaj ky vendim gjyqësor duhet të prishet dhe çështja të dërgohet për rishqyrtim në këtë gjykatë, me tjetër trup gjykues.



**10. Vendim nr.00-2025-4710 (537),
datë 23.12.2025 (kompensim me
obligacione-indeksimi i interesit bankar)**

Maksima: Kur vendimi përfundimtar i kompensimit ka njohur kompensim me obligacione, gjykata duhet të hetojë nëse subjekti ka përfutuar realisht obligacione, nëse ato kanë pasur vlerë të përcaktuar dhe si duhet të kryhet indeksimi apo aplikimi i interesit bankar sipas nenit 6, pikat 6 dhe 7, të Ligjit nr. 133/2015.

Fjalë kyçe: kompensim me obligacione, indeksim mbi obligacionet, interes bankar.

Decision no. 00-2025-4710 (537), dated 23.12.2025 (compensation with bonds - bank interest indexation)

Legal principle(s): When the final compensation decision has granted compensation via security bonds, the court must investigate whether the subject has actually benefited from bonds, whether they had a determined value and how the indexation or application of bank interest should be carried out according to article 6, points 6 and 7, of Law no. 133/2015.

Keywords: compensation with bonds, indexation on bonds, bank interest.

Rrethanat e çështjes:

[..] Me vendimin nr. [...], ish KKKP, ka vendosur; “[..] ish pronarit Xh.H (trashëgimtarëve) u jepet e drejta e bashkëpronësisë së truallit për sipërfaqen prej 1,640 m²(njëmijë e gjashtëqind e dyzet metra katror) të [...] dhe banesa një katëshe ish shtetërore të privatizuara, ish pronari (trashëgimtarët) kanë të drejtën të ndërtojnë një shtesë kati [...]. Në bazë të ligjit nr.7698, datë 15.04.1993 neni 16 për ish pronarit (trashëgimtarëve) të kompensohet me obligacione për sipërfaqen prej 1037 m² (njëmijë e tridhjetë e shtatë) të zënë nga oborri i shkollës 8 vjeçare “Jeronim De Rada”.

Me vendimin nr. [...] të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, ka vendosur: “Të pranojë kërkesë padinë e paraqitur nga paditësit [...] etj, duke ndryshuar pikën 2 të vendimit të anës së paditur K.K.K.Pronave Elbasan, nr. [...] ai më poshtë: 2-a Në bazë të nenit të ligjit nr.7598, datë 15.4.1993 ish pronarit, të ndjerit (trashëgimtarëve) tu kthehet pronësia mbi truallin prej 622 m² [...]. 2-b Në bazë të ligjit nr. [...], neni 16/a ish pronarit (trashëgimtarëve) të kompensohen me obligacione për sipërfaqen prej 415 m² zënë nga oborri i shkollës [...] Me vendimin nr. [...] Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka vendosur: “Ndryshimin e vendimin [...] të K.K.K.Pronave pranë Bashkisë Elbasan në këtë mënyrë ;Në bazë të nenit 16 të ligjit nr.7698, datë 15.04.1993 ish pronarit të kompensohen në natyrë për sipërfaqen 1,640 m².

Pala e paditur ATP ka publikuar në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare të përditësuar nr.41, datë 18.12.2017 vlerësimin financiar të pronës së njohur për kompensim me vendimin [...] duke e konsideruar të ezauruar. Ndërkohë që i njëjti publikim është kryer në Buletinin e njoftimeve zyrtare nr.22, datë 21.05.2018 me nr. rendor 84, subjekti konsiderohet i kompensuar për më shumë se 7,344,914 lekë.

Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. [...], ka vendosur: “Pranimin e pjesshëm të padisë. Shfuqizimin e vlerësimit financiar për pronën e njohur për kompensim në favor të trashëgimtarëve të ish-pronarit [...] Detyrimin e ATP të kompensojë financiarisht trashëgimtarët e ish-pronarit për sipërfaqen e njohur për kompensim prej 1,640 m² truall në ZK 8522 në vlerën 20,932,960 lekë. Detyrimin e ATP-së të kompensojë financiarisht trashëgimtarët e ish-pronarit për sipërfaqen e njohur për kompensim në obligacione për sipërfaqen 415 m² truall në ZK.8522 në përputhje me kërkesat e ligjit nr.133/2015. Rrëzimin e padisë për pjesën tjetër të kërtimeve [...]”.[..]

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji [...] rekursët e paraqitura në përmbajtje ngrenë shkaqe ligjore të bazuara në neni 58 ligjit nr. 49/2012 [...] ekzistenca e të cilave e bëjë të cenueshëm vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit. [...] Për pasojë vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit është i cenueshëm, dhe çështja duhet të kthehet për rishqyrtim pranë asaj Gjykate, por me tjetër trup gjykues për hetimin e plotë të çështjes dhe interpretimin e drejtë të ligjit material dhe procedural të zbatueshëm.

[...] Kreu I pika 4 dhe 5 e VKM-së nr. 223/2016 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin dhe shpërndarjen e fondit financiar e fizik për kompensimin e pronave”, parashikon se [...] Natyrshëm lind pyetja se çfarë është “obligacioni” ?. **Obligacioni (është letër me vlerë) dhe përfaqëson detyrimin e pakufizuar të shtetit për të kompensuar ish-pronarët për pronën e pamundur për kthim,** pa mekanizma realë ekzekutimi. Ligji nr.7698/1993 krijoi një obligacion ligjor të shtetit shqiptar për kthimin ose kompensimin e pronave të konfiskuara gjatë regjimit komunist, duke njohur në favor të ish-pronarëve një të drejtë të mbrojtur juridikisht. Megjithatë, ky obligacion u karakterizua nga mungesa e mekanizmave efektivë të zbatimit, nga mungesa e afateve të përcaktuara dhe nga pasiguria në vlerësimin financiar, duke e kthyer atë në një detyrim formal dhe të perealizueshëm në praktikë.

Në jurisprudencën e saj të qëndrueshme, GJEDNJ ka theksuar se njohja e një të drejte pronësore pa sigurimin e një kompensimi real, efektiv dhe brenda një afati të arsyeshëm përbën shkelje të Nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ. Sipas standardit të Gjykatës, një obligacion që mbetet i pacaktuar në kohë dhe në vlerë nuk plotëson kriterin e “balancës së drejtë” ndërmjet interesit publik dhe mbrojtjes së të drejtave individuale, duke e bërë të drejtën e njohur iluzore.

Në këtë kuptim, obligacioni i parashikuar nga ligji i vitit 1993 u vlerësua nga Gjykata si një problem strukturor, që kërkonte ndërhyrje legislative për të garantuar sigurinë juridike dhe përmbushjen efektive të detyrimeve të shtetit. Reformat pasuese ligjore, në veçanti ligji nr. 133/2015, synuan të harmonizojnë rendin juridik kombëtar me standardin e GJEDNJ, duke e shndërruar obligacionin nga një detyrim i hapur dhe i pakufizuar në një detyrim të llogaritshëm, të kufizuar dhe përfundimtar. Ky institut gjen zbatim tek neni 6, pika 6 dhe 7 i ligjit nr.133/2015 i ndryshuar si dhe VKM nr.223/2016 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin dhe shpërndarjen e fondit financiar e fizik për kompensimin e pronave”.

Sa më lart, Kolegji çmon të evidentojë, se referuar përmbajtjes së nenit 6 (pika 6, 7) të ligjit nr.133/2015, Gjykata Administrative e Apelit, nuk ka kryer një hetim lidhur me (ekzekutimin) vendimin nr. [...] dhënë në favor të paditësit, kur ka disponuar me detyrimin e ATP-së të kompensojë financiarisht trashëgimtarët e ish-pronarit për sipërfaqen e njohur për kompensim në obligacione prej 415 m² truall në ZK 8522 në përputhje me kërkesat e ligjit nr.133/2015.

GJAA nuk ka hetuar mbi faktin se,

- i) kemi një vendim kompensimi me obligacione shtetërore po pa një vlerë të përcaktuar, paditësi a ka përfituar obligacione (letra me vlerë) si rezultat i këtij vendimi dhe,
- ii) si do të kryhet indeksimi mbi obligacionet, apo dhe aplikimi i interesit bankar sipas formulës së parashikuar nga neni 6, pika 7 e ligjit 133.2015 i ndryshuar.

Po kështu, Kolegji vlerëson se në këtë rast gjendemi në kushtet kur organi publik e ka shfaqur vullnetin e tij duke disponuar me një vlerësim të caktuar, për të cilin pala paditëse nuk ka qenë dakord dhe e ka kundërshtuar gjyqësisht. Në këto kushte, pranimi i padisë nga gjykata e apelit dhe dërgimi i çështjes përsëri pranë ATP **që të (ri)bëjë** një vlerësim financiar në përputhje me parashikimet e ligjit nr.133/2015 nuk mbështetet në asnjë dispozitë të ligjit nr.133/2015 [...] e as në dispozitat e ligjit nr.49/2012, përkatësisht në nenin 40 “Vendimet Përfundimtare”, shkronja “ç”, as në shkronjën “e” të tij.

Gjykata Administrative e Apelit si gjykatë ligji dhe gjykatë fakti, në funksion të zgjidhjes së drejtë të çështjes, kishte detyrimin ligjor që, në përputhje me frymën dhe qëllimin e ligjit nr.133/2015 ta gjykonte çështjen në themel dhe t’i jepte zgjidhje përfundimtare pretendimeve të parashtruara në padinë e paraqitur përpara saj, pa e kthyer tek ATP **për ta trajtuar për së dyti**, kur kishte në dispozicion të gjitha mjetet ligjore që ta zgjidhte vetë, duke riparuar mangësitë apo parregullsitë e organit publik.

[...] Në rigjykim, Kolegji vlerëson se Gjykata Administrative e Apelit duhet të rivlerësojë faktet, bazuar në kriteret e sipërcituara ligjore dhe në fund të japë vendim për zgjidhjen në themel të pretendimeve të palëve. [...]

II. Marrëdhëniet e punës në shërbimin civil



11. Vendim nr. 00-2023-2560 datë 22.06.2023 (TND: DAP - ndërgjyqësi e detyrueshme)

Maksima: Në proceset gjyqësore të nisura nga nëpunësit civilë, anëtarë të Trupës së Nivelit të Lartë Drejtues, për kundërshtimin e liritimit nga pozicioni i rregullt drejtues, Departamenti i Administratës Publike (DAP) përfshihet tek ndërgjyqësit e detyrueshëm si palë e paditur.

Fjalë kyçe: TND, DAP, lirimi nga pozicioni, ndërgjyqësi e detyrueshme

Decision no. 00-2023-2560 dated 22.06.2023 (TND: DPA - mandatory arbitration)

Legal principle(s): In legal proceedings brought by civil servants, members of the High Level Management Body, challenging their dismissal from the regular management position, the Department of Public Administration (DPA) constitutes a mandatory joinder of parties to the proceedings as a defendant.

Keywords: TND, DPA, dismissal from position, mandatory joinder of parties

Rrethanat e çështjes:

Pala paditëse gëzon statusin e nëpunësit civil dhe është pjesë e TND-së në administratën shtetërore qendrore. Me shkresën nr. [...], DAP, ka miratuar emërimin e përkohshëm të paditëses në pozicionin Drejtor i Përgjithshëm, [...] [...] Me vendimin nr [...] DAP ka konfirmuar paditësen si nëpunës civil në pozicionin, “Drejtor i Përgjithshëm, në Drejtorinë e [...]”

Me shkresën nr. [...] Ministria e Kulturës, ka kërkuar nga DAP, “lirimin e paditëses, si anëtare e TND nga pozicioni i rregullt “Drejtor i Përgjithshëm, në [...] Me shkresën nr. [...], DAP, ka vendosur, “lirimin e paditëses Zhuljeta Harasani nga pozicioni i rregullt [...] dhe regjistrimin e saj nga njësia përgjegjëse në listën e anëtarëve të TND-së, në pritje për t’u caktuar në një pozicion të rregullt.

Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, me vendimin nr. [...], ka vendosur: “*Mospranimin e kërkesë padisë [...]*”. [...]

Gjykata Administrative e Apelit me vendimin nr. [...], ka vendosur: “*Prishjen e vendimit nr. [...] dhe kthimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë po me tjetër trup gjykues [...]*”.

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji [...] vëren se në tërësinë e tij nuk ngrihen shkaqe, nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr.49/2012 [...] të cilat do ta bënin të cenueshëm vendimin e Gjykatës së Administrative të Apelit. [...]

Kolegji gjen të mbështetur përfundimin e arritur prej Gjykatës Administrative të Apelit që në mosmarrëveshjet administrative të lindura për shkak të pretendimit që është cenuar statusi i nëpunësve civilë, kur ata janë pjesë e TND-së, patjetër në gjykimin administrativ, me cilësinë e palës së paditur duhet të thirret DAP dhe pala paditëse duhet të orientohet saktë prej gjykatës në kërkimet e saj për të saktësuar ato sipas ligjit nr.49/2012 i ndryshuar (neni 15 dhe neni 17) dhe ligjit me nr.152/2013 [...]

Në juridiksionin rishikues të Gjykatës së Lartë përfshihen vetëm rastet rigorozisht të përcaktuara në nenin 58 të ligjit nr.49/2012, që lidhen me mosrespektimin ose zbatimin e gabuar të ligjit, si dhe me shkeljet e rënda të normave procedurale apo shkelje procedurale që kanë ndikuar në dhënien e vendimit. Kolegji vëren se, gjykata, në gjykimin administrativ, siguron nëpërmjet një procesi të rregullt gjyqësor dhe brenda afateve të shpejta e të arsyeshme, mbrojtjen juridike të të drejtave, lirive dhe interesave kushtetues dhe ligjorë të subjekteve, që mund të cenohen si pasojë e ushtrimit ose jo të funksioneve publike nga ana e organeve të administratës publike. Gjykata administrative zbaton parimin e mbrojtjes së interesit publik dhe të të drejtave e interesave të ligjshëm të personave privatë. Organi i administratës publike, si rregull, ka detyrimin të provojë bazueshmërinë në ligj dhe në fakt të veprimeve të kryera prej tij. [...] Kolegji vendos mospranimin e rekursit të paraqitur nga pala e paditur, Ministria e Kulturës, kundër vendimit nr[...] të Gjykatës Administrative të Apelit.



**12. Vendim nr. 00-2023-93 (12),
datë 19.01.2023 (afat ngritje padie:
ristrukturimi si shkak përfundimi i
marrëdhënies në shërbim civil)**

Maksima: Në rastin e përfundimit të marrëdhënieve në shërbimin civil për shkak të ristrukturimit, sipas nenit 50 të ligjit nr. 152/2013, afati për ngritjen e padisë ndaj aktit administrativ nis nga momenti i marrjes dijeni për vendimin e përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil dhe jo nga momenti kur përfundojnë efektet financiare të dëmshpërblimit të caktuar sipas këtij vendimi. Akti i përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil rregullon në mënyrë përfundimtare marrëdhëniet ndërmjet palëve dhe përcakton të drejtat dhe detyrimet reciproke, ndaj është menjëherë i kundërshtueshëm në gjykatë.

Fjalë kyçe: ristrukturim, përfundim marrëdhënie shërbimin civil, afat padie

Decision no. 00-2023-93 (12), dated 19.01.2023 (deadline for filing a lawsuit: restructuring as a cause of termination of civil service relationship)

Legal principle(s): In the case of termination of civil service relationships due to restructuring, according to Article 50 of Law no. 152/2013, the deadline for filing a lawsuit against an administrative act starts from the moment of receiving notice of the decision to terminate the civil service relationship and not from the moment when the financial effects of the compensation determined under this decision end. The act of termination of civil service relationship definitively regulates the relationship between the parties and determines mutual rights and obligations, therefore it is immediately contestable in court.

Keywords: restructuring, termination of civil service relationship, lawsuit deadline

Rrethanat e çështjes:

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, me urdhër nr. [...], ka emëruar paditësin në detyrën e Inspektorit në Drejtorinë e Hetim Inspektimit, pa e përcaktuar kategorinë e pagës së tij për këtë pozicion pune.

[..] Pala e paditur, me shkresën nr. [..], në zbatim të ligjit nr. 8549 datë 11.11.1999 “[..]nenit 10, shkronja “ç”, nenit 14 pikave 2 dhe 3, vlerësimit të rezultateve individuale në punë për periudhën e provës si dhe të konfirmimit të eprorit direkt, ka vendosur dhënien e statusit të “nëpunësit civil të nivelit ekzekutues” paditësit nëpunës administrate i Komisionerit [..] Pala e paditur, me shkresën nr. [..] “Për zbatimin e vendimit të kuvendit nr.106/2014 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimin e pagave të KDIMDI”, ka urdhëruar Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse, të fillojë procedurën për ristrukturimin, përshkrimet dhe shpalljen e vendeve të punës.

Drejtori i Drejtorisë së [..] me shkresën nr. [..]drejtuar paditësit, në përfundim të procedimit disiplinor ndaj paditësit, i cili kishte filluar në bazë të kërkesës së tij si epror direkt, në zbatim të ligjit nr.152/2013 ka vendosur dhënien e masës disiplinore “vërejtje” për Z. A.N, me detyrë [..].

Komisioni i ristrukturimit, me shkresën nr. [..], [..]i propozon asaj përfundimin e marrëdhënieve në shërbimin civil të paditësit. Ky komision është gjendur në pamundësi të sistemimit të paditësit, sipas procedurës së transferimit të përhershëm [..]Komisioni i ristrukturimit është gjendur në pamundësi të sistemimit të paditësit, pasi pas ristrukturimit nuk janë krijuar ose gjenden vende të lira me të njëjtën emërtesë, përshkrim pune apo kategori page. Bazuar në shkronjën “c” të pikës 7 të ligjit nr. 152/2013 [..]i ka propozuar njësisë përgjegjëse përfundimin e marrëdhënieve në shërbimin civil të paditësit, duke i dhënë të drejtën e dëmshpërblimit me pagën e 6 muajve.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. [..] ka vendosur: *“Pranimin pjesërisht të kërkesë padisë. Shfuqizimin e vendimit nr. [..]. Detyrimin e palës së paditur të rikthejë paditësin në detyrë dhe detyrimin t’i paguajë pagën që prej datës 01.09.2015. Detyrimin e palës së paditur t’i paguajë paditësit diferencën e pagës për periudhën 18.12.2014 – 01.09.2015 sipas kategorisë III a. Rrëzimin për pjesën tjetër të kërkesë padisë”*. [..]

Gjykata Administrative e Apelit me vendimin nr. [..]ka vendosur: *“Prishjen e [..] dhe pushimin e gjykimit të çështjes.”*. [..]

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji [..] vlerëson se rekursi i palës paditëse, kundër vendimit nr. [..] të Gjykatës Administrative të Apelit ngre shkaqe ligjore në lidhje me afatin e ngritjes së padisë, në kuptim të nenit 18 dhe 58 pika “a” të ligjit 49/2012. Pala paditëse pretendon se, në rastin konkret, në kuptim të nenit 18 pika 2 të ligjit nr. 49/ 2012, afati për ngritjen e padisë është 1 vit, meqenëse akti

administrativ nuk tregon qartë për të drejtën dhe afatin e padisë.

[..]. Përpara se gjykata të vlerësojë themelin e pretendimeve të palës paditëse, padia duhet të përmbushë kushtet formale të paraqitjes së saj, në të kundërt, në zbatim të nenit 39 të ligjit nr. 49/ 2012, gjykata disponon me mospranimin e padisë. [..]

Në zbatim të nenit 41 pika 3 të ligjit nr. 152/ 2013, përcaktohet se[.] Në zbatim të nenit 18 pika 1 të ligjit nr. 49/2012 parashikohet se: “[...]” Kolegji vlerëson se për sa kohë që nëpunësit civil i njihet e drejta për t’u ankuar ndaj vendimmarrjes së organeve publike në rrugë gjyqësore, sipas parashikimeve të ligjit nr. 152/ 2013, vendimmarrja e administratës publike e ndërmarrë lidhur me marrëdhënien e shërbimit civil, e materializuar në vendim, urdhër, apo në ndonjë formë tjetër të shprehjes së vullnetit të këtij organi, përbën në çdo rast veprim administrativ të kundërshtueshëm gjyqësisht.

Referuar parashikimeve ligjore, vendimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së paditësit në shërbimin civil, përbën akt administrativ. [..] Në nenin 1, pika 2 të këtij ligji [..] Në analizë të kësaj dispozite Kolegji konstaton se marrëdhënia e shërbimit civil është një marrëdhënie e natyrës administrative, e si e tillë aktet që prodhojnë organet kompetente të administratës publike, si produkt i kësaj marrëdhënie administrative, përbëjnë akte administrative, të cilat në kuptim të nenit 3 pika 1 germa “a” të KPA dhe nenit 2 pika 2 të ligjit nr.49/ 2012 janë shprehje e vullnetit nga organi publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, i cili krijon, ndryshon ose shuan marrëdhënien e shërbimit civil.

Kolegji vlerëson se, në rastin e përfundimit të marrëdhënieve në shërbimin civil për shkak të ristrukturimit sipas nenit 50 të ligjit nr. 152/2013, afati i ngritjes së padisë për të kundërshtuar këtë vendim nis nga momenti i marrjes dijeni për vendimin e përfundimit të marrëdhënieve në shërbimin civil dhe jo nga momenti që kanë përfunduar efektet financiare të dëmshpërblimit të caktuar sipas këtij vendimi, sipas nenit 50 pika 7 të ligjit nr. 152/2013. Në kuptim të nenit 3 pika 1 germa “a” të KPA dhe nenit 2 pika 2 të ligjit nr.49/ 2012, Kolegji vlerëson se me aktin e përfundimit të marrëdhënieve në shërbimin civil rregullohen në mënyrë përfundimtare marrëdhëniet mes palëve dhe përcaktohen të drejtat dhe detyrimet reciproke. Në këtë kuptim, vendimi është menjëherë i kundërshtueshëm dhe nuk mund të pritet që të ezaurohen efektet e tij financiare porsa i përket dëmshpërblimit, në mënyrë që pala ti drejtohet gjykatës. Kolegji vlerëson se vendimi nr. 02, datë 24.02.2015 është një akt administrativ. Rezulton se paditësi ka gëzuar statusin e nëpunësit civil dhe marrëdhënia juridike objekt gjykimi rregullohet nga dispozitat e ligjit nr. 52/2013 [..] Në zbatim

të nenit 3 pika 1 germa “a” të KPA dhe nenit 2 pika 2 të ligjit nr.49/ 2012, Kolegji vlerëson se vendimi nr. 02, datë 24.02.2015 përbën shprehje të vullnetit nga organi publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, i cili ka shuar marrëdhënien e shërbimit civil që në këtë datë dhe rrjedhimisht ka qenë i kundërshtueshëm në gjykatë që në momentin që paditësi ka marrë dijeni për këtë akt.

Kolegji vlerëson se në rastin e përfundimit të marrëdhënieve në shërbimin civil për shkak të ristrukturimit sipas nenit 50 të ligjit nr. 152/2013, afati i ngritjes së padisë për të kundërshtuar këtë vendim është brenda 45 ditëve nga data e njoftimit të aktit administrativ, në zbatim të nenit 18 pika 1 gërma “b” e ligjit nr.49/ 2012. Kolegji vlerëson se afati 45 ditor që parashikohet në nenin 18 të ligjit nr. 49/2012 është afat ligjor për kryerjen e veprimit procedural të paraqitjes së padisë në gjykatë, që duhet vlerësuar me kujdes nga gjykatat më të ulta, si një specifikë e gjykimit administrativ dhe një nga parakushtet për ngritjen e padisë administrative, e cila normohet nga e drejta publike dhe passjell dekadencën e të drejtës, nëse nuk është ushtruar në afat. Kolegji vlerëson se marrëdhënia juridike e shërbimit civil është një marrëdhënie e posaçme, sepse rregullon të drejtat dhe detyrimet ndërmjet organeve publike dhe nëpunësve të saj. Për shkak të rëndësisë së kësaj marrëdhënie, ligji ka parashikuar që kjo marrëdhënie kërkon qartësi dhe një rregullim të shpejtë të mosmarrëveshjeve. Në këtë kuptim ligji ka parashikuar në nenin 1, pika 2 të tij se marrëdhënia e shërbimit civil është marrëdhënie juridike e natyrës administrative. Subjektet që i nënshtrohen rregullimeve të këtij ligji, të cilët rekrutohen sipas një konkurrimi të hapur në dy faza, të cilët duhet të plotësojnë kritere të caktuara pranimi dhe që, gjatë periudhës së provës, kryejnë një cikël të detyrueshëm trajnimi pranë ASPA-s, janë në dijeni të të drejtave që burojnë nga ky ligj, e konkretisht të së drejtës që mund të ankohen në gjykatë ndaj çdo veprimi apo mosveprimi, që i cenon të drejtat dhe interesat e tij të ligjshme në marrëdhënien e shërbimit civil dhe që kjo e drejtë duhet ushtruar brenda afatit 45 ditor nga marrja dijeni për vendimin apo veprimin e paligjshëm.

Sa më sipër, Kolegji vlerëson se me të drejtë, Gjykata Administrative e Apelit ka vlerësuar se padia e ngritur nga paditësi është ngritur përtej afatit 45 ditor të parashikuar nga neni 18 pika 1 gërma “b” e ligjit nr.49/ 2012 dhe se në rastin konkret nuk mund të aplikohet parashikimi i nenit 18 pika 2 të këtij ligji e për rrjedhojë, padia nuk plotëson kriteret formale të paraqitjes së saj. [...] Prandaj Kolegji vendosi lënien në fuqi të vendimit nr[...], të Gjykatës Administrative të Apelit.



**13. Vendim nr.00-2023-2356,
datë 13.06.2023 (ndërvarrësia: çështje
penale - administrative/disiplinore)**

Maksima: *Procedimi administrativ disiplinor konkurron me atë penal, pasi shpallja e pafajshme e palës paditëse për akuzën penale nuk nënkupton apriori mungesën e përgjegjësisë disiplinore. KAGJL çmon se përgjegjësia administrative është më e gjerë se përgjegjësia penale. Vendimi penal është detyrues për gjykatën që shqyrton pasojat civile, vetëm për faktin nëse vepra ka ndodhur dhe nëse është kryer nga i gjykuari pjesëmarrës në gjykimin penal. Vendimi i pushimit të çështjes penale apo vendimi i pafajësisë nuk ka efekt detyrues në gjykimin civil apo administrativ.*

Fjalë kyçe: *përgjegjësi disiplinore, përgjegjësi administrativ, efekti i vendimit penal*

Decision no. 00-2023-2356, dated 13.06.2023 (interdependence: criminal - administrative/disciplinary case)

Legal principle(s): *Administrative disciplinary proceedings compete with criminal proceedings, as the acquittal of the plaintiff on the criminal charge does not a priori imply the absence of disciplinary liability. The Administrative Chamber considers that administrative liability is broader than criminal liability. The criminal decision is binding on the court examining the civil consequences, only for the fact that the offense occurred and was committed by the defendant participating in the criminal trial. The decision to dismiss the criminal case or the decision of acquittal does not have a binding effect on the civil or administrative trial.*

Keywords: *disciplinary liability, administrative liability, effect of criminal decision*

Rrethanat e çështjes:

Pala paditëse K.J përgjatë periudhës 21.04.2014-28.01.2008, ka punuar në pozicione të ndryshme në strukturat e policisë së shtetit dhe së fundmi ka qenë specialist për krimet [..]

2. Më datë 19.02.2014 [..]nga seksioni i krimit kundër narkotikëve është bllokuar automjeti i markës [..]në të cilën janë gjetur dhe sekuestruar në cilësinë e provës materiale [..] Paditësi ka referuar në seksionin e kartotekës

[..]kallëzim në emër të shtetasës R.Z për vjedhjen e targave të automjetit të saj të markës «Ford Ka», të cilën dhe e ka pajisur me vërtetim përkatës. Në lidhje me këto veprime SHKB [..]ka nisur procedim penal ndaj paditësit dhe ka arrestuar në flagrancë atë për veprën penale të falsifikimit të dokumenteve parashikuar nga neni 186 dhe të shpërdorimit të detyrës parashikuar nga neni 248 të KP.

[..]Me vendimin datë 25.09.2014 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër është vendosur: Pushimin e hetimeve e procedimit penal [..] regjistruar në ngarkim të shtetasit K.J i dyshuar për veprën penale të «Veprimeve që pengojnë zbulimin e së vërtetës», parashikuar nga neni 301 të KP.

Më datë 24.02.2014 ndaj paditësit ka nisur ecuria disiplinore për shkelje të renda në punë, kjo e vërtetuar me shkresën përcjellëse nr. [..], paditësi është pezulluar nga detyra deri në përfundim të ecurisë disiplinore.

Në Përfundim të ecurisë disiplinore [..] me vendim nr. [..] të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit është vendosur masa disiplinore për paditësin “Përfundim nga Policia e Shtetit”.

Komisioni i Apelit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, me vendimin nr. [..]ka vendosur: “Të konsiderojë të motivuar masën disiplinore « Përfundim nga Policia »[..]

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Gjirokastër me vendimin nr. [..]ka vendosur: “*Rrëzimin e kërkesë padisë*”. [..]

Gjykata Administrative e Apelit me vendimin nr. [..]ka vendosur: “Lënien në fuqi të vendimit [..]”. [..]

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji [..]vlerëson se rekursi nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012 [..] **të cilat do ta bënin të cenueshëm vendimin e Gjykatës së Administrative të Apelit.** [..]

Kolegji vëren se, në gjykimin e padisë administrative për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të punës, kur punëdhënësi është një organ i administratës publike neni 17 germa “g” e ligjit nr. 49/2012 të ndryshuar) është ky i fundit që ka detyrimin të provojë ligjshmërinë e veprimeve në marrëdhënien e punës, nga e cila ka lindur mosmarrëveshja, objekt gjykimi. Gjykata Administrative e Apelit ka sqaruar plotësisht rrethanat dhe faktet që lidhen me mosmarrëveshjen objekt gjykimi, duke bërë një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me të. Konkluzioni i Gjykatës Administrative të Apelit është rrjedhojë e një analize tërësore dhe objektive të provave (neni 17 germa “g”, neni 35, neni 37 të ligjit nr. 49/2012 si dhe neni 126 i Kodit të Procedurës Civile).

Sa më sipër, Kolegji arrin në përfundimin se, të gjitha shkaqeve të parashtruara në rekurs, u është dhënë përgjigje në mënyrë shteruese nga ana e Gjykatës Administrative të Apelit, duke i bërë një analizë të hollësishme dispozitave të Kodit të Punës, të cilat rregullojnë mosmarrëveshjen në gjykim. Këto qëndrime bazohen edhe në jurisprudencën e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë. Nga ana tjetër, Kolegji sjell në vëmendje se pjesa e pretendimeve në rekurs që ngre çështje të vlerësimit të provave, del jashtë juridiksionit rishikues dhe ekskluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë. Nëpërmjet rekursit dhe gjykimit në Gjykatën e Lartë nuk mund të pretendohet të rihapet edhe një herë shqyrtimi gjyqësor i provave. Për këtë aspekt të gjykimit shqyrtimi gjyqësor është mbyllur pas shqyrtimit të çështjes në gjykatën e apelit.

Kolegji thekson se pretendimi i palës paditëse, se duhej të pritej mbyllja e procesit penal dhe pastaj të merrej vendimi për largimin nga puna, është i pambështetur ligjërisht. Pra, fakti se pala paditëse i është nënshtruar një procesi penal, nuk ka lidhje me çështjen konkrete dhe për zgjidhjen e saj, pasi çështja penale dhe ajo administrative nuk janë të ndërruara nga njëra tjetra, në rastin objekt gjykimi. Kjo do të thotë se edhe nëse pala paditëse shpallet i pafajshëm në lidhje me akuzën penale, nuk do të thotë se *apriori*, nuk mban përgjegjësi disiplinore administrative, pasi përgjegjësia administrative/civile është më e gjerë se përgjegjësia penale. Për këtë shkak, shkelja e kryer nga ana e paditësit parashikohet si shkelje e rëndë në kuptim të ligjit të posaçëm dhe ai mban përgjegjësi administrative/disiplinore, çka e bën vendimmarrjen e palës së paditur të bazuar në ligj.

Kolegji vlerëson të theksojë se për çështjen objekt gjykimi, gjykata administrative të faktit kanë zbatuar në mënyrë të drejtë kriteret e vlerësimit të përgjegjësisë individuale në rastin e procedimit disiplinor me ato të procedimit penal. Në këtë kuadër, Kolegji vlerëson se janë interpretuar dhe zbatuar drejtë dispozitat e KPP që rregullojnë raportin juridik midis dy proceseve. Në nenin 70 janë rregulluar efektet e vendimit penal në gjykimin civil dhe administrativ, ku është parashikuar se:[..]

Kolegji, vlerëson se, sipas dispozitës së referuar më sipër, vetëm vendimi gjyqësor penal i fajësisë ka efektin e gjësë së gjykuar dhe efektin detyrues jashtë procesit penal me karakter "*erga omnes*". Kjo rezulton nga një interpretim literal dhe logjik të kësaj dispozite, e cila ka parashikuar se vendimi penal është detyrues për gjykatën që shqyrton pasojat civile vetëm për faktin nëse vepra ka ndodhur dhe nëse është kryer nga i gjykuari, i cili ka qenë pjesëmarrës në gjykimin penal. Si

rrjedhojë i është garantuar e drejta për t'u mbrojtur dhe për t'u dëgjuar, para se të gjykohet. Për këtë arsye, konkluzionet e gjykatës penale, për fajësinë, mund t'i kundrejtohen këtij të fundit edhe në gjykimin civil ose administrativ, kur nga fakti i paligjshëm burojnë edhe pasoja juridike të natyrës civile dhe/ose administrative.

Nga një interpretim i kundërt (*a contrario*) i dispozitës, vendimi i pushimit të çështjes penale apo vendimi gjyqësor i pafajësisë, sipas neneve 387 dhe 388 të KPP, nuk ka efekt detyrues në gjykimin civil apo administrativ. [...]Kjo do të thotë se, vërtetimet e faktit apo konkluzionet e arritura nga gjykata penale, në vendimin gjyqësor të pushimit të çështjes penale ose të pafajësisë, të cilat janë të disfavorshme për palën e dëmtuar nga fakti i paligjshëm, nuk janë detyruese për gjykatën që shqyrton pretendimet civile/administrative, për sa kohë, pala e dëmtuar nga fakti i paligjshëm nuk ka qenë pjesëmarrës në gjykimin penal dhe nuk ka pasur mundësi t'i debatojë në një gjykim kontradiktor.

Për sa më sipër, [...] Kolegji vlerëson se rekursi nuk përmban shkaqe nga ato që parashikohen në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012, për rrjedhojë duhet të vendoset mospranimi i tij.



**14. Vendim nr.00-2024-160,
datë 16.01.2024 (moskonfirmim
statusi nëpunësi civil: vlerësim
i rezultateve në punë)**

Maksima: Përfundimi i marrëdhënies së shërbimit civil mund të vijë për shkak të lirimit ose largimit të nëpunësit civil. Lirimi i nëpunësit nga shërbimi civil bëhet për shkaqe të parashikuara shprehimisht në ligj, të ndryshme nga shkeljet disiplinore për të cilat gjen zbatim largimi nga shërbimi civil. Kur lirimi nga shërbimi civil vjen për shkak të moskonfirmimit të nëpunësit në detyrë, gjykata kompetente duhet të hetojë dhe identifikojë shkakun e moskonfirmimit të nëpunësit civil. Kështu, gjykata duhet të vlerësojë *proporcionalitetin* e ndërprerjes së marrëdhënies në shërbimin civil, në raport me vlerësimet e rezultateve në punë të nëpunësit civil.

Fjalë kyçe: kohë prove, moskonfirmim nëpunës civil, lirim nga shërbimi civil, largim nga shërbimi civil

Decision no. 00-2024-160, dated 16.01.2024 (non-confirmation of civil servant status: evaluation of work performance)

Legal principle(s): *The termination of the civil service relationship may occur either through the discharge or the dismissal of the civil servant. A civil servant may be discharged from the civil service only on grounds expressly provided by law, which are distinct from disciplinary breaches, in respect of which the appropriate measure is dismissal from the civil service. Where the discharge from the civil service results from the failure to confirm the civil servant in office, the competent court must examine and identify the underlying reasons for the failure to confirm the civil servant. In doing so, the court is required to assess the proportionality of the termination of the civil service relationship in light of the civil servant's performance evaluations.*

Keywords: *probationary period, non-confirmation of civil servant, discharge from the civil service, dismissal from civil service*

Rrethanat e çështjes:

Paditësja E.I, në përfundim të një procedure konkurrimi, [...] është pranuar në shërbimin civil në periudhë prove në detyrën e Përgjegjëses së [...]. [...] Në përfundim të vitit 2013, është bërë vlerësimi i paditëses [...], ku ajo rezulton të jetë vlerësuar me 2 = mirë. Me datë 17.05.2014, eprori [...] ka bërë vlerësimin e saj për periudhën 1 vjeçare 2013-2014, ku [...] ajo rezulton të jetë vlerësuar me 3 = përgjithësisht mjaftueshëm.

Me vendimin nr. [...] “Për periudhën e provës” është vendosur zgjatja e periudhës së provës deri në 6 muaj të tjerë, me argumentin se paditësja nuk ka treguar aftësitë e duhura në drejtimin e sektorit ku punonte [...]. Në përfundim të afatit të shtyrë të provës, me datë 17.11.2014, është bërë vlerësimi i punës dhe [...] është vlerësuar me 4 = jo kënaqshëm.

Me vendimin nr. [...] vendimin nr. [...] “Për lirim nga shërbimi civil të një nëpunësi” të Sekretarit të Përgjithshëm, është vendosur: “Lirim nga shërbimi civil të znj., [...] pas vlerësimit “jo kënaqshëm, për mosrealizimin e objektivave dhe jashtë cilësisë së kërkuar [...]”

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr[...] ka vendosur: “Pranimin e kërkesë padisë. Shfuqizimin e vendimit nr. [...] “Për lirim nga shërbimi civil”, [...] Detyrimin e palës së paditur Prokurorisë së Përgjithshme të rikthejë paditësen në vendin e mëparshëm të punës si [...]. Detyrimin e palës e paditur Prokurorisë së Përgjithshme t'i paguaje paditëses pagën nga moment i ndërprerjes së marrëdhënieve

financiare deri në momentin e rikthimit të saj në vendin e punës. Detyrimin e palës e paditur Prokurorisë së Përgjithshme t'i paguaje paditëses pjesën e mbetur të lejes vjetore të paezauruar prej saj...". [..]

Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. [..] ka vendosur: *"Ndryshimin e vendimit nr. [..]. Rrëzimin e padisë si të pabazuar në ligj...". [..]*

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji [..] vlerëson se rekurset përmbajnë shkaq nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012 [..] të cilat bëjnë të cenueshëm vendimin nr. [..] të Gjykatës Administrative të Apelit. [..]

Kolegji konstaton se Gjykata Administrative e Apelit [..] ka interpretuar në mënyrë jo të drejtë ligjin material duke rivlerësuar ndryshe provat, ç'ka dukshëm ka ndikuar në dhënien e vendimit përfundimtar nga ana e saj, pasi nuk ka garantuar një hetim të plotë dhe të gjithanshëm të çështjes në përputhje me parashikimet e posaçme të ligjit nr. 2013/152 në kohë prove. [..]

Konstatohet se vendimi nr. [..] ka dalë në mbështetje të nenit 24 "periudha e provës", e ligjit nr. 152/2013, si dhe VKM nr. 143, datë 12.03.2014. [..] Në nenin 67, të ligjit nr. 152/2013 parashikohet: [..]

Rezulton se paditësja, në kuptim të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, ishte nëpunëse civile në periudhë prove, e cila rezulton të jetë shtyrë me vendimin [..], të palës së paditur, deri në 6 muaj të tjerë, sipas nenit 24 të ligjit nr. 152/2013, pika 3, shkronja (b), e cila parashikon se në fund të periudhës së provës, institucioni, ku nëpunësi është i emëruar, vendos, ndër të tjera, *zgjatjen e periudhës së provës një herë të vetme, deri në 6 muaj të tjerë, nëse për arsye të justifikuara ka qenë i pamundur vlerësimi i plotë i nëpunësit.*

Nga përmbajtja e vendimit nr. [..] të palës së paditur rezulton se shkak i shtyrjes së periudhës së provës ka qenë se pala paditëse nuk ka treguar aftësitë e duhura në drejtimin e sektorit ku ishte caktuar, duke renditur mangësitë në kryerjen e detyrës. Afati gjashtë muajor sipas këtij akti, rezulton t'i jetë dhënë palës paditëse me qëllim angazhimit të palës paditëse në përmbushjen e detyrave. Përmes shkresës nr. [..] të palës së paditur rezulton të jetë kërkuar moskonfirmimi i statusit për paditësen, për shkak të mangësive profesionale.

Referuar shkakut ligjor të kërtimeve të palës paditëse në proces, arrihet në konkluzionin se jemi para një mosmarrëveshjeje që ka lindur si pasojë e zgjidhjes së marrëdhënies së punës midis paditëses dhe anës së paditur, mosmarrëveshjeje kjo që rregullohet nga ligji nr.152/2013 [..]

Nisur nga rëndësia e madhe që paraqet respektimi dhe mbrojtja e interesave të nëpunësve civilë që punojnë në administratën publike, si dhe nisur nga fakti që ata të mos bëhen pre e abuzimit nëpërmjet largimit të tyre të padrejtë, u miratua ligji nr.152/2013 që kishte si qëllim përcaktimin e rregullave të njëjta për kushtet dhe procedurat e pranimit në shërbimin civil, për mënyrën e fillimit dhe mbarimit të marrëdhënieve të punës, për zhvillimin e karrierës, për garantimin e të drejtave dhe përcaktimin e detyrimeve të nëpunësve civilë, për vlerësimin e ecurisë në punë, me synim krijimin e një shërbimi civil të qëndrueshëm, profesional dhe eficient. (*shih vendimi nr. 31003-02536-00-2015, datë 11.07.2017, i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë*).

Lirimi nga detyra i një nëpunësi civil, ashtu edhe largimi nga shërbimi civil në kuadrin e një mase disiplinore, janë forma të ndërprerjes së marrëdhënies së punës në shërbimin civil. Ndryshimi ndërmjet tyre, qëndron në faktin se lirimi nga shërbimi civil nuk jepet në kuadrin e një mase disiplinore siç parashikohet në nenin 63/b të këtij ligji. Pra, lirimi i një nëpunësi civil bëhet për shkaqe të parashikuara shprehimisht në ligj, të cilat janë të ndryshme dhe të pavarura nga shkeljet disiplinore. Ndërsa, për sa i përket largimit të nëpunësit civil nga shërbimi civil, vlen të theksohet se ndërprerja e marrëdhënies së punës në këtë rast bëhet në kuadrin e dhënies së një mase disiplinore të rëndë, që merret ndaj nëpunësit civil, vetëm në rastin kur ky kryen veprime të kundërligjshme, të cilat cenojnë rëndë parimet e shërbimit civil.

Konstatohet se vendimi nr. [...] për lirimin nga shërbimi civil të paditëses, ka ardhur si rezultat i vlerësimit “jo kënaqshëm” të paditëses për mosrealizim të objektivave në cilësinë e kërkuar. Rezulton se pala paditëse i është drejtuar gjykatës duke kundërshtuar vendimin e lirit të punës nga detyra, me argumentin thelbësor se vlerësimi i saj i punës është kryer në kundërshtim me parashikimet e ligjit dhe akteve nënligjore. Paditësja pretendon shkelje të natyrës procedurale në vlerësim, sikurse edhe shkelje në anën materiale duke i mbështetur kërkimet e saj në nenin 24 të ligjit nr. 152/2013 dhe në VKM nr. 109, datë 26.02.2014[...]

Kolegji vlerëson se Gjykata Administrative e Apelit, duke mos arsyetuar qartazi nuk ka arritur të konkludojë se cili është shkaku i moskonfirmimit në detyrë të palës paditëse. Kjo gjykatë referon se në vendimin nr. [...] për moskonfirmim të nëpunësit, pala e paditur ka konkluduar se paditësja nuk plotëson kriteret për të qenë nëpunës civil. [...] Kolegji konstaton se vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit nuk është koherent në raport me faktet e vëna në themel të shqyrtimit gjyqësor të kësaj çështje. Ajo nuk ka analizuar nëse janë plotësuar kushtet e parashikuara në nenin 24 të

ligjit nr. 152/2013 për moskonfirmimin e nëpunësës. Gjithashtu nuk rezulton të ketë analizuar proporcionalitetin e masës së ndërmarrë nga ana e palës së paditur në ndërprerjen e marrëdhënies së punës në raport me vlerësimet e punës së palës së paditur, për të konkluduar më tej edhe në (pa)bazueshmërinë e padisë objekt shqyrtimi. Këto janë elementë thelbësorë të arsytimit të një vendimi gjyqësor.

Duke marrë në konsideratë vlerësimet e mësipërme, Kolegji konkludon se Gjykata Administrative të Apelit Tiranë duhet të zgjidhë mosmarrëveshjen në themel dhe me qëllim zgjidhjen e drejtë të këtij konflikti gjyqësor, në rigjykim duhet të zbatohen udhëzimet e mësipërme të Gjykatës së Lartë; [...] Kolegji vendosi prishjen e vendimit nr. [...], të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim pranë kësaj gjykate, me tjetër trup gjyqësor.



**15. Vendim nr.00–2024–3688 (108),
datë 12.03.2024 (moskonfirmim statusi
nëpunësi civil: zbatim i parashikimeve të
Kodit të Punës)**

Maksima: Kur, në çastin e zgjidhjes së menjëhershme të marrëdhënies së punës, punëmarrësit nuk i është konfirmuar statusi i nëpunësit civil dhe nuk rezulton e provuar se e ka fituar atë status (si dhe nuk rezulton se janë ushtruar mjetet e duhura ligjore për konfirmimin e tij), pasojat e ndërprerjes së marrëdhënies së punës rregullohen sipas parashikimeve të Kodit të Punës, akti i deklarimit të statusit të punësimit i nxjerrë pas zgjidhjes së kontratës nuk sjell efekt në këtë drejtim.

Fjalë kyçe: moskonfirmim statusi i nëpunësit civil, zgjidhje e marrëdhënies punës, Kodi i Punës.

**Decision no. 00–2024–3688 (108), dated 12.03.2024
(non-confirmation of the civil servant status: application
of provisions of the Labor Code)**

Legal principle(s): When, at the time of immediate termination of the employment relationship, the employee's status as a civil servant has not been confirmed and it is not proven that he has acquired that status (and it does not appear that the appropriate legal means for its confirmation have been exercised), the consequences of the

termination of the employment relationship are regulated according to the provisions of the Labor Code, the act of declaration of employment status issued after the termination of the contract does not bring effect in this regard.

Keywords: *non-confirmation of civil servant status, termination of employment relationship, Labor Code.*

Rrethanat e çështjes:

Paditësi L.L., në datën 03.02.2014 është emëruar në detyrën e specialist në [...] Me shkresën me nr. [...], pala e paditur, ka njoftuar paditësin për zhvillimin e takimit në datë 03.10.2014, ora 12.00, për të parashtruar arsyet e vendimit të parashikuar për t'u marrë në lidhje me vijimin e marrëdhënieve të punës.

Me vendimin nr. [...], në zbatim të ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 Kodi i Punës, të ligjit nr.69/2012 "Për arsimin parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të [...] pala e paditur ka vendosur : *"Zgjidhjen e menjëhershme të marrëdhënieve të punës të L.L me detyrë specialist i [...]për arsye të moszbatimit të afateve dhe detyrave të ngarkuara në mënyrë të përsëritur. Ndërprerjen e marrëdhënieve të punës nga data [...]".*

Pasi ishte zgjidhur kontrata e punës, me vendimin nr. [...]nëpërmjet shkresës nr. [...]me lëndë: "Akti i deklarimit të statusit të punësimit", DAP sipas nenit 67 të ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", të Kreut III, pika 2 e VKM nr.116, datë 05.03.2014 "[...] ka konfirmuar se, *"L.L është nëpunës civil në periudhë prove, në pozicionin e specialistit në [...]".*

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. [...], ka vendosur: *"Pranimin e pjesshëm të padisë. Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të veprimtarisë administrative gjatë përfundimit të marrëdhënieve të punës, sipas vendimit [...]duke urdhëruar: Detyrimin e palës se paditur të rikthejë nëpunësin civil, L.L në shërbimin civil, në pozicionin e punës, [...]; Pagimin e pagës deri në momentin e rikthimit në punë sipas këtij vendimi, si zhdëmtim i pasojave ekonomike të pësuar [...]".*

Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. [...]ka vendosur: *"Ndryshimin e vendimit nr. [...]: Pranimin e pjesshëm të padisë; Detyrimin e palës së paditur që t'i paguajë paditësit 6 (gjashtë) paga dëmshpërblim për zgjidhjen e kontratës në mënyrë të menjëhershme dhe pa shkaqe të justifikuara, 1 (një) pagë mujore për shkak të mosrespektimit të afatit të njoftimit sipas përcaktimeve të nenit 143 të Kodit të Punës, 2 (dy) paga për shkak të mosrespektimit të procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës sipas nenit 144 të Kodit të Punës; Rrëzimin e padisë për pjesën tjetër si të pabazuar në prova dhe në ligj [...]".* [...]

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji [...] vlerëson se vendimi nr. [...] i Gjykatës Administrative të Apelit, lidhur me natyrën e marrëdhënieve të punës dhe dispozitave ligjore që e kanë rregulluar atë në çastin e përfundimit të tyre, është marrë në zbatim të drejtë të ligjit material. Bazuar në këtë analizë, si dhe në respektim të shkaqeve të ngritura në rekursin e paditësit, ky Kolegj çmon se vendimi i mësipërm duhet të lihet në fuqi.

Kodi i Punës, në nenin 4 të tij, parashikon zbatimin *ratio personae* të dispozitave të tij, duke sanksionuar se në zbatim të parimit të subsidiaritetit, dispozita të veçanta të tij do zbatohen edhe ndaj personave punësimi i të cilëve rregullohet me ligj të veçantë. Ky parim garanton sigurinë juridike të punëmarrësit në çdo element i marrëdhënies së punës do rregullohet sipas ligjit edhe në rastet e boshllëkut ligjor në ligjin e posaçëm.

Pala paditëse është emëruar në datë 03.02.2014 përkohësisht në Specialistit të personeli në sektorin [...]. Rezulton se paditësi ka pretenduar zbatueshmërinë e ligjit nr.152/2013 duke pretenduar se është nëpunës në periudhë prove. Ndryshe nga sa pretendohet në rekurs, nga aktet rezulton se pala paditëse nuk ka fituar statusin e nëpunësit civil.

Kolegji, tej arsyetimit të Gjykatës Administrative të Apelit, vlerëson se marrëdhënia e punës e palës paditëse nuk ka gjetur rregullim as në ligjin nr.152/2013 dhe as në ligjin nr.8549/1999. Në mbështetje të nenit 67/4, të ligjit nr.152/2013 përcaktohet se nëpunësit ekzistues që janë të punësuar në pozicione, pjesë të shërbimit civil, janë nëpunës në periudhë prove dhe për ta zbatohet neni 24 i ligjit nr.152/2013, ku periudha e provës fillon nga koha e shtrirjes së efekteve të këtij ligji. Në vijim neni 67/6, i këtij ligji përcakton se deklarimi i statusit të punësimit sipas këtij ligji bëhet nga njësia përgjegjëse pas verifikimit të statusit të punësimit, ku në rastin konkret është bërë pasi paditësit i është zgjidhur kontrata e punës nga ana e punëdhënësit. Zgjidhja e menjëhershme e marrëdhënieve të punës të paditësit është bërë me vendimin nr. [...] të palës së paditur, ndërkohë që “Akti i deklarimit të statusit të punësimit”, është konfirmuar nga DAP, me shkresën nr. [...]

Në këtë kuadër vlerësohet se palës paditëse nuk i është konfirmuar statusi i marrëdhënies së punës dhe nuk rezulton e provuar se janë ushtruar mjetet e duhura ligjore në këtë drejtim, për rrjedhojë Kolegji konstaton se pasojat e ndërprerjes faktike të marrëdhënies së punës së palës paditëse rregullohen sipas parashikimeve të Kodit të Punës.

Sa i përket shkaqeve të parashtruara në rekurset e palëve ndërgjyqëse, asnjë prej palëve nuk kanë ngritur pretendimet në rekurs lidhur me disponimin nga Gjykata Administrative e Apelit, tej kërkimeve të padisë. [...]

Kolegji vendosi lënien në fuqi të vendimit nr. [...]të Gjykatës Administrative të Apelit.



**16. Vendim nr.00-2025-1529 (180),
datë 30.04.2025 (status nëpunësi civil:
heqja dorë me shkrim nga rikthimi në
detyrë)**

Maksima: *Heqja dorë me shkrim nga rikthimi në detyrë dhe përfitimi vetëm i pagave të prapambetura sjell humbjen e statusit të nëpunësit civil pas kalimit të afatit ligjor të ruajtjes së këtij statusi. Çdo emërim i mëvonshëm në shërbimin civil, i bërë pa procedurën e konkurrimit përbën cenim të hapur të ligjit dhe e bën aktin e emërimit haptazi të paligjshëm.*
Fjalë kyçe: *heqje dorë nga rikthimi në detyrë, ekzekutim i vendimit të KSHC/gjykatës, afate ligjore, ruajtje e statusit.*

Decision no. 00-2025-1529 (180), dated 30.04.2025 (civil servant status: written waiver of reinstatement)

Legal principle(s): *A written waiver of reinstatement coupled with a request to receive only the outstanding salary arrears results in the loss of civil servant status upon the expiry of the statutory period during which that status is preserved. Any subsequent appointment to the civil service made without undergoing the competitive recruitment procedure constitutes a manifest violation of the law and renders the appointment decision manifestly unlawful.*

Keywords: *waiver of reinstatement, execution of the decision of the CSC/court, legal deadlines, preservation of status.*

Rrethanat e çështjes:

Paditësja V.K, ka qenë e punësuar pranë Drejtorisë Rajonale të Tatimeve (DRT) Tiranë. Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, bazuar në vendimin e komisionit të disiplinës, me vendimin nr. [...]ka vendosur largimin e paditëses nga shërbimi civil. Paditësja e ka ankimuar këtë vendim pranë Komisionit të Shërbimit Civil (KSHC), i cili me vendimin nr. [...]ka vendosur: “Pranimin e ankesës së znj., duke shfuqizuar aktin administrativ nr [...], për shkak të moszbatimit të procedurave administrative disiplinore. Kthimin e ankueses në pozicionin e mëparshëm të punës, inspektore në

[..]dhe pagimin e pagës për të gjithë kohën e qëndrimit padrejtësisht pa punë, duke filluar nga moment i ndërprerjes së marrëdhënieve financiare deri në ekzekutimin e këtij vendimi. [...]” Pas ankimit të ushtruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. [...], ka vendosur: “Rrëzimin e padisë [...]” Gjykata e Lartë me vendimin nr. [...]ka vendosur: “Mospranimin e rekursit të paraqitur [...]”

[..]. Gjatë fazës së ekzekutimit të këtij vendimi, pala paditëse, në datën 02.05.2008 ka paraqitur pranë Drejtorisë së [...]një deklaratë me shkrim, se “... duke filluar që nga sot heq dorë nga fillimi i punës në DPT dhe kërkoj të zbatohet vendimi për tu dëmshpërblyer për kohën e qëndrimit pa punë.”

Sipas shkresës nr. [...], rezulton të jetë ekzekutuar vendimi i mësipërm, duke paguar në favor të paditëses shumën prej 939,060 lekë. [...]

Paditësja në datën 24.10.2013 i është drejtuar DPT me kërkesë [...] për të kandiduar pranë administratës tatimore për t’u rikthyer në punë. Në vijim, paditësja ka paraqitur një deklaratë datë [...]duke deklaruar se në zbatim të vendimit të gjykatës, heq dorë nga e drejta e kthimit të pagës që ka mbetur pa u ekzekutuar nga DPT. Drejtori [...] me vendimin nr [...], ka vendosur emërimin e paditëses inspektore e dytë [...] në zbatim të vendimit nr. [...]të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Në vijim, Drejtori [...]me vendimin nr. [...]“Për revokim të aktit administrativ” ka vendosur: “Revokimin e aktit administrativ, vendimin nr [...]“Për emërim në detyrë” të [...], pasi ky urdhër ekzekutimi është ekzekutuar tërësisht sipas shkresës nr. [...], të DPT. Në këto kushte, vendimi nr. [...]i DPT është i pavlefshëm dhe i pazbatueshëm si dhe bie ndesh me dispozitat ligjore të sipërcituara. Me revokimin e këtij vendimi përtërihen fuqitë ligjore të aktit nr. [...]“pagesë dëmshpërblimi, ekzekutim vendime gjyqësore”. Znj. V.K ti kthejë Drejtorisë shumën e përfituar me të padrejtë nga data 06.01.2014 deri më sot.”

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. [...], ka vendosur: “Rrëzimin e padisë si të pabazuar në ligj dhe në prova.”

Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. [...], ka vendosur: “Lënien në fuqi të vendimit [...]”

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. [...] ka vendosur: “Prishjen e vendimit nr. [...]të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim po asaj gjykate me tjetër trup gjykues.”

Gjykata Administrative e Apelit, pas (ri)shqyrtimit të çështjes në seancë gjyqësore, me vendimin nr. [...], ka vendosur:

“Ndryshimin e vendimit nr. [...]Pranimin e pjesshëm të padisë. Konstatimin e pavlefshmërisë së aktit administrativ – vendimit nr. [...] Detyrimin e palës së paditur t’i paguajë paditëses Vojsava Kote pagën që do të kishte marrë në pozicionin e punës së emëruar me vendimin nr. 1, datë 06.01.2014 të Drejtorisë së Përgjithshme nga dita e ndërprerjes së pagës deri në datën e daljes në pension të paditëses; Rrëzimin e padisë në lidhje me kërkimet e tjera.” [...]

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji [...] vlerëson se rekursi i palës së paditur, përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012, të cilat e bëjnë të cenueshëm vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit dhe mbi këtë bazë, duhet të lihet në fuqi vendimmarrja e gjykatës administrative të shkallës së parë, që ka disponuar për rrëzimin e padisë.

[...] Kolegji vëren, se Gjykata Administrative e Apelit, në vendimin objekt rekursi, nuk ka identifikuar drejt marrëdhënien juridike në konflikt e për pasojë dhe zgjidhja e dhënë prej saj është e gabuar. Kjo gjykatë, në thelb është shprehur, se paditësja është rikthyer në punë për shkak të zbatimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, ajo (paditësja) gëzonte statusin e nëpunësit civil dhe për dhënien e masës disiplinore ndaj saj, pala e paditur nuk ka ngritur komisionin disiplinor.

Kolegji vëren, se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me masë disiplinore të dhënë ndaj një nëpunësi civil (paditëses), sikundër është orientuar gjykimi nga Gjykata Administrative e Apelit, por kemi një akt të palës së paditur DPT, me anë të cilit ajo (pala e paditur) ka revokuar aktin e emërimit në detyrë të paditëses. Kolegji vlerëson, se pala e paditur me aktin objekt gjykimi, ka vepruar në përputhje të plotë me ligjin, pasi ka konstatuar se emërimi i paditëses vinte në kundërshtim me legjislacionin për nëpunësin civil, kjo pasi vendimi i KSHC/gjykatës, që shërbeu si shkak për emërimin e paditëses në detyrë, ishte ekzekutuar më herët prej palës së paditur.

Kolegji vlerëson, se pala e paditur me të drejtë e ka konsideruar si të përmbushur (ekzekutuar) vendimin e KSHC, kjo sipas shkresës nr. [...] të DPT, ku kjo e fundit ka paguar në favor të palës paditëse pagat deri në momentin kur paditësja ka paraqitur kërkesën për heqje dorë nga rikthimi në punë, si pjesë e ekzekutimit të vendimit të KSHC, dhe më pas, përmbaruesi ka vendosur pushimin e ekzekutimit. KPC, në kohën kur është ekzekutuar vendimi i KSHC në favor të paditëses, neni 616 parashikonte: [...] Ndërsa neni 617 i KPC, parashikonte: [...]

Referuar dispozitave të mësipërme të ligjit procedural, vendimi i KSHC

konsiderohet i përmbushur (ekzekutuar), jo vetëm thjesht për faktin se kreditori (paditësja) ka hequr dorë me kërkesë (shkresë) nga ekzekutimi, por se pala paditëse, pas heqjes dorë nga ekzekutimi i vendimit të KSHC, nuk ka bërë kërkesë të re për ekzekutim, brenda kohës së parashkrimit të ekzekutimit të vendimit të KSHC/gjykatës, referuar nenit 617(3) të KPC. Për rrjedhojë, nuk ka vend që vendimi i KSHC/gjykatës të konsiderohet i pa ekzekutuar, pasi ky vendim (gjyqësor) nuk rrjedh (nuk është i lidhur) nga padi, për të cilat nuk zbatohet parashkrimi.

Mbi këtë bazë, pala paditëse në vitin 2013, kur ka paraqitur kërkesën për t'u punësuar pranë palë së paditur, nuk e mbante (gëzonte) statusin e nëpunësit civil dhe me të drejtë është konstatuar nga pala e paditur, se emërimi i saj në detyrë me vendimin nr. 1, datë 06.01.2014, është bërë në kundërshtim me legjislacionin për nëpunësin civil. Kolegji vëren, se legjislacioni që normon marrëdhëniet juridike për nëpunësit civilë, ka parashikuar një afat kohor për ruajtjen e statusit të nëpunësit civil në favor të nëpunësit (punonjësit), që nuk ushtron një detyrë konkrete. Sipas ligjit nr. 8549/1999, (neni 23) është parashikuar afati 1 vit për ruajtjen e statusit nga nëpunësi, ndërsa ligji aktual në fuqi, ligji nr. 152/2013, ka parashikuar afatin 2 vjet për ruajtjen e statusit (nenet 50, 55, 64). Në këtë kuptim, është e qartë se paditësja nuk mund të ruante statusin e nëpunësit civil nga viti 2008, kur është ekzekutuar vendimi i KSHC/gjykatës, deri në vitin 2014, kur paditësja gabimisht është emëruar në detyrë nga pala e paditur.

Paditësja, duke mos pasur statusin e nëpunësit civil, nuk mund të emërohej në një pozicion pune, që rregullohej sipas ligjit për nëpunësin civil dhe që emërimi kryhej vetëm pas zhvillimit të procedurave të konkurrimit. Rekrutimi dhe emërimi i nëpunësve civilë nëpërmjet procedurave të konkursit, është një proces shumë i rëndësishëm, i parashikuar nga Kushtetuta neni 107(2), si dhe ligji që rregullon marrëdhëniet e shërbimit civil. Ky proces nuk është thjesht një parashikim formal ligjor, por se ka për qëllim krijimin e një shërbimi civil të qëndrueshëm, profesional, të bazuar në meritë, transparencë, profesionalizëm, integritet moral dhe paanësi politike.

Emërimi i nëpunësit civil duke zbatuar procedurat (konkurrim) e parashikuara nga ligji i shërbimit civil, është një detyrim ligjor për organet publike. Çdo emërim pa zbatuar këto procedura, bie në kundërshtim me ligjin dhe si i tillë, referuar ligjit aktual në fuqi, është parashikuar si një nga rastet e përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil. [..]

Mbi këtë bazë, pala e paditur, pasi ka konstatuar emërimin e paligjshëm të paditëses në detyrë, ka nxjerrë aktin objekt gjykimi, duke e korrigjuar këtë situatë paligjshmërie, në lidhje me emërimin e paditëses si nëpunëse

civile. Kolegji vlerëson, se vendimi i palës së paditur objekt gjykimi, pavarësisht formës dhe emërimit të tij (si akt), është një vendim i nxjerrë në përputhje me ligjin. Vullneti dhe qëllimi i ligjshëm i palës së paditur, është mjaftueshmërisht i qartë, përballë faktit të konstatuar se paditësja nuk gëzonte statusin e nëpunësit civil dhe se akti i emërimit të saj (paditëses) si nëpunëse civile, kishte dalë në kundërshtim flagrant me ligjin. Në rastin konkret, organi publik që ka nxjerrë aktin e emërimit në kundërshtim me ligjin, me nismën e tij ka konstatuar paligjshmërinë dhe në zbatim të detyrimeve ligjore, ka vepruar, duke nxjerrë aktin objekt gjykimi.

Kriteret ligjore për t'u punësuar në shërbimin civil dhe zbatimi i procedurave ligjore për këtë qëllim, nga organet shtetërore, janë kërkesa legjitime dhe përbëjnë detyrim ligjor për këto organe. Çdo punësim (emërim) në shërbimin civil në kundërshtim me kërkesat e ligjit, siç ka ndodhur në rastin e emërimit të paditëses, do të përbënte cenim të hapur të ligjit dhe të parimeve mbi bazën e të cilave është ndërtuar dhe udhëhiqet shërbimi civil dhe një (mos)zbatim i tillë i ligjit, e bën aktin e emërimit haptazi të paligjshëm. Mbi këtë bazë, Kolegji vlerëson, se qëndrimi i mbajtur nga Gjykata Administrative e Apelit, për zgjidhjen e çështjes, është në një linjë të gabuar arsyetimi që nuk përputhet me parashikimet e legjislacionit për shërbimin civil. [...] Kolegji vendosi prishjen e vendimit nr. [...], të Gjykatës Administrative të Apelit dhe lënien në fuqi të vendimit nr. [...], të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.



**17. Vendim nr.00-2025-2351 (255),
datë 18.06.2025 (largim nga shërbimi
civil: nxjerrja e vërtetimit tatimor, tejkallim
flagrant kompetence)**

Maksima: *Nxjerrja e një vërtetimi nga nëpunësi civil pa autorizim të titullarit dhe në tejkallim flagrant të kompetencave, në favor të një shoqërie tregtare për pjesëmarrje në procedurë tenderimi, e shoqëruar me pasojën e cenimit të besimit të publikut në integritetin e procedurave të tenderimit, legjitimon marrjen e masës disiplinore “Largim nga shërbimi civil”, si masë e justifikuar dhe proporcionale, për shkak të natyrës së pasojës së krijuar.*

Fjalë kyçe: *masë disiplinore, vërtetim për detyrime tatimore, tejkallim flagrant kompetence*

Decision no. 00-2025-2351 (255), dated 18.06.2025 (dismissal from civil service: issuing a tax certificate, flagrant excess of competence)

Legal principle(s): *The issuing of a certificate by a civil servant without the authorisation of the competent authority and in flagrant excess of their statutory powers, in favor of a commercial company for participation in a tender procedure, where such conduct undermines public confidence in the integrity of the procurement procedures, legitimises the imposition of the disciplinary sanction of "Dismissal from civil service", as a justified and proportional measure, due to the nature of the consequence created.*

Keywords: *disciplinary measure, tax liability certificate, flagrant excess of competence*

Rrethanat e çështjes:

Paditësi A.N, ka qenë në shërbimin civil, në administratën tatimore, pranë palës së paditur [...], nga data 16.11.2006 deri në datën 18.09.2015. [...] Me shkresën nr. [...] Drejtoria e Investigimit të Brendshëm (Antikorrupsion), [...], i është drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, duke propozuar fillimin e ecurisë disiplinore, për disa punonjës të Drejtorisë Rajonale Tatimore Kukës, ndër ta edhe për paditësin, [...]. Sipas kësaj shkrese, punonjësit e Drejtorisë, kanë lëshuar një vërtetim për tender për një subjekt, në kundërshtim me procedurën ligjore dhe duke mos pasqyruar realitetin, si dhe pas kërkesës së organit publik që ka kryer tenderimin kanë konfirmuar mungesën e detyrimeve tatimore për subjektin, duke mos pasqyruar realitetin. Nga investigimi i kryer, për subjektin përkatës, për periudhën që bën fjalë vërtetimi për tender, që kanë lëshuar punonjësit e [...], kanë rezultuar detyrime tatimore të pashlyera. [...] Sipas shkresës së mësipërme, vërtetimi për tender për subjektin, është lëshuar nga Drejtoria e Vlerësimit dhe jo nga Sektori i Shërbimit të Tatimpaguesve, nëpërmjet shkresës nr. [...]. Ky vërtetim është konceptuar nga inspektori A.N sipas urdhrit verbal të paditësit, pa patur kërkesë nga subjekti dhe pa e patur një kompetencë të tillë, pasi vërtetimi për tender lëshohet nga Sektori i Shërbimit të Tatimpaguesve. [...] Mbi bazën e propozimit të mësipërm të [...] me shkresën nr. [...], të palës së paditur, drejtoresha e përgjithshme e tatimeve, ka filluar ecurinë disiplinore për paditësin, duke e trajtuar shkëljen e mësipërme si shkëlje disiplinore në lidhje me "moszbatimin e dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale". [...] Në përfundim të shqyrtimit disiplinor, Komisioni i Disiplinës, me vendimin

nr. [...], ka shqyrtuar shkeljen disiplinore “Moszbatim i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale”, dhe ka vendosur marrjen e masës disiplinore “Largim nga shërbimi civil” për paditësin. [...]

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër me vendimin nr. [...] ka vendosur: *“Pranimin e kërkesë padisë në këtë mënyrë: Shfuqizimin e aktit administrativ, vendimit [...], që ka dhënë për paditësin, [...] masën disiplinore “Largim nga shërbimi civil”. Detyrimin e palës së paditur, për të kthyer paditësin, në detyrën drejtor i drejtorisë [...], ose në një detyrë të barasvlershme me të. Detyrimin e palës së paditur, për t’i paguar paditësit, pagën që ka përfituar në momentin e largimit nga shërbimi civil, nga dita e largimit deri në ripranimin në shërbimin civil. [...]”*. [...]

Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. [...], vendosi: *“Lënien në fuqi të vendimit nr. [...]”*. [...]

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji [...] vlerëson se rekursat përkatëse përmbajnë shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr.49/2012 [...] të cilat e bëjnë të cenueshëm vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit dhe të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, duke diktuar ndryshimin e tyre dhe rrëzimin e padisë, si pasojë e interpretimit jo të drejtë të ligjit material të zbatueshëm në rastin konkret, ligjin nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, konkretisht natyrës së shkeljes disiplinore të palës paditëse si nëpunës civil, si dhe proporcionalitetit të masës disiplinore “largim nga shërbimi civil” me natyrën e shkeljes. [...]

Në këto rrethana sikurse në shkallët më të ulta të gjykimin, Kolegji vlerëson të marrë në shqyrtim faktin nëse me kryerjen e veprimeve të tilla paditësi ka kryer apo jo shkelje disiplinore në kuptim të parashikimeve të nenit 57 të ligjit nr. 2013/152, si dhe të cilës natyrë konsiderohen ato në ballafaqim me interpretimin e duhur të parashikimeve në këtë ligj.

Kolegji, në sintezë të rrethanave të faktit, arrin në të njëjtin përfundim sikurse Gjykata Administrative e Apelit se, përpilimi i akteve dhe verifikimi i të dhënave që lidhen me subjektet tatimpagues për efekt të lëshimit të këtyre akteve, nga personi i papajisur me tagrin ligjor për të kryer një veprim të tillë, është veprim në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës, që ngarkojnë me përgjegjësi paditësin. Konkretisht, paditësi ka vepruar në kundërshtim me parashikimet e ligjit nr. 9131 datë 08.09.2003 *“Për rregullat e etikës në administratën publike”*, të detyrueshme për t’u zbatuar nga të gjithë nëpunësit e administratës publike (sipas parashikimit të nenit 2). Paditësi ka shkelur një prej parimeve të këtij ligji, atë të

parashikuar në nenin 3 të këtij ligji, që [..]. Gjithashtu, neni 43 i ligjit nr. 152/2013, në pikën 2 të tij parashikon se[..]

Megjithatë, në ndryshim nga gjykata e apelit që shkeljet e paditësit i ka konsideruar në kuptim të parashikimit të germës “ë” të pikës 3 të nenit 57 të ligjit nr. 152/2013, si shkelje të rënda, Kolegji çmon se paditësi ka kryer shkelje shumë të rënda në kuptim të shkronjës “a” të nenit 57 të këtij ligji. Për rrjedhojë, Kolegji ka vlerësuar se vendimi nr. [..]i palës së paditur, me të cilin është marrë masa disiplinore “*Largim nga shërbimi civil*” për paditësin, është nxjerrë në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 152/2013 lidhur me përcaktimin e kategorisë së shkeljes disiplinore të kryer nga paditësi e për pasojë edhe me masën disiplinore të caktuar ndaj tij. Në referim të neneve 57, 58 dhe 59 të ligjit nr. 152/2013, në rastin objekt gjykimi, referuar vendimmarrjes së palës së paditur, konstatohet se shkaqet që kanë çuar në marrjen e masës disiplinore “*Largim nga shërbimi civil*”, kanë qenë moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale që i përkasin pozicionit të punës në zbatim të procedurave të legjislacionit tatimor, që është vlerësuar nga komisioni disiplinor si shkelje shumë e rëndë e kryer prej paditësit. Ashtu sikurse është arsyetuar edhe më sipër, paditësi me veprimet e kryera prej tij e për të cilat është proceduar disiplinarisht, ka shkelur detyrimet e përcaktuara në ligjin nr. 152/2013, si dhe parashikimet e ligjit nr. 9131 datë 08.09.2003 [..]

Ndërkaq, këto shkelje duket se janë kryer në sfondin e një procedure prokurimi publik (tender), pjesë e së cilës ka qenë një shoqëri tregtare që rezulton të jetë pajisur me një vërtetim nga paditësi, me qëllim për të qenë pjesëmarrës. Eventualisht, dhënia e një vërtetimi në lidhje me pasjen ose jo të detyrimeve tatimore, për një shoqëri tregtare që konkurren në procedura tenderimi për ofrimin e një shërbimi për publikun duke përfutur fonde publike, përbën një element thelbësor për integritetin e kësaj procedure dhe garantimin e barazisë në pjesëmarrjen e operatorëve në këto procedura tenderimi. Integriteti i procedurave të tilla, jo vetëm siguron mirëqeverisjen e buxhetit të shtetit dhe fondeve publike, por garanton miradministrimin e shërbimeve ndaj publikut. Kësisoj, respektimi i procedurave dhe kompetencës për pajisjen e shoqërive tregtare, operatorë konkurrues në procedurat e tenderimit, me dokumentacion vërtetues të raportit të tyre me detyrimet dhe organet tatimore, nga këto të fundit, vlerësohen të kenë ndikim të drejtpërdrejtë në sigurimin e ligjshmërisë dhe ndershmërisë në procedurat e prokurimeve (tenderit). Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se marrja përsipër nga pala paditëse në mungesë të kompetencës ligjore, për të pajisur me vërtetim mbi mospasjen e detyrimeve tatimore të shoqërisë tregtare [..], me qëllim që kjo e fundit të merrte pjesë në një procedurë

tenderimi, përbën jo vetëm shkelje të parimeve etike dhe administrative në hierarkinë e brendshme të organeve tatimore, por vë në rrezik drejtësinë dhe vërtetësinë e rezultateve të tenderit, si dhe ngre pikëpyetje mbi besueshmërinë e publikut në administrimin e buxhetit të tyre dhe shërbimit që presin nga operatorët fitues të kësaj procedure.

Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se marrja ndaj paditësit e masës disiplinore në fjalë gëzon përputhshmëri me ligjin, për shkak se në rastin konkret rezulton se nga ana e paditësit janë kryer veprime të asaj natyre, sa të klasifikohen si shkelje shumë të rënda. Në përcaktimin e masës disiplinore dhe shkeljeve që janë kryer nga paditësi, vlerësohet se pala e paditur ka respektuar parimet për përshkallëzimin dhe individualizimin e masës disiplinore, të përcaktuar në nenin 60 të ligjit në fjalë [...] Në interpretim të kësaj dispozite, Kolegji çmon se gjenden rrethanat që legjitimojnë Komisionin e Disiplinës të ngritur pranë palës së paditur, në marrjen e masës disiplinore për largimin e paditësit nga shërbimi civil. Nxjerrja e një vërtetimi, dokument zyrtar, pa autorizim të titullarit të organit tatimor, në tejkalim flagrant të kompetencave nga paditëse, në favor të një shoqërie tregtare, në kuadër të konkurrimit të saj në një procedurë tenderimi, në sinkron me pasojën e ngritjes së mosbesimit të publikut në integritetin e zhvillimit dhe drejtësisë së procedurave të tenderimit, përbëjnë shkaqe të mjaftueshme që justifikojnë arsyeshëm dhe objektivisht masën më të rëndë disiplinore për paditësin, nëpunës civil. Kjo masë disiplinore kënaqë kërkesat e proporcionalitetit në raport me shkeljet e analizuar. Në kuptim të ligjit nr. 2013/152 *“Për nëpunësin civil”*, largimi nga shërbimi civil i paditësit përkon me ato raste kur ndaj tij, për shkak të shkeljes shumë të rëndë të kryer, nuk mund të aplikohet asnjë prej masave të tjera që janë renditur në mënyrë të përshkallëzuar në dispozitën e sipërcituar. Dhënia e një prej masave të tjera më të lehta disiplinore, të parashikuara në gerrat “b” dhe “c” të nenit 58 të ligjit për nëpunësin civil paditës, Kolegji nuk e vlerëson se do të realizonte funksionin për të cilin vendoset masa disiplinore nga organi i administratës publike, për shkak se pasoja e ardhur në cenim të besueshmërisë së procedurave të tenderimit, nuk do të mund të zhdukej, për shkak të natyrës së kësaj pasoje. Në kuptim të nenit 60, pika 3 të ligjit nr.152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, mospërmbyllja e detyrimeve nga ana e paditësit, ka sjellë pasoja shumë të rënda, për shkak të rëndësisë që ka besimi i publikut në mirëqeverisjen e buxhetit të shtetit në procedurat e tenderimit. [...]

Për sa më lart, referuar ligjit të zbatueshëm, që rregullon marrëdhënien e punës për nga pikëpamja materiale, kërkit të palës paditëse në padi, si dhe shkaqeve të rekursit përkatës, padia duhet të rrëzohet. [...]



**18. Vendim nr.00–2023-3297(279),
datë 12.09.2023 (status nëpunësi civil:
punonjës i administratës doganore)**

Maksima: Zgjidhja e kontratës së punës në administratën doganore, kur punëdhënësi ka respektuar detyrimet ligjore për afatin e njoftimit përmes kompensimit financiar dhe procedurën e parashikuar në Kodin e Punës, nuk konsiderohet zgjidhje e menjëhershme. Punonjësit e administratës doganore nuk gëzojnë statusin e nëpunësit civil dhe nuk përfitojnë institutin e listës së pritjes apo të drejtën e rikthimit në punë.

Fjalë kyçe: administratë doganore, afat njoftimi, zgjidhje e menjëhershme, ristrukturim

Decision No. 00–2023-3297(279), dated 12.09.2023 (civil servant status: customs administration employee)

Legal principle(s): The termination of the employment contract in the customs administration, when the employer has complied with the statutory obligations concerning the notice period by providing payment in lieu of notice and has followed the procedure prescribed by the Labour Code does not constitute summary dismissal. Employees of the Customs Administration do not enjoy the status of civil servants and are therefore not entitled to placement on the waiting list ('lista e pritjes') or to reinstatement.

Keywords: customs administration, notice period, immediate termination, restructuring

Rrethanat e çështjes:

Paditësja A,M ka filluar marrëdhëniet e punës pranë palës së paditur në [...], në detyrën, “programiste në Degën e Doganës Durrës” dhe më tej ka lëvizur në detyra të ndryshme. Me shkresën nr. [...], Drejtori i Përgjithshëm i Doganave i ka propozuar Ministrit të Financave “lirimin e paditëses nga detyra e Zv.Drejtor i Përgjithshëm i Departamentit të Teknologjisë dhe Informacionit”, për arsye ristrukturimi. Me shkresën nr. [...], Ministri i Financave ka miratuar propozimin [...]4. Me anë të shkresës nr. [...], pala e paditur e ka njoftuar paditësen për takim në lidhje me problemet në marrëdhëniet e punës dhe në vijim, në datën 26.12.2013 ora 13:00, janë zhvilluar bisedimet në lidhje me mundësinë e zgjidhjes së kontratës së

punës për shkak të shkurtimit të vendit të punës, bisedime të cilat janë dokumentuar në procesverbalin e kësaj date. [..]

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. [..], ka vendosur: *“Rrëzimin e kërkesë padisë si të pabazuar në ligj dhe në prova [...]”*. [..]

Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. [..], ka vendosur: *“Ndryshimin e vendimit nr. [..] të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Pranimin e pjesshëm të padisë. Detyrimin e palëve të paditura të dëmshpërblejnë paditësen me 12 (dymbëdhjetë) paga mujore për shkak të zgjidhjes së menjëhershme dhe për shkaqe të pajustificuara të kontratës së punës. Rrëzimin për pjesën tjetër të padisë si të pabazuar në prova dhe në ligj [...]”*. [..]

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji [..] vlerëson se rekursi i palës së paditur ngre shkaqe nga ato të përcaktuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012, pasi qëndrimi i mbajtur nga Gjykata Administrative e Apelit është në linjë të gabuar arsyetimi që nuk përputhen me parashikimet e ligjit material dhe si i tillë duhet të priset dhe të lihet në fuqi vendimi nr. [..] i Gjykatës Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, në referim të nenit 63, pika 1, shkronja b) të ligjit nr. 49/2012. [..]

Referuar konkluzioneve unifikuese të vendimit nr.19, datë 15.11.2007 të Kolegjeve të Bashkuara, [..] Ligji ka lënë në dorë të palëve zgjidhjen vetëm me kushtin e respektimit të afatit të njoftimit, pra palët të njoftohen në një periudhë të caktuar (paralajmërimi) përpara zgjidhjes përfundimtare të kontratës, me qëllim që të kenë mundësi të marrin masa për rregullimin e situatës së tyre personale. Gjatë afatit të njoftimit, kontrata e punës është në fuqi, me gjithë faktin që njëra palë ka bërë të ditur zgjidhjen e saj dhe ajo përfundon me përfundimin e afatit të njoftimit. Pasoja e mosrespektimit të afatit të njoftimit të zgjidhjes së kontratës përcaktohet në nenin 143 pika 4 të KP, [..]

Gjatë gjykimit në rastin konkret, të dy gjykatat e faktit kanë pranuar se paditësja ka përfituar 3 muaj pagë për efekt të afatit të njoftimit. Kolegji vlerëson se nëpërmjet pagesës së 3 muajve pagë për efekt të afatit të njoftimit, pala e paditur ka respektuar detyrimin e saj për të njoftuar paditësen brenda afateve të parashikuara nga neni 143/1 i KP dhe kontrata e punës konsiderohet e zgjidhur normalisht, në respektim të nenit 141 të KP. Qëllimi i legjislatorit, për të përcaktuar një afat njoftimi për zgjidhjen e kontratës së punës është që palët të njoftohen në një periudhë të caktuar (paralajmërimi) përpara zgjidhjes përfundimtare të kontratës, me qëllim që të kenë mundësi të marrin masa për rregullimin e situatës

së tyre personale. Kolegji vlerëson se nëpërmjet përfitimit të pagesës së afatit të njoftimit konsiderohet i përmbushur qëllimi për të cilin ligji ka parashikuar një afat njoftimi për zgjidhjen e kontratës dhe rrjedhimisht edhe kontrata e punës konsiderohet e zgjidhur në mënyrë normale, në respektim të neneve 141 e 143 të KP.

Kolegji vlerëson se, me të drejtë Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, ka vlerësuar se kërkesë padia duhet të rrëzohet, pasi ka interpretuar në mënyrë të drejtë ligjin material Kodin e Punës duke vlerësuar se pala paditëse është paguar në zbatim të vendimit nr. [...] të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave për afatin e njoftimit të zgjidhjes së kontratës së punës. Respektimi i kërkesave të nenit 143, 144, 145 të KP nga punëdhënësi, passjell përfundimin në mënyrë të natyrshme të kontratës së punës dhe respektimin e të gjitha të drejtave të paditëses. [...] Kolegji vlerëson se, duke qenë përpara faktit se zgjidhja e kontratës së punës është bërë nga ana e punëdhënësit në mënyrë të ligjshme dhe në respektim të dispozitave të KP, me të drejtë gjykata e shkallës së parë nuk e ka legjitimuar paditësen në kerkimin e saj për të përfituar dëmshpërblimin për përfundimin e marrëdhënies së punës nga ana e punëdhënësit, për arsye se zgjidhja nuk është as në kushtet e zgjidhjes së menjëhershme pa shkaqe të arsyeshme (neni 153 i KP) dhe as në kushtet që zgjidhja e kontratës të jetë bërë për motive abuzive referuar nenit 146 të Kodit të Punës.

[..]

Mendim Pakice

Në ndryshim nga qëndrimi i shumicës, [...] çmoj se vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit është marrë në interpretim të drejtë të ligjit dhe si i tillë duhet të lihet në fuqi. [...] Ndryshe nga shumica, e gjej të drejtë analizën e bërë nga gjykata administrative e apelit, që e ka konsideruar zgjidhjen e kontratës së punës, si të menjëhershme dhe për rrjedhojë, kanë vlerësuar shkaqet e zgjidhjes së saj, në nenin 153 të KP. [...] Në çështjen në shqyrtim diskutohet rasti kur kontrata me kohëzgjatje të pacaktuar është zgjidhur nga punëdhënësi duke respektuar procedurën dhe afatin e njoftimit, pra zgjidhja normale e kontratës pa afat të përcaktuar, që parashikohet në nenin 141 e vijues të KP. [...] Bazuar në përmbajtjen e nenit 141 të KP si dhe në qëndrimin e shprehur në vendimin e mësipërm unifikues, çmoj se, pavarësisht akordimit që punëdhënësi i ka bërë punëmarrëses, duke i dhënë në mënyrë të menjëhershme, edhe pagën që kjo e fundit do të përfitonte nga detyrimi për të respektuar afatin e njoftimit, zgjidhja e kontratës së punës e bërë pa respektuar këtë afat, duhet të trajtohet si zgjidhje e menjëhershme e marrëdhënieve të punës. Kategorizimi i kësaj

zgjidhje nuk lidhet vetëm me nevojën e punëmarrësit për garanci, si pala më e “dobët” në kontratën e punës, që në kushtet e ekonomisë së tregut, duhet të jetë më e mbrojtur përballë punëdhënësit, por edhe me pasoja të tjera që rrjedhin nga vijueshmëria e marrëdhënieve të punës, si p.sh., efekti “surprizë” me pasoja psikologjike për punëmarrësin, llogaritja e vjetërsisë në punë, përfitime të tjera të cilat punëmarrësi do të mund t’i përfitojë, nëse kontrata e punës do të konsiderohej e zgjidhur në përfundim të afatit të njoftimit. [...] Shprehja e vullnetit të punëdhënësit për ta zgjidhur marrëdhënien e punës, jo në përfundim të këtij afati, edhe pse mund t’i ketë akorduar punëmarrësit pagat që ky i fundit do të përfitonte nëse do të respektohej ky afat njoftimi, çmoj se nuk e kategorizon zgjidhjen e kontratës, si zgjidhje e zakonshme duke respektuar afatin e njoftimit.

[...] Për arsyet e sipërcituara, në përfundim të kësaj analize, vlerësoj se vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, është i drejtë, ndaj si i tillë, duhet të lihet në fuqi.



**19. Vendim nr.00-2025-1740 (189),
datë 13.05.2025 (status nëpunësi civil
gjyqësor: procedurë e posaçme verifikimi
nga Këshilli i Gjykatës)**

Maksima: *Statusi i nëpunësit civil gjyqësor nuk fitohet automatikisht (ipso jure), por përfitohet vetëm pas ndjekjes së një procedure të posaçme verifikimi nga Këshilli i Gjykatës, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.*

Fjalë kyçe: *statusi i nëpunësit civil gjyqësor, procedurë e posaçme verifikimi, Këshilli i Gjykatës, Këshilli i Lartë Gjyqësor*

Decision no. 00-2025-1740 (189), dated 13.05.2025 (status of judicial civil servant: special verification procedure by the Judicial Council)

Legal principle(s): *The status of judicial civil servant is not automatically acquired (ipso jure), but is obtained only after following a special verification procedure by the Judicial Council, in accordance with the provisions of Law no. 98/2016 “On the organisation of the judiciary in the Republic of Albania”.*

Keywords: *status of judicial civil servant, special verification procedure, Judicial Council, High Judicial Council*

Rrethanat e çështjes:

Paditësja E.I ka filluar marrëdhëniet e punës pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në shtator 2007 si sekretare gjyqësore, [...] Për periudhën shtator 2014 deri në qershor 2016, ajo ka punuar në pozicionin e sekretares në zyrën e ankimeve dhe rekurseve, [...]

Sipas kontrollit të kryer nga pala e paditur, ka rezultuar se paditësja E.I nuk ka kryer asnjë veprim lidhur me detyrën e ngarkuar, dhe konkretisht nuk ka komunikuar aktet procedurale, rekursset. [...] **është përgatitur një material me shkrim, sipas të cilit kanë rezultuar rreth 300 rekurse të prapambetura, të** pakomunikuara palëve që nga viti 2006 deri në vitin 2015, për të cilat pjesa më e madhe e gjykimeve kanë përfunduar, marrë formë të prerë, janë ekzekutuar etj. [...] me shkresën nr. [...] nga kancelari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është propozuar masa disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për pushim nga puna”.

Me urdhrin nr. [...] të kryetares së gjykatës, është urdhëruar zgjidhja e menjëhershme e kontratës së punës [...], me motivacionin se me mosveprimet e saj ka kryer shkelje të rëndë në mospërmbushjen e detyrave të saj funksionale, që nuk lejojnë, sipas parimit të mirëbesimit, vazhdimin e marrëdhënieve të punës. [...]

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. [...], ka vendosur: “Pranimin e padisë së paditëses. Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ urdhër nr. [...] për zgjidhjen e menjëhershme të marrëdhënies së punës, të kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Detyrimin e palës së paditur, [...] të rikthejë paditësen në vendin e mëparshëm të punës, duke i paguar pagën nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënies financiare deri në rikthimin në detyrë... [...]” [...]

Gjykata Administrative e Apelit me vendimin nr. [...] ka vendosur: “Ndryshimin e vendimit nr. [...]. Rrëzimin e padisë, si të pabazuar në prova dhe në ligj...” [...]

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji [...] vlerëson se pala rekursuese ka ngritur shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012 [...] të cilat lidhen me interpretimin e ligjit nr. 2016/98 [...] Pra kërkohet të konkludohet, nëse paditësja gëzon statusin si nëpunëse ligjore *ipso iure* apo ky status konsiderohet i përfituar pas ndjekjes së procedurave ligjore që ligji parashikon për punonjësit e sekretarisë gjyqësore në detyrë, interpretim i cili, në vlerësim të Kolegjit, në kuptim të nenit 58/a të ligjit nr. 49/2012, paraqet një rëndësi themelore për sigurinë dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore.

Kolegji vlerëson se ligji nr. 98/2016 [...] ka hyrë në fuqi në datë 22.11.2016. Arsyeja e vendimmarrjeve të ndryshme të gjykatave lidhet me zbatimin e ligjit nr. 98/2016 “[...] e konkretisht nëse ky i fundit do të zbatohet ndaj paditëses e, për rrjedhojë, a do konsiderohet paditësja nëpunëse civile, referuar nenit 50 të këtij ligji. [...]”

Në këtë aspekt Kolegji vlerëson të drejtë qëndrimin e Gjykatës Administrative të Apelit se organi që përfaqëson gjykatën në lidhje me emërimin dhe largimin e nëpunësit civil të gjykatës është Këshilli i Gjykatës. Pikërisht neni 85 i këtij ligji parashikon procedurën që ndiqet nga Këshilli i Gjykatës për verifikimin e kushteve formale të nëpunësve në detyrë, në të cilin është përcaktuar se [...]

Kolegji vlerëson se në interpretim literal sistematik dhe teleologjik **të dispozitave të ligjit nr. 98/2016**, referuar pikërisht qëllimit të ligjvënësit, procedura e verifikimit të kushteve formale të nëpunësve në detyrë kalon në disa hapa e procedura të përcaktuara në mënyrë të detajuar, hapa këto të cilat nuk janë ndjekur në rastin e paditëses për fitimin e statusit të nëpunësit gjyqësor. Ligji ka determinuar krijimin dhe funksionimin e Këshillit të Gjykatës brenda një afati të limituar (katër muaj) të lidhur me momentin e krijimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ), organ ky i cili nuk ishte krijuar ende. Pra, në vlerësim të Kolegjit në momentin që palës paditëse i është zgjidhur kontrata e punës, konstituimi i Këshillit të Gjykatës ishte i kushtëzuar me krijimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, organ ky i cili ende nuk ishte krijuar. Ligji ka përcaktuar se pasi të fillojë funksionimin Këshilli i Gjykatës, ka limituar afatin gjashtë mujor, brenda të cilit duhet të vlerësohet plotësimi i kriterëve formale të punonjësve në detyrë për pozicionin që kryejnë. Nëse punonjësi në detyrë nuk plotëson kriteret formale të pozicionit përkatës, Këshilli i Gjykatës vlerëson mundësitë ekzistuese për sistemimin në një pozicion tjetër brenda administratës së gjykatës, të përshtatshëm dhe në përputhje me kriteret ligjore dhe profesionale, nëse nuk ka arsye për përfundimin e marrëdhënieve të punës. Ky verifikim kualifikues sipas ligjit finalizohet me vendimin e Këshillit të Gjykatës (neni 60/4 i ligjit), i cili përcillet tek KLGJ dhe brenda afatit ligjor e regjistron atë në regjistrin qendror të personelit (neni 62 i ligjit). Në referim të këtyre përcaktimeve ligjore, të analizuara në raport me situatën faktike, rezulton se për shkak të moskrijimit të KLGJ, nuk është konstituuar as Këshilli i Gjykatës, organ i cili më pas do të ketë statusin e punëdhënësit ndaj punonjësve të administratës gjyqësore, si me të drejtë ka arsyetuar Gjykata Administrative e Apelit. Rezulton se paditësja nuk i është nënshtruar ndonjë verifikimi kualifikues nga Këshilli i Gjykatës. Kolegji, për më tepër, vlerëson të bazuar në ligj arsyetimin e

Gjykatës Administrative të Apelit se edhe në rast se do të ishte krijuar Këshilli i Gjykatës pas krijimit të KLGJ, nëpunësit ekzistues të gjykatave, përfshirë edhe palën paditëse, nuk do të cilësohen *ipso jure* **“nëpunës civilë gjyqësorë”**, pasi pika 2 e nenit 85 parashikon një procedurë të posaçme vlerësimi, e cila ka për objekt verifikimin e plotësimit të kriterëve formale të punonjësve në pozicionin që ata kryejnë.

Në dritën e këtij arsyetimi me qëllim garantimin e parimit të vazhdueshmërisë dhe koherencës institucionale në ushtrimin e funksioneve të mëparshme deri në konstituimin e plotë të organeve kushtetuese (në rastin objekt gjykimi KLGJ dhe Këshilli i Gjykatës), marrëdhëniet e punësimit të punonjësve të administratës gjyqësore i nënshtrohen rregullimit të mëparshëm, parashikim ky në funksion të mbrojtjes së sigurisë juridike. Me të drejtë Gjykata Administrative e Apelit ka referuar vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 34 datë 10.04.2017, i [...]

Nga ana tjetër, Kolegji gjen me vend të theksojë se në përputhje me parimin procedural gjykata duhet të shprehet për të gjitha kërkesat që parashtrohen pa i kaluar kufijtë e saj, duke u shprehur mbi gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet në përputhje me nenin 6 dhe 28 të KPC, vlerëson të drejtë arsyetimin e Gjykatës Administrative të Apelit se paditësja referuar objektit dhe shkakut ligjor të padisë kërkon pavlefshmërinë e urdhrit të largimit të saj nga puna si dhe zgjidhjen e pasojave bazuar në ligjin 98/2016. Në kushtet kur kërkimet e paditëses në objektin e padisë, bazën ligjore dhe përmbajtjes së kërkesë padisë referojnë në zgjidhjen e pasojave të marrëdhënies së punës sipas dispozitave të ligjit nr. 98/2016 dhe në kushtet kur ky nuk është ligji i aplikueshëm në zgjidhjen e kësaj marrëdhënieje pune, Gjykata Administrative e Apelit me të drejtë ka konkluduar në rrëzimin e kërkesë padisë, si të pabazuar në ligj dhe në prova.

Mbështetur sa më sipër, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë arrin në përfundimin, se rekursi i paraqitur ndaj vendimit nr [...] të Gjykatës Administrative të Apelit nuk duhet të pranohet, por vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit duhet të lihet në fuqi.



**20. Vendim nr.00-2025-799 (60),
datë 30.01.2025 (status nëpunësi civil:
njësia e qeverisjes vendore - inspektor
IVMT)**

Maksima: Akti i konfirmimit të statusit të nëpunësit civil i lëshuar nga njësia e qeverisjes vendore për punonjësit ekzistues nuk prezumon fitimin e këtij statusi sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, pa u kryer më parë verifikimi i procedurës së punësimit dhe kritereve nga njësia përgjegjëse DAP (Departamenti i Administratës Publike). Për marrëdhëniet juridike të punësimit për punonjësit e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit, ligji i zbatueshëm është legjislacioni i posaçëm (Ligji nr. 9780, datë 16.07.2007, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij), i cili përcakton shprehimisht se marrëdhëniet e punës për këtë kategori rregullohen nga ligji nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”.

Fjalë kyçe: konfirmim status nëpunës civil, inspektor IVMT, ligj i posaçëm, reformë

Decision no. 00-2025-799 (60), dated 30.01.2025 (civil servant status: local government unit - IVMT inspector)

Legal principle(s): The act of confirmation of the civil servant status issued by the local government unit for existing employees does not presume the acquisition of this status according to Law no. 152/2013 “On the Civil Servant”, without prior verification of the employment procedure and criteria by the responsible unit DAP (Department of Public Administration). With regard to the employment relationships of employees of the Territorial Protection Inspectorate, the applicable legal framework is the special legislation, namely Law No. 9780, dated 16 July 2007, as amended, together with the secondary legislation adopted for its implementation—which expressly provides that the employment relationships of this category of employees are governed by Law No. 7961, dated 12 July 1995, the Labour Code of the Republic of Albania.

Keywords: confirmation of civil servant status, IVMT inspector, special law, reform

Rrethanat e çështjes:

Paditësi N.V, ka filluar marrëdhëniet e punës pranë palës së paditur, Bashkia Sukth, në vitin 2007, fillimisht në pozicionin e shefit të policisë së Bashkisë Sukth e më pas ka kaluar në detyrën e inspektorit pranë IVMT. [...] me aktin e konfirmimit të statusit të nëpunësit civil nr. [...] është dhënë “Statusi i Nëpunës Civil”.

[...]Me Vendimi e Këshillit Bashkiak nr. [...] “Për miratimin e numrit të punonjësve të Bashkisë Durrës, institucioneve në varësi dhe njësisive administrative” është miratuar Struktura e Bashkisë Durrës, si dhe strukturat e njësisive administrative vartëse, në mbështetje të Ligjit Nr. 115/2014, për reformën territoriale. Struktura e Njesisë Administrative Sukth, bëhet me 25 punonjës, ku janë suprimuar vendet e punës të inspektorëve të IVMT. Paditësi është njoftuar me shkresën [...]se është vendosur përfundimi i marrëdhënieve të punës [...]

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Durrës me vendimin nr. [...]ka vendos: “-Pranimin e pjesshëm të kërkesë padisë. -Shfuqizimin e vendimit me datë [...]të nxjerrë nga pala e paditur, Bashkia Durrës. -Detyrimin e palës së paditur të vazhdojë marrëdhënien e punës me paditësin, duke e rikthyer në pozicionin e mëparshëm ose transferimin e tij në një pozicion tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori. -Detyrimin e palës së paditur t’i paguajë paditësit, pagën për gjithë periudhën e qëndrimit pa punë deri në rikthimin e tij në punë. -Rrëzimin për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit.. [...]”. [...]

Gjykata Administrative e Apelit me vendimin nr. [...]ka vendos: “-Ndryshimin e pjesshëm të vendimit [...], të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Durrës, në këtë mënyrë: -Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ, shkresë [...], “Njoftim i përfundimit të marrëdhënies të punës së nëpunësit civil” për paditësin të nxjerrë nga pala e paditur, Bashkia Durrës”. -Lënien në fuqi të vendimit për pjesën tjetër të tij...”. [...]

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji konstaton [...] se në përmbajtje të rekursit të palës së paditur gjenden shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr.49/2012 “[...], të cilat bëjnë të cenueshëm vendimin e Gjykatës së Administrative të Apelit vlerësuar në lidhje me regjimin juridik që rregullon marrëdhënien e punës së palës paditëse. [...]

Kolegji vëren se Gjykatat më të ulta kanë konkluduar se ligji i zbatueshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjes objekt gjykimi është ligji nr. 152/2013 [...]nisur nga pasja e konfirmimit të statusit për paditësin përmes

aktit të konfirmimit nr. [...]të Bashkisë Sukth. [...] Duke qenë se paditësi ka qenë i punësuar pranë IVMT marrëdhëniet e tij të punës janë rregulluar në bazë të ligjit të posaçëm nr.9780, datë: 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme” (*i ndryshuar*), i cili në nenin 8 të tij, [...]

Kolegji ka mbajtur qëndrimin se në zbatim të nenit 8(5) të ligjit nr.9780, datë: 16.07.2007 [...] është miratuar VKM-në nr.868, datë: 12.12.2007 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar” (*i ndryshuar*), i cili ishte në fuqi në kohën e përfundimit të marrëdhënieve të punës së paditësit dhe që parashikonte në pikën 5 të tij [...] I njëjti rregullim gjendet jo vetëm tek ky akt ligjor që ka qenë në fuqi në kohën e zgjidhjes së marrëdhënies së punës me paditësin, por edhe VKM-ja që e ka pasuar atë (VKM nr.893, datë: 04.11.2015) në pikën 3 të pjesës IV (Dispozitat e Fundit) parashikon në mënyrë identike se [...] Ligji i posaçëm në këtë rast, është ai që duhej mbajtur parasysh nga gjykatat më të ulta për zgjidhjen e çështjes. (*shih vendimi nr. 00-2024-2884, datë 04.07.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë*)

[...] Kolegji vlerëson se konfirmimi i statusit të nëpunësit nga Bashkia Sukth, nuk prezumon pasjen e statusit të nëpunësit civil në kuptim të ligjit nr. 152/2013, për sa kohë nga aktet e dosjes nuk rezulton që ky konfirmim të jetë bërë nga strukturat e njësisë përgjegjëse DAP. Në këtë drejtim Kolegji sjell në vëmendje jurisprudencën e tij se *të drejtat që burojnë nga statusi i nëpunësit civil, sipas ligjit nr. 152/2013, për punonjësit ekzistues janë të aplikueshme në momentin që DAP, pasi ka verifikuar procedurën e punësimit dhe kriteret për përfitimin e statusit ka vlerësuar se punonjësi ekzistues i përmbush këto kriteret.* (*Shih vendimi nr. 00-2023-5651, datë 05.12.2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, palë paditëse Noris Zeneleja palë e paditur IKMT*). Sa më sipër, Kolegji vlerëson se vendimi nr[...]Gjykatës Administrative të Apelit duhet të priset dhe çështja të kthehet për rishqyrtim pranë kësaj gjykate, e cila në rigjykim duhet të hetojë dhe të vlerësojë në mënyrë shteruese mbi ligjin e zbatueshëm për mosmarrëveshjen administrative që lidhet me marrëdhëniet e punësimit në administratën shtetërore vendore. Në varësi të identifikimit të ligjit të zbatueshëm, gjykata administrative duhet të marrë në vlerësim, paraprakisht plotësimin e kushteve formale të padisë administrative, në lidhje me afatin e padisë, në raport me llojin e kërimit në padi që kundërshton ligjshmërinë e veprimit administrativ për përfundimin e marrëdhënies së punësimit. [...]

Në rishqyrtim, Kolegji vlerëson se Gjykata Administrative e Apelit duhet të rivlerësojë faktet, bazuar në kriteret ligjore, që përcakton ligji i

zbatueshëm për marrëdhënien juridike të punësimit dhe në fund të japë vendim për zgjidhjen në themel të pretendimeve/prapësime të palëve ndërgjyqëse referuar kërimit dhe shkakut ligjor, ku i mbështesin ato.

III. Ndhimja juridike



**21. Vendim nr. 00-2024-3517,
datë 19.09.2024 (kompetencë
funksionale-ndihma juridike dytësore)**

Maksima: Kërkesa për dhënien e ndihmës juridike dytësore dhe përjashtimin nga pagimi i tarifave e shpenzimeve gjyqësore, edhe kur lidhet me një çështje që ndodhet për shqyrtim në gjykatën e apelit ose në Gjykatën e Lartë, shqyrtohet nga gjykata e shkallës së parë që ka kompetencën lëndore dhe tokësore për çështjen në themel.

Fjalë kyçe: ndihmë juridike dytësore, kompetencë funksionale, gjykata kompetente shqyrtim çështje në themel

Decision no. 00-2024-3517, dated 19.09.2024 (functional competence - secondary legal aid)

Legal principle(s): The request for granting secondary legal aid and exemption from the payment of court fees and expenses, even when related to a case that is under consideration in the court of appeal or the Supreme Court, is reviewed by the court of first instance that has subject and territorial jurisdiction over the case on the merits.

Keywords: secondary legal aid, functional competence, competent court, review of the case on the merits

Rrethanat e çështjes:

Nëpërmjet formularit të aplikimit, të depozituar në datë [..], pranë Gjykatës së Shkallës së Parë [..] kërkuesi ka kërkuar përfitimin e ndihmës juridike dytësore dhe përjashtim nga pagimi i të gjitha tarifave dhe

shpenzimeve gjyqësore.

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me vendim nr. [...] ka vendosur : *“Deklarimin e moskompetencës lëndore për gjykimin e kërkesës dhe dërgimin e saj për kompetencë lëndore pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me arsyetimin së mosmarrëveshja ku kërkuesi pretendon ofrimin e ndihmës juridike rrjedh nga e drejta e pensionit.”* [...]

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin nr. [...]ka vendosur: *“Parashtrimin e mosmarrëveshjes së kompetencës funksionale për gjykimin e kërkesës së kërkuetit [...]para Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë. [...]*

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji [...] vlerëson se kompetente për gjykimin e kërkesës për dhënien e ndihmës juridike dytësore është Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë. [...]

Në rastin objekt gjykimi shtrohet për diskutim kompetenca funksionale në rastet kur kërkesa për dhënien e ndihmës juridike dytësore paraqitet pranë gjykatës së shkallës së parë për një çështje e cila është gjykuar pranë kësaj gjykate dhe është ankimuar duke qenë në pritje për shqyrtimin e ankimit. [...]

Situatën epamundësisë së palëve për të angazhuar asistencë profesionale nëpërmjet avokatit, e ka rregulluar ligji nr.111/2017 [...]i cili parashikon ndër të tjera, ofrimin falas të ndihmës juridike dytësore, për një kategori të caktuar personash që plotësojnë kriteret e përcaktuara në ligj. Me ndihmën dytësore, sipas nenit 3(c), të ligjit do të kuptohet shërbimi juridik që ofrohet për përpilimin e akteve të nevojshme për të vënë në lëvizje gjykatën, ofrimi i këshillimit, përfaqësimit dhe mbrojtjes para gjykatës në çështjet administrative, civile dhe në çështjet penale, për të cilat nuk zbatohet mbrojtja e detyrueshme, sipas përcaktimeve të legjislacionit procedural penal. Në nenet 11 e 12 të këtij ligji parashikohen kategoritë e personave dhe kriteret që ato duhet të plotësojnë që të përfitojnë nga ndihma juridike dytësore, ndërsa në nenet 18-24 të ligjit parashikohet procedura që duhet ndjekur për përfitimin e ndihmës juridike dytësore.

Në analizën e përcaktimit të kompetencës funksionale në shqyrtimin e kërkesës për përfitimin e ndihmës juridike dytësore, Kolegji i referohet kuptimit të nenit 20 të ligjit nr. 111/2017, [...] Kolegji sjell në vëmendje jurisprudencën e Gjykatës së Lartë në rastet kur është parashtruar për zgjidhje qëndrimi i gjykatave më të ulëta për kompetencën funksionale në shqyrtimin e kërkesës për dhënie të ndihmës juridike dytësore.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (shih vendimi nr. 00-2024-2680, datë 12.06.2024), ka vlerësuar se *kërkesa për dhënien e ndihmës dytësore është çështje provueshmërie dhe vlerësimi kriteresh ligjore që rezultojnë nga një procedurë gjyqimi në gjykatën e në shkallës së parë ku, kërkuesi ka paraqitur kërkesën. Pra, gjykata pranë së cilës është paraqitur kërkesa, e cila hartohet sipas formularit të miratuar nga Ministri i Drejtësisë, do të duhet të administrojë e vlerësojë prova duke kryer për këtë rast një hetim gjyqësor, për të konkluduar nëse kërkesa është e bazuar në ligj apo jo. Në një çështje tjetër të praktikës gjyqësore, është shtruar për zgjidhje kompetenca funksionale e gjykatës për shqyrtimin e kërkesave për dhënie të ndihmës juridike dytësore, në rastin kur kërkesa depozitohet pranë gjykatës së shkallës së parë, ndërsa çështja për të cilën kërkohet ndihma juridike është duke u gjykuar pranë gjykatës së apelit. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (shih vendimi nr. 00-2021-885, datë 06.07.2021), ka vlerësuar: “[..]Në kushtet sa sipër, Kolegji vlerëson se, nëse kjo kërkesë do të shqyrtohet nga gjykata e apelit, do të ishim para një vendimi ndaj të cilit nuk lejohet rekurs në Gjykatën e Lartë, duke u shkelur në këtë mënyrë e drejta kushtetuese e kërkuetit për t’u gjykuar kërkesa e tij në dy shkallë gjyqimi, sikurse garantohet kjo e drejtë nga ligji nr.111/2017, kur kërkesa shqyrtohet nga gjykata e shkallës së parë. [..].”*

Në nenin 19 të ligjit nr. 111/2017, parashikohet se [..]Kolegji çmon se kjo dispozitë e ligjit, nuk ka për qëllim të kufizojë të drejtën për të kërkuar dhënien e ndihmës juridike dytësore vetëm gjatë gjykimit të çështjes në shkallë të parë, por interpretuar në harmoni me nenin 20, pika 1, të ligjit, konkludohet se kërkesa për dhënien e ndihmës juridike dytësore mund të paraqitet pavarësisht shkallës në të cilën gjykohet çështja, por se me togfjalëshin “gjykatë kompetente për shqyrtimin e çështjes në themel”, do të kuptohet gjykata e shkallës së parë që ka kompetencën lëndorë dhe tokësore për shqyrtimin e çështjes, duke mos përfshirë kompetencën funksionale në lidhje me përcaktimin e gjykatës kompetente kur çështja për të cilën është kërkuar dhënia e ndihmës juridike dytësore është duke u gjykuar pranë gjykatave të apelit dhe/ose Gjykatës së Lartë.

Sipas nenit 2 të ligjit nr. 111/2017, ai ka për qëllim : a) të krijojë një sistem për organizimin dhe ofrimin e ndihmës juridike falas për të siguruar akses të barabartë të të gjithë individëve në sistemin e drejtësisë; b) të sigurojë mirorganizimin, miradministrimin dhe mirëfunksionimin e institucioneve shtetërore përgjegjëse për administrimin e ndihmës juridike; c) të sigurojë ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike në mënyrë profesionale, cilësore, efëcente dhe efektive.

Në interpretim të frymës së këtij ligji, Kolegji çmon se ofrimi i

ndihmës juridike në mënyrë efçente, realizohet pikërisht duke i krijuar mundësinë kategorisë së personave që kanë nevojë për këtë ndihmë, për ta kërkuar dhe marrë atë sa më pranë vendbanimit të tyre, duke ulur kostot e panevojshme dhe krijuar mundësinë efektive për të siguruar dokumentacionin e nevojshëm. Procedurat që ndiqen në shqyrtimin e kërkesave të kësaj natyre, shmangia e vonesave, të cilat cenojnë thelbin e të drejtave të kërkuësit, duke urdhëruar dorëzimin e dokumentacionit të nevojshëm nga organet e administratës shtetërore që e disponojnë atë, realizohet, nën frymën dhe qëllimin e këtij ligji, pikërisht nga gjykatat e shkallëve të para, të cilat janë kompetente nga pikëpamja lëndore për shqyrtimin e çështjes në themel, edhe nëse çështja për të cilën është kërkuar dhënia e ndihmës juridike dytësore është duke u gjykuar pranë gjykatave të apelit dhe/ose Gjykatës së Lartë.

Për sa më sipër, duke rikonfirmuar qëndrimet e lartpërmendura, Kolegji vlerëson se gjykata kompetente për shqyrtimin e kërkesës për dhënien e ndihmës juridike në mosmarrëveshjen konkrete është Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë.

Mendim pakice:

Vlerësoj të mos pajtohem me qëndrimin e shumicës, duke parashtruar në vijim mendimin tim në pakicë se vendimi [..] është marrë në zbatim të gabuar të ligjit nr. 2017/111 dhe se parashtrësja e Gjykatës Administrative të Apelit është e bazuar në ligj dhe identifikon saktë gjykatën kompetente për shqyrtimin e kërkesës për dhënien e ndihmës juridike dytësore në përputhje me parashikimet e ligjit të posaçëm.

[..] Ndihma juridike dytësore është një detyrim pozitiv i institucioneve shtetërore kompetente dhe duhet të jepet për personat që plotësojnë kushtet ligjore për përfitim *edhe në fazat e shqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Apelit dhe/ose në Gjykatën e Lartë*. Ky qëndrim është mbajtur edhe nga Gjykata Kushtetuese (ndonëse në çështjet penale) ku është theksuar se [..] (shih vendimi nr. 9/2012 të Gjykatës Kushtetuese). [..]

Sa më sipër, konstatohet se ligji nr. 111/2017 nuk ka parashikuar në mënyrë të posaçme situatën ligjore ku kërkesa për dhënien e ndihmës juridike dytësore paraqitet rishtazi në ankim. Rrjedhimisht çështja e kompetencës funksionale të gjykatës që do shqyrtojë këtë kërkesë është shtruar për zgjidhja nga gjykatat e faktit. Ndodhur në kushtet e ometimit ligjor mbi gjykimin e kërkesës në rastet kur çështja është për gjykim në gjykatat e apelit ose në Gjykatën e Lartë, vlerësoj se Kolegji duhet të priret drejtë *natyrës së posaçme dhe garantimit të gjykimit brenda një afati veçanërisht të shpejtë të këtyre kërkesave*, pasi shqyrtimi i kërkesave për

dhënien e juridike dytësore qëndron si gjykim “aksesor” në raport me gjykimin e themelit të çështjes, në funksion të garantimit të parimit të aksesit efektiv në gjykatë. Rrjedhimisht vlerësoj se *gjykata kompetente për shqyrtimin e çështjes në themel*, në kuptim të nenit 20 të ligjit nr. 2017/111, **është gjykata pranë të cilës qëndron në pritje çështja për gjykim, pavarësisht fazës së gjykimit të saj (në shkallë të parë apo në gjykim rishikues).**

[..] Për rrjedhojë për sa kohë çështja është në pritje të gjykimit pranë Gjykatës Administrative të Apelit, vlerësoj se kjo e fundit është gjykata kompetente për gjykimin e çështjes. [..]



**22. Vendim nr.00-2024-5317,
datë 27.12.2024 (kompetencë
funksionale-ndihma juridike dytësore)**

Maksima: Kërkesa për dhënien e ndihmës juridike dytësore shqyrtohet nga gjykata pranë së cilës ndodhet për shqyrtim çështja e themelit, pavarësisht fazës së gjykimit të saj. Kur çështja ndodhet në pritje shqyrtimi në Gjykatën Administrative të Apelit, kjo gjykatë është kompetente nga pikëpamja funksionale për të shqyrtuar kërkesën për ndihmë juridike dytësore, pasi kjo kërkesë ka natyrë aksesore ndaj gjykimit të themelit dhe duhet të trajtohet në mënyrë që të garantohet akses efektiv në gjykatë dhe mbrojtje reale.

Fjalë kyçe: ndihmë juridike dytësore, kompetencë funksionale, gjykata kompetente për shqyrtimin e çështjes në themel

Decision no. 00-2024-5317, dated 27.12.2024 (functional competence-secondary legal aid)

Legal principle(s): The request for secondary legal aid is examined by the court before which the main case is pending, regardless of the stage of its trial. When the case is pending before the Administrative Court of Appeal, this court is functionally competent to examine the request for secondary legal aid, since this request is ancillary to the trial of the main case and must be treated in a way that guarantees effective access to court and real protection.

Keywords: secondary legal aid, functional competence, court competent to examine the main case

Rrethanat e çështjes:

Pala kërkuese [...] nëpërmjet Formularit standard të aplikimit për përfitim të ndihmës juridike dytësore, [...]ka kërkuar në gjykatë miratimin e ndihmës juridike dytësore të garantuar nga shteti [...] pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë. [...]

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. [...]ka vendosur: *“Shpalljen e moskompetencës funksionale të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për gjykimin e çështjes [...]dhe aktet t’i dërgohen për kompetencë funksionale Gjykatës Administrative ti Apelit Tiranë”*. [...]

Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. [...] ka vendosur: *“1. Të parashtrojnë çështjen e konfliktit të kompetencave Gjykatës së Lartë për çështjen me nr. [...]. [...]*

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji [...]vlerëson se vendimi nr. [...]i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, që ka shpallur moskompetencën funksionale për shqyrtimin e çështjes, duke i dërguar aktet për vazhdimin e gjykimit Gjykatës Administrative të Apelit, është rrjedhojë e zbatimit të drejtë të ligjit. Në këto kushte, çështja do të shqyrtohet në vijim nga Gjykata Administrative e Apelit, si gjykatë kompetente nga pikëpamja funksionale. [...]

Duke u kthyer në çështjen objekt shqyrtimi, referuar akteve, pjesë e dosjes gjyqësore, konstatohet se mosmarrëveshja e kompetencës funksionale, lidhet me diskutimin në rastet kur kërkesa për dhënien e ndihmës juridike dytësore paraqitet pranë gjykatës së shkallës së parë për një çështje e cila është gjykuar pranë kësaj gjykate dhe është ankimuar duke qenë në pritje për shqyrtimin e ankimit. Kolegji evidenton se situata dhe pamundësia e palëve për të angazhuar asistencë profesionale nëpërmjet avokatit, është rregulluar nga ligji nr.111/2017 [...]i cili parashikon ndër të tjera, ofrimin falas të ndihmës juridike dytësore, për një kategori të caktuar personash që plotësojnë kriteret e përcaktuara në ligj. Me ndihmën dytësore, sipas nenit 3(c), të ligjit do të kuptohet shërbimi juridik që ofrohet për përpilimin e akteve të nevojshme për të vënë në lëvizje gjykatën, ofrimi i këshillimit, përfaqësimit dhe mbrojtjes para gjykatës në çështjet administrative, civile dhe në çështjet penale, për të cilat nuk zbatohet mbrojtja e detyrueshme, sipas përcaktimeve të legjislationit procedural penal. [...]

Përpara se Kolegji të arsyetojë kuptimin e dispozitës së lartpërmendur vlerëson të theksojë se, e drejta për ndihmë juridike të garantuar nga shteti

është parashikuar shprehimisht në shumë akte në fuqi në Republikën e Shqipërisë të cilat kanë paraqitur detyrimin ndaj shtetit shqiptar për të miratuar Ligjin nr. 111/2017 me objektin përkatës të përcaktuar në nenin 1 të tij. [..]

Sipas germës “ç” të nenit 6 të këtij ligji, Gjykata kompetente është parashikuar si institucioni që në funksion të ndihmës juridike falas shqyrton kërkesat për ndihmë juridike falas e cila përfshin ndihmën juridike dytësore si dhe përjashtimin nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore, dhe shprehet me vendim për pranimin ose jo të kërkesës, të cilin ia vë në dispozicion Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas. Ky fakt është elaboruar dhe nga Jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e cila në vendimin nr.35 datë 01.06.2016 është shprehur[..]

Në lidhje me çështjen konkrete, konstatohet se ligji nr. 111/2017 nuk ka parashikuar në mënyrë të posaçme situatën ligjore ku kërkesa për dhënien e ndihmës juridike dytësore paraqitet rishtazi në ankim. Rrjedhimisht çështja e kompetencës funksionale të gjykatës që do shqyrtojë këtë kërkesë është shtruar për zgjidhje nga gjykatat e faktit. Ndodhur në kushtet e ometimit ligjor mbi gjykimin e kërkesës në rastet kur çështja është për gjykim në gjykatat e apelit ose në Gjykatën e Lartë, Kolegji mban në vëmendje këto kritere; i) parimin e aksesit efektiv në gjykatë (*garantimin e gjykimit brenda një afati veçanërisht të shpejtë të këtyre kërkesave*, pasi shqyrtimi i kërkesave për dhënien e juridike dytësore qëndron si gjykim “aksesor” në raport me gjykimin e themelit të çështjes), ii) statusin e çështjes, padisë që është e paraqitur në shkallë të parë kur pret fatin e saj për tu zgjidhur, apo mbi bazë ankimi dhe kjo kërkesë bëhet për gjykimin e themelit në shkallën e dytë .

Ligjvënësi, në nenin 20 të ligjit nr. 111/2017 ka sanksionuar se [..]Në interpretimin literal dhe teologjik të kësaj dispozite, Kolegji vlerëson se *gjykata kompetente për shqyrtimin e çështjes në themel, është gjykata pranë të cilës qëndron në pritje çështja për gjykim” gjykimi i themelit”, pavarësisht fazës së gjykimit të saj (në shkallë të parë apo në gjykim rishikues). Pra, kur flasim për “gjykimin e themelit” të një çështjeje, nënkuptohet se kjo është faza ku gjykata shqyrton dhe vendos mbi thelbësinë e konfliktit juridik, pra lidhur me bazën/substancën e pretendimeve dhe detyrimeve të palëve.*

Ndihma juridike dytësore është detyrim të jepet për personat që plotësojnë kushtet ligjore edhe në fazat e shqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Apelit dhe në Gjykatën e Lartë. Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj

nr. 9, datë 29.02.2012, është shprehur se: [..]

Ky Kolegj, gjithashtu mban në konsideratë edhe parashikimet e nenit 2 të ligjit nr. 111/2017, i cili ka për qëllim: a) të krijojë një sistem për organizimin dhe ofrimin e ndihmës juridike falas për të siguruar akses të barabartë të të gjithë individëve në sistemin e drejtësisë; b) të sigurojë mirorganizimin, miradministrimin dhe mirëfunksionimin e institucioneve shtetërore përgjegjëse për administrimin e ndihmës juridike; c) të sigurojë ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike në mënyrë profesionale, cilësore, efçente dhe efektive. Në interpretim të frymës së këtij ligji, Kolegji çmon se ofrimi i ndihmës juridike në mënyrë efçente, realizohet pikërisht duke i krijuar mundësinë kategorisë së personave që kanë nevojë për këtë ndihmë, për ta kërkuar dhe marrë atë sa më pranë vendbanimit të tyre, duke ulur kostot e panevojshme dhe krijuar mundësinë efektive për të siguruar dokumentacionin e nevojshëm. Procedurat që ndiqen në shqyrtimin e kërkesave të kësaj natyre, shmangia e vonesave, të cilat cenojnë thelbin e të drejtave të kërkuarit, duke urdhëruar dorëzimin e dokumentacionit të nevojshëm nga organet e administratës shtetërore që e disponojnë atë, realizohet, nën frymën dhe qëllimin e këtij ligji, pikërisht nga gjykatat pranë të cilës ndodhet për shqyrtim çështja e themelit, të cilat janë kompetente nga pikëpamja lëndore/funksionale për shqyrtimin e çështjes në themel, pra edhe nëse çështja për të cilën është kërkuar dhënia e ndihmës juridike dytësore është duke u gjykuar pranë gjykatave të apelit dhe/ose Gjykatës së Lartë.

Mbështetur sa më sipër, Kolegji arrin në përfundimin se gjykata kompetente për shqyrtimin e kërkesës për dhënien e ndihmës juridike, do të jetë gjykata pranë së cilës ndodhet për shqyrtim çështja e themelit. Për rrjedhojë në çështjen objekt shqyrtimi, për sa kohë çështja e themelit është në pritje të shqyrtimit pranë Gjykatës Administrative të Apelit, atëherë kjo e fundit është gjykata kompetente për shqyrtimin e kërkesës për dhënien e ndihmës juridike.

Mendim pakice:

[..] Pakica vlerëson se ligji nr. 111/2017, në nenet 19, 20, 21, 22 e 23 ka përcaktuar një procedurë të veçantë sesi përfitohet ndihma dytësore falas me shpenzimet e shtetit. Rrjedhimisht qëndrimi i Gjykatës Administrative të Apelit, në kushtet kur ndaj vendimit për pranimin ose rrëzimin e kërkesës për ndihmë gjyqësore, lejohet vetëm një ankim dhe nga ana tjetër ndalohet rekursi në Gjykatën e Lartë, është i drejtë. Procedura është projektuar në atë mënyrë që të zhvillohet pranë gjykatës

së shkallës së parë mundësisht para se të iniciohet procedura gjyqësore, ose edhe më pas, kur verifikohen kushtet e posaçme të parashikuara në ligj, por gjithnjë duke u shqyrtuar në shkallë të parë nga gjykata e shkallës së parë dhe eventualisht në apel nga Gjykata e Apelit, brenda afateve shumë të shkurtra. Nëse Gjykata Administrative e Apelit do të trajtonte për herë të parë një kërkesë të tillë në apel dhe kërkuesi do të dilte humbës, atëherë ai nuk do të kishte asnjë mundësi rekursi, duke iu kufizuar e drejta e ankimit, tej parashikimit ligjor. Nga ana tjetër vërtetë Gjykata Administrative e Apelit do të duhej të trajtonte të gjitha kërkesat e palëve gjatë gjykimit, porse kjo mund të bëhet në çdo rast, përveç kur ligji shprehimisht ka parashikuar një rrugë të ndryshme ligjore (siç është ky rast). [..]



23. Vendim njësuës nr. 35008-00053-00-2026, datë 16.04.2026 (kompetencë funksionale - ndihma juridike dytësore)

Sentenca njehsuese: *Shprehja “gjykata kompetente për shqyrtimin e çështjes në themel”, e parashikuar në nenin 20/1 të ligjit nr. 111/2017, duhet kuptuar, në dritën e neneve 2, 4, 19, 21 dhe 22 të këtij ligji, si dhe të nenit 42 të Kushtetutës, si gjykata që, në fazën konkrete të procesit, ka kompetencën funksionale të shqyrtojë çështjen ose kërkesën procedurale nga e cila varet ushtrimi efektiv i së drejtës së aksesit në gjykatë. Për rrjedhojë, kur kërkesa për ndihmë juridike dytësore paraqitet gjatë gjykimit në apel, kompetente është gjykata e apelit ku ndodhet çështja. Kur nevoja për ndihmë juridike dytësore lind në fazën e ushtrimit të ankimit ose të rekursit, kompetenca i përket gjykatës pranë së cilës depozitohet ankimi ose rekursi dhe ku verifikohet rregullsia formale e tij.*

Fjalë kyçe: *ndihmë juridike dytësore, kompetencë funksionale, gjykata në fazën konkrete të procesit*

***Unifying decision no. 35008-00053-00-2026, dated 16.04.2026
(functional competence - secondary legal aid)***

Unifying sentence: *The phrase “court competent to examine the case on the merits”, provided for in Article 20/1 of Law no. 111/2017, must be understood, in the light of Articles 2, 4, 19, 21 and 22 of this Law, as well as Article 42 of the Constitution, as the court that, at the specific stage of the process, has the functional competence to examine the case or procedural request on which the effective exercise of the right of access to court depends. Consequently, when the request for secondary legal aid is submitted during the appeal hearing, the competent court of appeal is the one where the case is pending. When the need for secondary legal aid arises at the stage of exercising the appeal or recourse, the competence belongs to the court with which the appeal or recourse is filed and where its formal regularity is verified.*

Keywords: *secondary legal aid, functional competence, court at the specific stage of the process.*

Rrethanat e çështjes:

[..] pala kërkuese F.B atbardha Braho ka depozituar ankesën pranë [..] KMD, për shkak të mospërfshirjes së fëmijëve të saj Gj.B. dhe N.B., në listën e përfituesve të bursës shkollore. [..] KMD ka marrë vendimin [..], me të cilin ka konstatuar diskriminimin e fëmijëve të palës kërkuese, në kushtet kur familja e tyre trajtohej me ndihmë ekonomike dhe fëmijët ndiqnin arsimin parauniversitar; dhe [..] ka përcaktuar edhe detyrime konkrete për Bashkinë Korçë, me qëllim ndalimin dhe shmangien e pasojave të diskriminimit të konstatuar.

Kundër këtij vendimi, Ndërmarrja e Shërbimeve [..] ka paraqitur padi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke kërkuar shfuqizimin e vendimit [..] të KMD-së. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin [..], ka vendosur: “*Mospranimin e padisë.*”

Kundër vendimit nr. [..] të Gjykatës Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, ka ushtruar ankim Ndërmarrja e Shërbimeve [..] Pala kërkuese [..] ka paraqitur pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm formularin e aplikimit për përfitimin e ndihmës juridike dytësore, formularin e vetëdeklarimit për kategoritë e veçanta të përfituesve, si dhe formularin e aplikimit për përjashtimin nga pagimi i tarifave dhe i shpenzimeve gjyqësore.

Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, me vendimin nr. [...] ka vendosur: *“Deklarimin e moskompetencës lëndore të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për shqyrtimin e kërkesës së kërkuases [...] dhe dërgimin e akteve gjykatës kompetente, Gjykatës Administrative të Apelit. [...]”*. [...]

Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. [...] ka vendosur: *“Të ngrejë çështjen e mosmarrëveshjes për kompetencë para Gjykatës së Lartë [...]”*. [...]

Arsyetimi i Kolegjit:

A. Procedura në Gjykatën e Lartë dhe shkaqet e njësimit të praktikës gjyqësore

Kolegji Administrativ [...]vëren se çështja e paraqitur për zgjidhje lidhet me interpretimin e ligjit nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, për të përcaktuar gjykatën kompetente për shqyrtimin e kërkesës për ndihmë juridike dytësore, në rastet kur kjo kërkesë paraqitet pasi **çështja kryesore ka kaluar nga gjykata e shkallës së parë dhe ndodhet për shqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit ose në Gjykatën e Lartë**.

Kolegji konstaton se për këtë çështje janë mbajtur qëndrime të ndryshme në praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, veçanërisht në vendimet nr. 00-2024-3517, datë 19.09.2024 dhe nr. 00-2024-5317, datë 27.12.2024, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë. Kjo mospërputhje ka krijuar nevojën për përcaktimin e një rregulli të qartë njësoj, me qëllim garantimin e zbatimit të njëtrajtshëm të ligjit dhe shmangien e pasigurisë procedurale për personat që kërkojnë ndihmë juridike dytësore.[...]

Në këto rrethana, për shkak të qëndrimeve të ndryshme në praktikën gjyqësore dhe të rëndësisë që ka çështja për garantimin e aksesit efektiv në drejtësi, Kolegji Administrativ [...]vendosi nisjen e procedurës për njësimin e praktikës gjyqësore dhe kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore¹.

Për njësim të praktikës gjyqësore, Kolegji shtroi pyetjen:

“Cila është gjykata kompetente për shqyrtimin e kërkesës për dhënien e ndihmës juridike dytësore, sipas ligjit nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, kur çështja në

¹ Vendimi i ndërmjetëm mbi nisjen e procedurës për njësimin e praktikës gjyqësore administrative, ku jepen arsytet për nevojën e njësimit është njoftuar me anë të publikimit në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, siç përmendet dhe më lart.

themel ndodhet për gjykim në Gjykatën Administrative të Apelit ose në Gjykatën e Lartë?”.

[..]Kolegji çmon të nevojshme të theksojë se çështja e shtruar për njësim nuk lidhet me vlerësimin nëse kërkuesi i plotëson kushtet ligjore për përfitimin e ndihmës juridike dytësore, por vetëm me përcaktimin e gjykatës që duhet të shqyrtojë kërkesën, kur nevoja për mbrojtje profesionale lind në një fazë të mëvonshme të procesit. Për rrjedhojë, rregulli njësues orienton gjykatat vetëm për kompetencën, pa paragjykuar vlerësimin konkret të kriterëve ligjore nga gjykata kompetente.

B. *Legjislacioni kombëtar, standardet gjyqësore kombëtare dhe ato ndërkombëtare*

[..] Nga këto dispozita rezulton se ligji nr. 111/2017 nuk e trajton kërkesën për ndihmë juridike dytësore si procedurë të shkëputur nga procesi për të cilin kërkohet ndihma. Përkundrazi, ai e vendos atë në varësi të fazës ku ndodhet çështja dhe të nevojës që vendimmarrja mbi kërkesën të prodhojë efekt praktik brenda atij procesi. Kjo lidhje ndërmjet kërkesës ndihmëse dhe procesit kryesor është thelbësore për kuptimin e nenit 20/1 të ligjit.

i. Standardet gjyqësore kushtetuese dhe konventore

Jurisprudenca kushtetuese ka theksuar se ndihma juridike e garantuar nga shteti nuk është mekanizëm formal, por instrument në funksion të aksesit efektiv në drejtësi dhe të procesit të rregullt ligjor. Në vendimin nr. 34, datë 17.11.2022, [..] Ky standard e lidh ndihmën juridike jo vetëm me ekzistencën formale të një procedure, por me aftësinë reale të saj për t'i mundësuar individit mbrojtje profesionale në procesin ku ajo kërkohet.

Në vendimin nr. 45, datë 03.10.2023, Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar se, [..] Edhe standardet e zhvilluara nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut kërkojnë që e drejta e aksesit **në gjykatë nuk duhet të jetë teorike ose** iluzore, por reale, praktike dhe efektive. [..] çështja “*Bakan kundër Turqisë*”, [..] “*Kreuz kundër Polonisë*” dhe “*Weissman dhe të tjerët kundër Rumanisë*”, [..] “*Airey kundër Irlandës*”, [..] “*Steel and Morris kundër Mbretërisë së Bashkuar*” [..] Edhe Gjykata e Drejtësisë së Bashkimit Evropian, në çështjen “*DEB*”, theksoi se gjykata kombëtare duhet të verifikojë nëse kushtet për dhënien e ndihmës juridike cenojnë thelbin e aksesit në gjykatë, duke marrë parasysh rëndësinë e çështjes për kërkuenin, kompleksitetin e ligjit dhe procedurës, gjasat e suksesit dhe aftësinë reale të kërkuetit për t'u vetëpërfaqësuar. Në të njëjtën linjë, në çështjen “*Aerts kundër Belgjikës*”, GJEDNJ ka vlerësuar se [..] Nga ana

tjetër, në çështjet “Del Sol kundër Francës” dhe “Essaadi kundër Francës”, GJEDNJ [..]

Nga këto vendime rezulton një linjë e qëndrueshme jurisprudenciale, se aksesimi **në gjykatë dhe ndihma juridike nuk vlerësohen vetëm nga ekzistenca e tyre formale në ligj, por nga mënyra se si ato funksionojnë në praktikë. Për këtë arsye, kur gjykata interpreton dispozitat e së drejtës së brendshme që rregullojnë ndihmën juridike dytësore, ajo duhet të mbajë parasysh jo vetëm tekstin e normës, por edhe qëllimin e saj, efektivitetin e mekanizmit dhe ndikimin që zgjidhja procedurale mund të ketë mbi mundësinë reale të palës për të ushtruar të drejtat e saj në proces. Në këtë kuptim, interpretimi i nenit 1/20 të ligjit nr. 2017/111 nuk mund të bëhet i shkëputur nga funksioni që ndihma juridike dytësore përmbush në fazën konkrete të gjykimit. Ai duhet të orientohet nga një lexim që ruan njëkohësisht rregullin e kompetencës dhe efektivitetin e mbrojtjes që ligji synon të garantojë.**

Në të njëjtën linjë, Kolegji vlerëson se efektiviteti i ndihmës juridike dytësore nuk matet vetëm me faktin nëse kërkuesi ka mundësi të paraqesë formalisht një kërkesë, por edhe me faktin nëse vendimi mbi këtë kërkesë merret nga gjykata që mund ta bëjë ndihmën të dobishme në fazën konkrete të procesit. Një ndihmë juridike e dhënë me vonesë, ose nga një forum i shkëputur nga faza ku kërkohet mbrojtja, mund të mbetet formalisht ekzistente, por praktikisht joefektive.

C. Arsyetimi i Kolegjit Administrativ për rregullin njësores

[..] Për qëllimin e njësitimit të praktikës gjyqësore, Kolegji çmon se interpretimi i ligjit nr. 111/2017, në lidhje me gjykatën kompetente për shqyrtimin e kërkesës për dhënie të ndihmës juridike dytësore, duhet të bëhet duke mbajtur parasysh jo vetëm rregullin procedural të kompetencës, por edhe funksionin kushtetues që përmbush kjo ndihmë në garantimin e mbrojtjes efektive. Ndihma juridike dytësore nuk është një kërkesë procedurale e zakonshme. Ajo është mjeti përmes të cilit individ, që nuk ka mundësi financiare ose ndodhet në kushte të veçanta ligjore, bëhet realisht i aftë të marrë pjesë në proces dhe të ushtrojë të drejtat e tij. Prandaj, interpretimi i kompetencës nuk mund të shkëputet nga qëllimi i ligjit për të garantuar akses të barabartë, mbrojtje profesionale dhe efektivitet të procesit gjyqësor.

Çështja e shtruar për njësim nuk është thjesht teknike. Ajo përcakton nëse kërkesa për ndihmë juridike do të shqyrtohet nga gjykata ku pala ka

nevojë konkrete për mbrojtje, apo nga një gjykatë e shkëputur nga faza procedurale ku ndodhet çështja. Në rastin konkret, kërkesa është paraqitur kur çështja e themelit ishte regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit.

[..]Neni 19 lejon paraqitjen e kërkesës në çdo fazë të procesit gjyqësor; neni 20/1 parashikon se ajo paraqitet në gjykatën kompetente për shqyrtimin e çështjes në themel; neni 21, për fushën penale, e lidh kompetencën me organin procedues, ndërsa neni 22 i referohet legjislacionit procedural, parashikon afate të ndryshme sipas fazës së procesit dhe autorizon gjykatën të shmangë vonesa që cenojnë thelbin e të drejtave të kërkuarit. Nga leximi i përbashkët i këtyre dispozitave rezulton se ligji ndërthur dy kërkesa: respektimin e rregullit të kompetencës dhe sigurimin e efektivitetit të ndihmës juridike në fazën ku ajo kërkohet.

Përpara se të përcaktohet kuptimi i shprehjes *“gjykata kompetente për shqyrtimin e çështjes në themel”*, duhet vënë në dukje se ligji nr. 111/2017 nuk e koncepton ndihmën juridike të garantuar nga shteti si një mekanizëm që aktivizohet vetëm përpara gjykatës. Nga objekti, qëllimi dhe struktura e tij rezulton se ligjvënësi ka ngritur një sistem publik të organizuar, i cili synon të identifikojë, orientojë dhe trajtojë sa më shpejt nevojën e qytetarit për ndihmë juridike. Gjykata është një hallkë e rëndësishme e këtij sistemi, por jo domosdoshmërisht hallka e parë. Për këtë arsye, analiza e kompetencës gjyqësore duhet të bëhet duke mbajtur parasysh edhe funksionin paraprak, orientues dhe mbështetës të mekanizmit publik të ndihmës juridike. [..]

Megjithatë, roli i mekanizmit publik të ndihmës juridike nuk nënkupton se në çështjet civile dhe administrative qytetari ka detyrimin formal që, përpara se t'i drejtohet gjykatës, të kalojë domosdoshmërisht pranë strukturave publike të ndihmës juridike. Ligji nuk parashikon një parakusht të tillë pranueshmërie. Përkundrazi, neni 19 lejon paraqitjen e kërkesës pranë gjykatës, ndërsa neni 20/1 e lidh shqyrtimin e saj me gjykatën kompetente për çështjen në themel. Për këtë arsye, mekanizmi publik duhet kuptuar si garanci orientuese, ndihmëse dhe organizuese për qytetarin, jo si filtër i detyrueshëm procedural që kushtëzon aksesin e tij në gjykatë.

Për rrjedhojë, kur kërkesa për ndihmë juridike dytësore paraqitet drejtpërdrejt në gjykatë, çështja që shtrohet për zgjidhje nuk është nëse qytetari duhej t'i ishte drejtuar më parë mekanizmit publik, por cila është gjykata kompetente për shqyrtimin e saj. Pikërisht në këtë pikë merr rëndësi interpretimi i nenit 20/1 të ligjit nr. 111/2017 dhe përcaktimi nëse shprehja *“gjykata kompetente për shqyrtimin e çështjes në themel”*

i referohet gjykatës së shkallës së parë që ka kompetencën fillestare për mosmarrëveshjen, apo gjykatës ku çështja ndodhet realisht në fazën konkrete të procesit.

Lidhur me këtë përcaktim, në praktikën gjyqësore siç u përmend edhe më sipër, janë shfaqur dy linja të ndryshme interpretimi. Sipas qëndrimit të parë, kërkesa për ndihmë juridike dytësore duhet të shqyrtohet nga gjykata e shkallës së parë, si gjykata që ka kompetencën fillestare lëndore dhe tokësore për zgjidhjen në themel të mosmarrëveshjes. Ky interpretim mbështetet në leximin literal dhe sistematik të nenit 20/1, sipas të cilit togfjalëshi *“gjykata kompetente për shqyrtimin e çështjes në themel”* lidhet me gjykatën që shqyrton fillimisht themelin e çështjes. Ai mbështetet gjithashtu në nenin 22, pikat 7 dhe 8, të ligjit nr. 111/2017, të cilat parashikojnë ankimin e veçantë kundër vendimit që rrëzon kërkesën për ndihmë juridike dytësore dhe shqyrtimin e këtij ankimi nga gjykata e apelit, pa pasur të drejtë për rekurs në Gjykatën e Lartë.

Ky qëndrim ruan skemën klasike të kontrollit gjyqësor, siguron rrugën procedurale të ankimit të veçantë dhe në pamje të parë paraqitet si një lexim i kujdesshëm i nenit 20/1 në lidhje me nenin 22 të ligjit nr. 111/2017. Për këtë arsye, ai nuk mund të refuzohet *apriori* si formalist apo i pabazuar. Megjithatë, pranueshmëria teorike e këtij interpretimi nuk mjafton për ta bërë atë zgjidhjen më të përshtatshme, nëse zbatimi i tij në praktikë dobëson funksionin për të cilin është krijuar ndihma juridike dytësore.

Kolegji vëren gjithashtu se kthimi i kërkesës për ndihmë juridike dytësore në gjykatën e shkallës së parë, kur çështja ndodhet tashmë në apel ose në fazën e rekursit, mund të krijojë një procedurë paralele, e cila nuk i shërben zhvillimit të procesit kryesor. Një qasje e tillë mund të shtojë shkëmbime aktesh ndërmjet gjykatave, të krijojë pasiguri për palën dhe të vonojë caktimin e mbrojtësit, ndërkohë që nevoja për mbrojtje lidhet me një veprim procedural që duhet kryer në kohë.

Kolegji vlerëson se argumenti i mbështetur në nenin 22, pikat 7 dhe 8, të ligjit nr. 111/2017 nuk mund të jetë vendimtar në mënyrë të izoluar. Kjo dispozitë garanton ankimin e veçantë kundër vendimit që rrëzon kërkesën për ndihmë juridike dytësore, por kjo garanci duhet lexuar në harmoni me qëllimin e ligjit dhe me funksionin që ndihma juridike dytësore përmbush në proces. E drejta e ankimit është një garanci e rëndësishme procedurale, por ajo nuk mund të shndërrohet në arsye për ta zhvendosur kërkesën nga gjykata ku ndodhet realisht çështja dhe ku pala ka nevojë të menjëhershme për mbrojtje profesionale. Në të kundërt, mjeti i ankimit do të ruhej formalisht, ndërsa vetë ndihma juridike do të rrezikonte të humbiste dobishmërinë e saj praktike.

Në këtë kuptim, duhet dalluar garancia e kontrollit gjyqësor mbi vendimin për ndihmë juridike nga efektiviteti i vetë së drejtës për akses në gjykatë. Kur çështja ndodhet në apel, ose kur ndihma juridike kërkohet për ushtrimin, nënshkrimin apo depozitimin e rekursit, shqyrtimi i kërkesës nga gjykata e shkallës së parë vetëm për të ruajtur formalisht skemën e ankimit të veçantë, do ta shkëpuste këtë kërkesë nga faza procedurale ku ajo duhet të prodhojë efektin e saj. Një zgjidhje e tillë mund të ruajë formën e kontrollit, por rrezikon të dobësojë thelbin e së drejtës që ligji synon të garantojë: mbrojtjen reale, në kohën dhe në fazën ku ajo nevojitet. Për këtë arsye, shprehja *“gjykata kompetente për shqyrtimin e çështjes në themel”*, e parashikuar në nenin 20/1 të ligjit nr. 111/2017, nuk duhet kuptuar në mënyrë të ngurtë, si referim i pandryshueshëm vetëm te gjykata që ka shqyrtuar fillimisht çështjen, por në lidhje me gjykatën ose hallkën procedurale ku ndodhet realisht procesi dhe ku ndihma juridike bëhet e nevojshme për ushtrimin efektiv të së drejtës për mbrojtje.

Vetë neni 19 i ligjit nr. 111/2017 parashikon se [...] Ky formulim tregon se ligjvënësi nuk e ka lidhur të drejtën për të kërkuar ndihmë juridike vetëm me momentin fillestar të procesit, por e ka shtrirë atë edhe në fazat e mëvonshme të tij, aty ku nevoja për mbrojtje profesionale mund të lindë ose të bëhet reale. Për këtë arsye, nëse çështja ndodhet në apel ose në fazën e rekursit, kërkesa për ndihmë juridike nuk mund të trajtohet sikur procesi të ishte ende në shkallë të parë. Ajo duhet të lidhet me fazën procedurale ku pala ka nevojë konkrete për mbrojtje. Në të kundërt, e drejta e njohur nga neni 19 do të rrezikonte të mbetej formale sepse kërkesa do të shqyrtohej nga një gjykatë e shkëputur nga procesi ku ndihma juridike duhet të prodhojë efektin e saj.

Edhe jurisprudenca kushtetuese mbështet këtë qasje. [...] Në këtë kuptim merr përparësi qëndrimi që e lidh kompetencën me gjykatën ku ndodhet çështja për shqyrtim. Ky interpretim mbështetet në natyrën mbështetëse dhe funksionale të ndihmës juridike dytësore, e cila nuk qëndron e shkëputur nga procesi kryesor, por shërben për të garantuar ushtrimin efektiv të të drejtave procedurale të palës. Kërkesa për ndihmë juridike nuk ka vlerë të pavarur nga procesi për të cilin kërkohet. Ajo ka kuptim për aq sa i jep palës mundësi reale të përfaqësohet, të mbrohet ose të ushtrojë mjetin procedural në fazën ku ndodhet çështja. Prandaj, shprehja *“në çdo fazë të procesit”*, e përdorur në nenin 19 të ligjit nr. 111/2017, merr kuptim të plotë vetëm nëse kompetenca për shqyrtimin e kërkesës lidhet me gjykatën ose hallkën procedurale ku ajo fazë zhvillohet realisht. Në të kundërt, ndihma juridike do të shkëputej nga funksioni i

saj dhe do të kthehej në një procedurë paralele, më shumë formale sesa efektive.

Ky interpretim mbështetet edhe në formulimin e vetë nenit 20/1 të ligjit nr. 111/2017. Ligjvënësi nuk ka përdorur shprehjen “*gjykata e shkallës së parë*”, por formulimin më të gjerë “*gjykata kompetente për shqyrtimin e çështjes në themel*”. Kjo terminologji e zgjedhur nuk mund të konsiderohet e rastësishme. Ajo lejon që kompetenca të kuptohet në lidhje me çështjen konkrete dhe me fazën procedurale ku ajo ndodhet, jo vetëm me gjykatën që ka pasur kompetencën fillestare për shqyrtimin e saj. Për rrjedhojë, “gjykata kompetente” është ajo që, në momentin kur paraqitet kërkesa për ndihmë juridike ka kompetencën funksionale për të shqyrtuar çështjen ose për të kryer veprimin procedural nga i cili varet ushtrimi efektiv i së drejtës së palës. Ky nuk është krijim i një kompetence të re, por zgjedhje ndërmjet dy kuptimeve të mundshme të së njëjtës dispozitë, duke i dhënë përparësi atij kuptimi që shmang një rezultat formalist dhe i jep normës efekt praktik.

Këtë lexim e mbështet edhe neni 21 i ligjit nr. 111/2017. Fakti që, në procesin penal, ligji e lidh kërkesën për ndihmë juridike dytësore me organin procedues që fillon hetimet tregon se ligjvënësi nuk e ka absolutizuar modelin sipas të cilit kërkesa duhet të shqyrtohet vetëm nga gjykata që shqyrton fillimisht themelin. Edhe pse ky rregull është i posaçëm për procesin penal dhe nuk mund të zbatohet mekanikisht në çështjet civile ose administrative, ai ka vlerë interpretative **për logjikën e përgjithshme të ligjit**. Ai tregon se, kur nevoja për mbrojtje lind në një hallkë të caktuar procedurale, kompetenca mund dhe duhet të lidhet me atë hallkë, në mënyrë që ndihma juridike të jetë e dobishme dhe në kohë.

Po ashtu, neni 22, pikat 2 dhe 3, të ligjit nr. 111/2017 tregon se ligjvënësi e ka lidhur shqyrtimin e kërkesës për ndihmë juridike me ritmin dhe nevojat e fazës procedurale ku ajo paraqitet. Kur kërkesa paraqitet gjatë shqyrtimit gjyqësor, vendimi merret sipas legjislacionit procedural dhe dispozitave të ligjit, ndërsa kur plotësimi i dokumentacionit mund të shkaktojë vonesa që cenojnë thelbin e të drejtave të kërkuarit, gjykata mund të urdhërojë organet e administratës shtetërore të paraqesin dokumentet e nevojshme. Këto rregulla tregojnë se koha e dhënies së ndihmës juridike nuk është element dytësor, por pjesë e efektivitetit të saj. Për këtë arsye, interpretimi i nenit 1/20 duhet të jetë i tillë që të mos e neutralizojë këtë element kohor. Kur çështja ndodhet tashmë në apel ose në fazën e rekursit, ridërgimi i kërkesës në gjykatën e shkallës së parë rrezikon të krijojë vonesë dhe ta shkëpusë ndihmën juridike nga momenti procedural ku ajo duhet të shërbejë realisht.

Ky interpretim ka rëndësi të veçantë në gjykimin administrativ, ku çështja në apel ose në fazën e rekursit shpesh lidhet me kontrollin e ligjshmërisë së akteve administrative dhe me respektimin e afateve procedurale. Kur pala kërkon ndihmë juridike për të marrë pjesë në këtë fazë ose për të ushtruar një mjet procedural, gjykata që administron fazën përkatëse është në pozitën më të përshtatshme për të vlerësuar urgjencën, lidhjen e kërkesës me çështjen dhe nevojën për shmangien e vonesave që mund të cenojnë aksesin efektiv.

[..] Edhe vështrimi krahasues mbështet të njëjtën linjë interpretimi. [..] Pikërisht sepse zgjidhja duhet të mbetet brenda kornizës së ligjit të brendshëm, Kolegji vlerëson se duhet trajtuar edhe kundërargumenti që mbështetet në të drejtën e ankimit të veçantë ndaj vendimit për rrëzimin e kërkesës për ndihmë juridike dytësore. Ky argument nuk është pa peshë. Neni 22, pikat 7 dhe 8, të ligjit nr. 2017/111 parashikon një skemë kontrolli ku vendimi që rrëzon kërkesën i nënshtrohet ankimit të veçantë në gjykatën e apelit, ndërsa kundër vendimit të kësaj të fundit nuk lejohet rekurs. Për këtë arsye, duhet pranuar se shqyrtimi fillestar i kërkesës nga gjykata e apelit, kur çështja ndodhet tashmë në atë shkallë, e ngushton modelin e zakonshëm të kontrollit të parashikuar nga kjo dispozitë. Megjithatë, ky element procedural nuk mjafton për ta bërë gjykatën e shkallës së parë forum të detyrueshëm në çdo rast.

E drejta e ankimit duhet të lexohet në harmoni me qëllimin e ligjit dhe me funksionin real të ndihmës juridike dytësore. Ajo nuk mund të interpretohet në mënyrë të tillë që, për të ruajtur formalisht një shkallë kontrolli, të dobësojë aksesin real në gjykatë dhe mbrojtjen profesionale në fazën ku ajo nevojitet. Nëse kërkesa do të dërgohej në gjykatën e shkallës së parë vetëm për të ruajtur skemën e ankimit të veçantë, ndërkohë që çështja ndodhet tashmë në apel ose në fazën e rekursit, atëherë do të krijohet një kontroll procedural formalisht i plotë, por funksionalisht i vonuar dhe i shkëputur nga nevoja konkrete e palës. Për këtë arsye, nuk vendosen përballë njëra-tjetrës e drejta e ankimit dhe efektiviteti si dy vlera të jashtme ndaj ligjit. Përkundrazi, kërkohet një lexim që ruan balancën e brendshme të ligjit dhe nuk lejon që formalizmi i kontrollit të prevalojë mbi funksionin real të ndihmës juridike dytësore.

Për fazën e apelit, përfundimi është më i drejtpërdrejtë. Kur çështja ndodhet tashmë në gjykatën e apelit, kërkesa për ndihmë juridike dytësore duhet të shqyrtohet nga ajo gjykatë, sepse pikërisht aty zhvillohet faza procedurale për të cilën pala kërkon mbrojtje profesionale. Gjykata e apelit është në këtë rast gjykata që ka kompetencën funksionale për

shqyrtimin e çështjes në atë fazë dhe që mund ta bëjë ndihmën juridike realisht të dobishme për palën. Të kërkohej që kërkesa ndihmëse t'i rikthehet gjykatës së shkallës së parë vetëm sepse ajo ka gjykuar fillimisht themelin, do të thotë t'i jepet përparësi një kuptimi statik të kompetencës, në dëm të funksionit real të së drejtës. Një zgjidhje e tillë nuk përputhet me arkitekturën e ligjit nr. 111/2017, i cili kërkon që ndihma juridike të jetë jo vetëm e parashikuar në ligj, por e përdorshme në kohë dhe në fazën konkrete ku ajo kërkohej.

Kur nevoja për ndihmë juridike dytësore lidhet me ushtrimin, nënshkrimin ose depozitimin e rekursit, kompetenca për shqyrtimin e kërkesës i përket gjykatës pranë së cilës depozitohet rekursi dhe ku verifikohet rregullsia formale e tij. Kjo zgjidhje diktohet nga fakti se pa nënshkrimin e rekursit nga avokati, mjeti procedural nuk mund të kalojë filtrin formal dhe për rrjedhojë, çështja nuk mund të bëhet objekt shqyrtimi në Gjykatën e Lartë, për sa kohë rekursi nuk plotëson këtë kusht formal.

Në këtë rast, shqyrtimi i kërkesës për ndihmë juridike dytësore nuk nënkupton marrjen në shqyrtim të themelit të rekursit nga gjykata ku ai depozitohet, por vetëm vlerësimin e kushteve ligjore për sigurimin e mbrojtjes profesionale të domosdoshme për vlefshmërinë formale të mjetit procedural. Kështu ruhet roli kushtetues i Gjykatës së Lartë si gjykatë ligji, ndërsa pala nuk lihet pa mjet efektiv për të përmbushur një kërkesë formale që ligji procedural e lidh me përfaqësimin nga avokati.

Kolegji vlerëson se kjo zgjidhje ruan tekstin e ligjit, i jep kuptim real parimit të efektivitetit, mban parasysh rolin parësor të mekanizmit publik të ndihmës juridike dhe nuk e vendos Gjykatën e Lartë në rolin e ligjvënësit sepse ajo nuk krijon një normë të re, por zgjedh interpretimin kushtetues më bindës ndër dy leximet e mundshme të ligjit. Veçanërisht për rekursin, ky interpretim nuk e zhvendos shqyrtimin e kërkesës në Gjykatën e Lartë përpara se çështja të kalojë filtrin formal, por e lidh ndihmën juridike me gjykatën ku ky filtër kryhet. Njëkohësisht, ajo përcjell edhe mesazhin institucional që sistemi i ndihmës juridike duhet të funksionojë sa më herët dhe sa më shpejt përmes hallkave publike të krijuara nga ligji, në mënyrë që nevoja e qytetarit për mbrojtje të mos shndërrohet në një konflikt procedural të panevojshëm. Në këtë mënyrë, ruhet edhe dallimi i domosdoshëm midis interpretimit gjyqësor dhe krijimit të normës. Gjykata nuk po shton një rregull të ri, por po zgjedh atë lexim të ligjit që i jep fuqi reale efikasitet dhe efektivitet që vetë ligjvënësi ka ngulitur në strukturën e tij. Ky interpretim harmonizon nenin 20/1 me nenin 19, me parimet e nenit 4 dhe me qëllimin e nenit 2 të ligjit nr. 111/2017, duke i dhënë përparësi aksesit real, mbrojtjes efektive dhe funksionimit të

arsyeshëm të procesit gjyqësor. Për rrjedhojë, lidhja e kompetencës me gjykatën ose hallkën procedurale ku ndodhet realisht çështja nuk është zgjidhje thjesht praktike, por pasojë e vetë qëllimit dhe strukturës së ligjit.

Bazuar në arsyetimin e mësipërm, në interpretim sistematik dhe teleologjik të ligjit nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, Kolegji konkludon në këtë përfundim njëses:

“Shprehja “gjykata kompetente për shqyrtimin e çështjes në themel”, e parashikuar në nenin 20/1 të ligjit nr. 111/2017, duhet kuptuar në dritën e neneve 2, 4, 19, 21 dhe 22 të këtij ligji, si dhe të nenit 42 të Kushtetutës, si gjykata që në fazën konkrete të procesit ka kompetencën funksionale të shqyrtojë çështjen ose kërkesën procedurale nga e cila varet ushtrimi efektiv i së drejtës së aksesit në gjykatë. Për rrjedhojë, kur kërkesa për ndihmë juridike dytësore paraqitet gjatë gjykimit në apel, kompetente është gjykata e apelit ku ndodhet çështja. Kur nevoja për ndihmë juridike dytësore lind në fazën e ushtrimit të ankimit ose të rekursit, kompetenca i përket gjykatës pranë së cilës depozitohet ankimi ose rekursi dhe ku verifikohet rregullsia formale e tij”.

Ç. Zgjidhja e çështjes konkrete

Në zbatim të rregullit njëses të mësipërm, Kolegji konstaton se vendimi i Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, me të cilin është deklaruar moskompetenca e kësaj gjykate dhe aktet i janë dërguar Gjykatës Administrative të Apelit, **është i drejtë në përfundim.** [...] Kjo gjykatë është jo vetëm gjykata e juridiksionit administrativ, por edhe gjykata që në atë fazë procedurale ka kompetencën funksionale për shqyrtimin e çështjes kryesore. Prandaj, vetëm shqyrtimi i kërkesës nga Gjykata Administrative e Apelit ruan lidhjen ndërmjet ndihmës juridike dytësore dhe fazës së procesit ku pala ka nevojë konkrete për mbrojtje profesionale. [...]

Ky botim u prodhuan me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe të Këshillit të Evropës. Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e autorit. Pikëpamjet e shprehura këtu nuk mund të konsiderohen në asnjë mënyrë se pasqyrojnë opinionin zyrtar të Bashkimit Evropian apo të Këshillit të Evropës.

Bashkëfinancuar nga
Bashkimi Evropian



BASHKIMI EVROPIAN

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Bashkëfinancuar dhe zbatuar
nga Këshilli i Evropës



GJYKATA E LARTË
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË